



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 9 MARS 2023

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 9. MARTA 2023. GODINE

MARS - MART  
2023

## **Rendi i ditës**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Pyetjet parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-137 për pyjet,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-172 për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158,
8. Shqyrtimi i Raportit të performansës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2021,
9. Shqyrtimi i Rekomandimeve lidhur me Raportin e auditimit “Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra”,
10. Shqyrtimi i Rekomandimeve lidhur me Raportin e auditimit “Performansa financiare dhe operative NP “Trepça sh. a.”,
11. Emërimi i drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
12. Shqyrtimi i Projekt-Deklaratës në mbështetje të Fondit Kosovaro-Amerikan për Arsim (KAEF).

## **Dnevni red**

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Parlamentarna pitanja,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-137 o šumama,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-172 o opštoj bezbednosti proizvoda,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-212 o reproduktivnom zdravlju i medicinski potpomognutoj oplodnji,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-214 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-163 o rudnicima i mineralima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-158,
8. Razmatranje Izveštaja o radu Centralnih javnih preduzeća za 2021. godinu,
9. Razmatranje preporuka u vezi sa Izveštajem o reviziji “Sistem licenciranja hidroelektrana i njihovo praćenje uticaja na životnu sredinu i vode”,
10. Razmatranje preporuka u vezi sa Izveštajem revizije “Finansijski i operativni učinak NP “Trepča sh. a.”,
11. Imenovanje direktora i zamenika direktora Izvršnog sekretarijata Agencije za upoređivanje i verifikaciju imovine,
12. Razmatranje Nacrta deklaracije koja se odnosi na podršku Kosovsko-američkom fondu za obrazovanje (KAEF).

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Presim edhe pak, sepse grupet parlamentare mund të jenë në konsultim për ta plotësuar rendin e ditës së seancës së sotme.

Meqenëse kemi një kërkesë për ta shtuar një pikë të rendit të ditës, atëherë ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Arsim, deputeti Ardian Gola. Urdhëroni, zoti Gola!

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryekuvendar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në pajtim me nenin 53, nënparagrafi 1.2 të Rregullores së Kuvendit, propozojmë plotësimin e rendit të ditës së seancës plenare të datës 9 mars 2023 si në vijim:

Shqyrtimi i Projektligjit numër 08/L-152 për antidopingun të renditet si pikë e tetë e rendit të ditës.

Arsyetimi është si në vijim.

Përmes këtij projektligji do të përcaktohen rregullat themelore për organizimin, administrimin dhe funksionimin e Agjencisë antidoping në Republikën e Kosovës, e cila nuk ka qenë më parë e rregulluar në Kosovë.

Gjithashtu ky projektligj do të përcaktojë rregullat themelore dhe mekanizmat që luftojnë përdorimin e substancave dhe metodave të dopingut në sport për të mbrojtur shëndetin e sportistëve, për të garantuar drejtësi dhe shanse të barabarta në gara sportive dhe për të ruajtur integritetin e sportit në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare.

Për shkak të rëndësisë që ky projektligj për sportin dhe sportistët në Republikën e Kosovës ka, ju ftoj që të votoni këtë mocion për plotësim të rendit të ditës dhe të shqyrtojme projektligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo ishte kërkesa e mocionit, pra si pikë e tetë e rendit të ditës të vendoset Projektligji antidoping.

E hedhim në votim këtë kërkesë në formë të mocionit që të përfshihet ky projektligj në rend të ditës.

Kush është për këtë mocion?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

74 deputetë ishin të pranishëm. 67 nga ta votuan, nga 74 sa ishin.  
Të gjitha votat për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që miratohet mocioni, si pika e tetë e rendit të ditës vendoset Projektligji antidoping, të cilën do ta shqyrtojmë kur t'i vijë koha.

Të nderuar deputetë,  
Në sallë janë të pranishëm 76 deputetë

## **1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme**

Ju pyes nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës, e mbajtur më 16 shkurt 2023? Nëse nuk keni vërejtje, konstatohet që Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës.

## **2. Deklarimet jashtë rendit të ditës**

Nga Lëvizja Vetëvendosje nuk është lajmëruar askush.  
Deputeti Avni Dehari e ka fjalën.

AVNI DEHARI: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra e zëvendësministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të dashur,

7 Marsi, Dita e Mësuesit, është nga ditët më të rëndësishme e më të shënuara ndër festat tona kombëtare. Në këtë ditë të muajit të parë të stinës së pranverës rilindësit tanë që punonin natë e ditë për lirinë e atdheut të vetëdijshëm për rolin e arsimit kombëtarë në rrethana të vështira të robërisë shekullore më 7 mars të vitit 1887 ia dolën ta hapnin shkollën e parë në gjuhën shqipe në Korçë.

Hapja e shkollës shqipe në muajin e parë të pranverës ka edhe anën e saj simbolike, pranvera që vjen pas dimrit të acartë e të vështirë, siç vjen liria pas robërisë, na mbush me gjallëri e me vull jetësor për ta gëzuar stinën e verës e të vjeshtës dhe për t'u përballur me sukses me dimrin që nuk harron të vijë dhe sërish të na kërcënojë me ngrica, me uri, me sëmundje, madje edhe me vdekje.

Si pranvera që më e fortë si gjallëri t'i gëzojmë të mirat e stinëve dhe t'i përballojmë vështirësitë e rreziqet që mund t'i sjellin ato, edhe shkollimi na i hap sytë, na e rrit mendjen e na jep zemër ta luftojmë robërinë, gjënë më të rëndë e më të urryer që njih njerëzim, dhe t'i përvishemi punës me përkushtim për ta ndërtuar shtetin, kupolën e atdheut, për t'i gëzuar frutat e lirisë dhe për t'i

mbrojtur ato nga përpjekjet e pareshtura të armiqve tanë që nuk pushojnë të na futin sërish nën kthetrat e robërisë vdekjeprurëse.

Shkollimi gjatë gjithë historisë na ka prirë në luftë çlirimtare, në rrugën e shpëtimit kombëtar dhe në përpjekjet për t'u radhitur krah për krah me popujt e lirë e të qytetëruar.

Duke e vlerësuar dijen si një armë më të përsosur kundër robërisë si një armë magjike për mbijetesë, për mbrojtje dhe për shpëtim armiqtë dhe pushtuesit tanë na kanë privuar nga e drejta për t'u shkolluar. Maksima që ka nxjerrë ata se “po e fituan shqiptarët të drejtën për shkollim në gjuhën amtare, kanë siguruar armën më të fortë në luftë për liri, bombën atomike”, flet më së miri për rëndësinë që ka shkollimi.

Shkolla e parë shqipe në Korçë më 7 mars të vitit 1887, shkolla e Prizrenit e vitit 1889, shkolla e vashave në Korçë e vitit 1891, Shkolla e Stubllës së Vitisë e vitit 1905 dhe disa shkolla e përpjekje në qytetet e tjera për të nxënë dije në gjuhën shqipe sollën fruta të çmueshme, si Kongresin e alfabetit të Manastirit më 1908 që vendosi që gjuha jonë të shkruhet me një alfabet origjinal e të përbashkët nga të gjithë shqiptarët, Normalen e Elbasanit, shkollën e parë të mesme më 1909, shpalljen e pavarësisë së shtetit shqiptar më 1912 në Vlorë, themelimin e Universitetit në Tiranë më 6 shtator 1957, demonstratat gjithëpopullore të vitit 1968 që tronditën themelet e Jugosllavisë, themelimin e Universitetit në Prishtinë më 15 shkurt 1970, Kongresin e drejtshkrimit më 1972 në Tiranë që vuri bazat e gjuhës së njësuar sipas parimit “Një komb, një gjuhë”, demonstratat gjithëpopullore të vitit 1981 që hapën shtigjet për rezistencë të hapur dhe për luftë të armatosur çlirimtare, UÇK-në që çlirojë Kosovën nga pushtuesi serb më 12 qershor 1999, shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008 dhe shumë rezultate të tjera që është e vështirë të numërohen në këtë rast.

Mësuesit dhe institucionet e Kosovës, duke pasur parasysh mundin dhe sakrificën e rilindësve tanë, si Petro Nino Luarasi, Pandeli Sotiri, Motrat dhe Vëllezërit Qirijazi, Dom Mikel Tarabulluzi, e shumë të tjerë të mësuesve e të veprimtarëve që në vitet '90-a organizuar shkollimin paralel nëpër shtëpi e objekte të tjera, të prindërve Muharrem Hysenaj, Bajram Hoxha dhe Hasan Hysenaj që në janar të vitit 1992 ranë nga plumbat e policisë serbe dhe të Asllan Hysenajt, me të birin Ymerin, që morën plagë të rënda në mbrojtje të shkollës paralel në Uçë të Burimit, të mësuesit dhe të atdhetarit Fazli Grajçevci që vdiq nga torturat e hetuesve të UDB-së më 17 gusht 1964...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia vazhdoni kohën e fjalës zotit Dehari.

AVNI DEHARI: ...në Burgun e Prishtinës, të mësuesit Halit Geci që u vra nga forcat serbe në Llaushë të Skenderajt më 26 nëntor 1997, të mësuesit dhe të patriotit të pashembullt Shaban Jashari që edhe ky u vra më 5 mars 1998 duke luftuar kundër ushtrisë serbe tok me bashkëshorten Zahiden, me bijtë Ademin, Hamzën, me rejat, me nipat dhe me mikun Osman Geci, të prindërve, të mësuesve në mërgim që mbajnë gjallë gjuhën dhe mbrojnë identitetin kombëtar me organizimin e mësimit plotësues në gjuhën shqipe dhe të shumë mësuesve atdhetarëve të tjerë që kanë dhënë kontribut të madh në këtë fushë, e kanë për detyrë të u ofrojnë nxënësve njohuri të mjaftueshme shkencore bashkëkohore nëpërmjet një sistemi arsimor cilësor që garanton një të ardhme të ndritshme e të sigurt për popullin e për vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të PDK-së, Ferat Shala.

FERAT SHALA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ngrehim shqetësimin tonë rreth paralajmërimeve për rritjen e çmimit të energjisë nga Zyra e Rregullatorit.

Pra, jemi në prag të vendimmarrjes nga ZRRE për ngritjen e tarifave për 14%.

Ne si Parti Demokratike jemi kundër dhe kërkojmë që kjo të mos ndodhë për arsye si më poshtë: gjendjes jo të mirë ekonomike të vendit, për shkak të inflacionit të lartë mbi 14% për të gjitha produkteve bazë të jetesës, për shkak të rënies së fuqisë punëtore dhe humbjes së shumë vendeve të punës për shkak të ikjes masive të gjitha kategorive qytetare jashtë vendit. Kjo rritje është e papërballueshme dhe nuk duhet të ndodhë.

Po pse jemi këtu në këtë situatë? Tash e dy vjet jemi në paqartësi rreth të ardhmes së sektorit energjetik të vendit, pa planifikim rreth remonteve të termocentraleve, jemi këtu edhe për shkak të ndërhyrjeve politike në Rregullatorin, ZRRE, në KOST, në KEK dhe në institucione të tjera energjetike. Jemi këtu sepse kemi negociuar rreth dy vjet udhërrëfyesin e energjisë dhe tanimë edhe pas nënshkrimit, nuk kemi implementim dhe zbatim të tij. Jemi këtu sepse kemi një keqmenaxhim të skajshëm të KEK-ut mbështetur në kuadro krejtësisht politike dhe jo profesionale. Jemi këtu si rezultat i zvogëlimit të kapaciteteve prodhuese në Bllokun B2, jemi këtu si rezultat i goditjeve politike ndaj investitorëve në sektorin energjetik të vendit.

Por më lejoni që këtë situatë alarmante në sektorin energjetik të vendit ta ilustruj edhe me një shembull, të cilin nuk do të dëshiroja asnjëherë që shteti im Kosova dhe ne si parlamentar ta dëgjonim.

Më datën 7 mars 2023 Komisionin për Ekonomi bashkë me dy zyrtarë të lartë të KOST-it kemi mbajtur një takim me përfaqësues të ENSOI-së, organizatë kjo e operatorëve të sistemit të transmissioinit evropian. Pra, vërejtjet ishin ekstreme, si asnjëherë tjetër. Veçanërisht për periudhën e fundit dyvjeçare, apo, i citoj ata, për vërejtjet në sistemin e balancimit në kohë joreale. Pra pa planifikim, citoj ata: në vërejtjet që na dhanë direkt për financat e KOSTT-it, për çmimin e lartë që paguajmë si Kosovë për penalltitë si rezultat i mosplanifikimit dhe mosorganizimit. Citoj ata për shkeljet e marrëveshjes së vitit 2020. Sinqerisht situatat të cilën e kemi dëgjuar bashkërisht me kolegët e të gjitha subjekteve politike është shqetësuese për shtetin dhe për vendin në sektorin energjetik.

Ju lutem, i citoj, “jeni rasti më i keq në tërë sistemin e 39 operatorëve evropianë të sistemit të transmissioinit nga gjithsej 35 vende të Bashkimit Evropian, si pjesë e këtyre organizatave. Jeni rasti më i keq se vetë Ukraina, e cila ndodhet në luftë në sistemin energjetik të vendit”. Pra, nuk ka rast më të rëndë kur përfaqësues të ENSOI-së, në takim zyrtar na thonë që jeni rast ekstrem, jeni pikë e zezë në kuadër të Evropës, ndryshoni sepse mund të përjashtoheni, edhe ashtu nuk jem anëtar të rregullt. Paralajmërimet e tilla duhen të jenë shqetësim për vendin, shqetësim për institucionet vendimmarrëse, larg duart nga politika në rregullator dhe në institucione të tjera. Ju lutem, reflektoni dhe veproni!

Unë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ju ofrojmë sinqerisht mbështetje për të dalë nga kjo rrugë, por jo me këtë formë, me këtë platformë dhe me këtë sjellje që aktualisht Qeveria ka.

Çka duhet të bëjmë ne aktualisht si Qeveri nëse keni vullnetin e mirë që ta kalojmë këtë krizë dhe këtë goditje të rëndë ekonomike që po i ndodh vendit. Të krijojmë një task-forcë nacionale me ekspertë të pavarur, të cilët shumë shpejtë do të merrnin përsipër reformën e thellë në tërë sektorin energjetik të vendit, do të merrnin vendim në orientimin tonë politik e strategjik për sektorin, të merrnim vendim për kapacitetet prodhuese vendore, për shkallën e shfrytëzimit të resurseve minerale të linjitet për mënyrën, teknologjinë dhe aplikimin e tyre, të merrni vendim për të reformë të thellë legjislativë për tërë sektorin, duke shikuar paketën aktuale legjislativë dhe duke hartuar një paketë të re legjislativë, të mbështetur në kërkesën, ofertën dhe në gjendjen globale të sektorit.

Po ashtu duhet një reformë e thellë e të gjitha kapaciteteve humane që menaxhojnë me sektorin. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nga Lidhja Demokratike, deputetja Rrezarta Krasniqi e ka fjalën.

**REZARTA KRASNIQI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Partia që erdhi që pushtet përmes propagandës e mashtrimit me ide se do t'i kthejë shpresën vendit, duke premtuar edhe ndërtimin e autostradave si ajo për Pejë, Podujevë, Gjilan, Gjakovë e Mitrovicë, nuk ka filluar punimet në asnjërën prej tyre, për më keq ka nisur t'i bllokojë projektet ekzistuese që ishin në prag të përfundimit siç ishte ajo e magjistrales Prishtinë-Mitrovicë.

Andaj, sot dua të ngre një shqetësim për këtë çështje e cila edhe më tutje po vazhdon të vështirësohej qarkullimi i automjeteve, e halli i qytetarëve është veç përfundimi i punimeve në këtë segment.

Atyre nuk i intereson punëkryesi, përzgjidhni ju cilindo kompani që keni vendosur t'i ofron tender në këtë rrugë dhe përmyllni punimet brenda këtij viti, duke respektuar gjithashtu edhe të gjitha kërkesat që janë bë për kyçje edhe në rrugë.

Çdo vonesë tjetër e punimeve në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë është dëm i jashtëzakonshëm për qytetarët, bizneset dhe bujq, sepse gjendja është alarmante marrë parasysh edhe faktin se si projekt ka filluar punimet qe 10 vjet. Andaj, vonesat e mëtutjeshme janë të paarsyeshme.

Punimet duhet të përfundohen duke marrë për bazë të gjitha kërkesat e banorëve, siç janë ato për ndërtimin e rrethrotullimeve apo nënkalimeve si dhe funksionalizimin e semaforëve, çështje për të cilat është i njoftuar edhe ministri.

Ndonëse është larguar edhe një amendament i përkrahur këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës për ndërtimin e një rrethrotullimi në fshatin Pestovë, sepse është fshat që lidh edhe shumë fshatra të tjera të Ortakollit, gjithashtu lidh edhe komunën e Skenderajt.

Gjithashtu fshati Pestovë, duke pasur parasysh që ka shumë frekuentim të madh të mjeteve bujqësore, meqë kultivohet me masë të madhe patatja, është e domosdoshme një rrethrotullim, sepse çdo ditë marrim mesazhe nga qytetarët dhe bujq të atij fshati.

Ka ankesa të vazhdueshme nga qytetarë përveç vështirësisë në qarkullim dhe në kolona të gjata. Unë po ashtu kam një propozim konkret për kolegët e mi deputetë të partisë në pushtet që vijnë nga ajo anë për hir të gjendjes së rënduar në infrastrukturë dhe nevojat e qytetarëve për qarkullim të lirë të mos votojnë asnjë nga çështjet e tjera pa filluar punimet në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë.

Gjithashtu kam pritur që kjo kërkesë të vijë nga ata për arsye se janë më të zëshëm dhe Qeveria mund t'i dëgjojë, mirëpo po e shoh që nuk kanë pasur interes. Duhet të dini se duke u marrë me tema të tjera, ju injoroni kërkesat e tyre dhe rrjedhimisht po rreshtoheni kundër interesit të tyre, sepse keni përgjegjësi dhe obligim.



Më dua t'jua përkujtoj po ashtu se përfundimi i magjistrales Prishtinë - Mitrovicë ka qenë në mesin e projekteve infrastrukturore, për të cilat jeni zotuar se do t'i përmbyllni pasi të vini në pushtet, por çka boni sot: ndërpritni punimet, shkaktoni humbje të tjera te qytetarët, bizneset e kësaj pjese, të cilët me të drejtë ndjehen të zhgënjyer me mënyrën e qeverisjes së vendit që përbën vetëm stagnim dhe kthim mbrapa në shumë çështje.

Një ekonomi e rënduar, paga të vogla pothuajse në të gjithë sektorët, një gjendje po ashtu e rënduar në sistemin e shëndetësisë, largimi nga vendi u bë zgjedhja e vetme për shumë qytetarë, për fatin e keq në mesin e tyre po vazhdojnë edhe sot të presin në radhë para ambasadave janë mjekë, profesionistë të shumë fushave të tjera.

Ky është një rrezik i madh që po i kanoset vendit në mungesë të fuqisë punëtore. Në anën tjetër, shohim një diplomaci në gjumë që nuk ka shënuar asnjë progres në integrimin e vendit, përkundër që flitet vetëm për skandale siç ishte ajo e ambasadorit Berisha.

Asnjë njohje e re nuk i ka ardhur vendit, asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare, keni punuar çdo gjë mbrapsht deri më tani.

Prandaj, sot zhgënjimi është i madh dhe largimi është masiv, sepse keni manipuluar me vite të tëra se ju do të bëni ndryshimin. Ndërkohë që korrupsioni, nepotizmi vazhdojnë të jenë çështje kyçe që karakterizojnë punën e Qeverisë tuaj. Po shpresoj që shumë shpejt do të paguani faturën e dështimit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kryetari i Grupit të AAK-së, Besnik Tahiri.

**BESNIK TAHIRI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jam sot këtu të adresoj dhe të elaboroj pak më shumë kurthin, në të cilin Qeveria e Kosovës ka rënë, pra në kurthin e diskutimit politik në dialog dhe në neglizhencën totale të jetës, ekonomisë, mirëqenies dhe gjendjes sociale.

Shumë politikë - pak ekonomi, pak jetë - shumë politikë.

Është e papranueshme që i gjithë diskursi publik dhe vendimet në Qeveri të lidhen me politikën dhe tema të lara dhe asnjë veprim serioz të mos jetë në dobi të shoqërisë dhe qytetarëve. Është e pakuptimtë që politika dhe temat e larta të kthehen në qëllim më vete të Qeverisë. Më lejoni pak të elaboroj këtë.

Në qoftë se i shohim trendët globale të inflacionit, shohim e gjithandej botës inflacioni ka rënë, ndërsa në Kosovë është ngritur. Në janar të këtij viti inflacioni është shënuar në 12,1%, përderisa për çudi çmimet e derivateve kanë rënë, ndërsa produktiviteti i ekonomisë është në rënie. Kjo vjen si rrjedhojë e neglizhencës totale dhe injorimit të ekonomisë dhe politikave që e forcojnë shtetin në këtë aspekt.

Ekonomia dhe bizneset, të nderuar deputetë, janë para kolapsit dhe para bankrotimit. Njerëz që janë në punë në sektorin privat, po edhe në sektorin publik, janë bërë njësoj raste sociale, sikur ata që marrin ndihmë sociale, për shkak se nuk ka as ngritje të pagave dhe nuk ka asnjë veprim, asnjë subvencion, asnjë element që e forcon ekonominë. E ekonomia e bën jetën, ndërsa kjo Qeveri e ka kthyer në mjet të vetin, në qëllim të vetin vetëm diskutimin politik.

Tri lajmet e fundit janë tepër dëshpëruese. E para ka të bëjë me paralajmërimin e rritjes së rrymës për 14%. Si mund të ndodhë kjo, mbi çfarë baze? Cili është presioni? Si ka ardhur deri te ky vendim?

E dyta ka të bëjë me rritjen e tatimit në pronë, që ka efektuar drejtpërdrejt secilin qytetar më vete.

Dhe e treta, që po ashtu është jashtëzakonisht e rëndësishme, lidhet me sektorin publik dhe me Ligjin e pagave. Po, nja dhjetë mijë njerëz janë gëzuar, shtatëdhjetë mijë të tjerë kur zgjohen në mëngjes dhe shkojnë në punë, janë të dëshpëruar. Në qoftë se nuk ka një reflektim të zhvillimit ekonomik dhe vijmë në këtë seancë dhe dëgjojmë kryeministrin, dëgjojmë ministrat, duke u sjellë rreth një teme, rreth politikës, atëherë ju them me përgjegjësi të plotë, ky do të jetë viti i kapitullimit ekonomik.

Po jua jap vetëm një shembull, se çka ka ndodhur në Maqedoni.

Rruga Tetovë - Strugë - Qafëthanë dhe rruga Prilep - Manastir është nënshkruar me kompaninë Bechtel&Enka për 1,3 miliard euro. Qeveria e Kosovës e ka bërë një rrugë tri metra në Istog. Kthjelluni!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Arjeta Fejza.

**ARJETA FEJZA:** Faleminderit, i nderuar kryetar Konjufca!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Muaji mars është thirrja për reflektim për detyrat tona për barazinë shoqërore dhe ekonomike, kundër diskriminimit, shtypjes dhe pabarazisë. Veprimtaria e grave dhe vajzave në vendin tonë, si në çdo vend tjetër të botës, përbën thelbin për arritje drejt një shoqërie përparimtare e të drejtë. Në shkencë, kulturë, sporte, edukim, art, politikë e të gjitha fushat e tjera, vajzat dhe gratë kanë

prekur majat e sukseseve, duke thyer të gjitha stereotipat dhe barrierat e duke dëshmuar se gjinia nuk duhet të jetë dhe nuk është pengesë për barazi.

Në Kosovë tashmë janë ndërmarrë veprime konkrete që të avancohet në pavarësinë ekonomike të grave. Janë mbi pesë mijë gra të punësuar përmes masave të Qeverisë. Rreth dyzetekatër biznese që drejtohen nga gratë janë përkrahur për zgjerim të biznesit të tyre. Gjashtëqind e tri gra janë punësuar në kuadër të skemës “Qeveria për Familjen” dhe mbi tetëdhjetenëntë mijë gra që kanë marrë shtesa për lehonat si ndihmë për nënat e reja.

E megjithatë, femicidi, dhuna në familje dhe me baza gjinore mbetet sfida jonë si shoqëri. Në kuadër të veprimeve shtetërore në këtë fushë tashmë janë ndërmarrë: miratimi i strategjisë kombëtare dhe plani i veprimit kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; kompensimi i viktimave të krimit; Ligji për ndihmë juridike falas; plotësimi i buxhetit për strehimoret që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave; miratimi i protokollit shtetëror për rastet e dhunës seksuale; miratimi dhe lansimi i kurrikulës për trajnimin e profesionistëve për ofrimin e programeve për kryesit e dhunës në familje; miratimi i plotësim-ndryshimit të Kodit Penal dhe atij të procedurës; transferimi i departamentit për politika sociale dhe familjare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në Ministri të Drejtësisë, si dhe nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë është organizuar fushata ndërkombëtare “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore”.

Dje, në seancën e Kuvendit, votuam në lexim të parë Projektligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore. Me këtë rast hapet rruga për ndryshim rrënjësor të mekanizmave shtetërorë që kanë përgjegjësi për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve brenda shtëpisë apo kudo tjetër. Po ashtu, dje iniciuam Komisionin Hetimor për hetim të çdo dështimi të hallkave institucionale në rastet e dhunës, hetim për çdo lëshim.

Lufta kundër femicidit, dhunës në familje, është e vështirë, por nuk guxojmë dhe nuk duhet t'i humbim shpresat. Përkundrazi, si institucione dhe si shoqëri, të bashkuar duhet të luftojmë femicidin që po merr jetën e grave. Jemi të vetëdijshme për sfidat dhe barrierat, por duhet t'i tejkalojmë teksa angazhohemi së bashku kundrejt patriarkatit dhe drejt barazisë gjinore. Sa më shpejt bie e para, e arrijmë të dytën. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën tash ia japim deputetes Floretë Zejnullahu.

**FLORETË ZEJNULLAHU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Tani, kur u bënë dy vjet të kësaj Qeverie, edhe sot gjendja në sektorin e shëndetësisë është shumë e rëndë. Ndërrimi i tre ministrave brenda dy vjet qeverisjeje tregon më së miri se në çfarë prioriteti e kanë trajtuar këtë sektor.

Tani dua të flas për disa çështje që prekin këtë sektor. Në vitin 2019, kur Ministria e Shëndetësisë udhëhoqej nga Partia Demokratike e Kosovës, u nënshkrua Udhëzimi Administrativ për rregullimin e çmimit të barnave, i cili me ndërrimin e qeverive nuk u zbatua, madje edhe u shfuqizua.

Para një viti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kam dorëzuar Projektligjin për rregullimin e çmimit të produkteve medicinale, projektligj ky që nuk gjeti mbështetje nga kjo shumicë, vetëm pse si i tillë ishte propozuar nga opozita. Atëherë, kur këtu shpërfaqet edhe një herë se për qëllime politike dhe biznese, kjo mazhorancë lejon blerjen e barnave me çmime abuzive edhe për një kohë të caktuar.

Tani, një vit më pas, projektligji i tillë është proceduar nga Ministria e Shëndetësisë, edhe pse një nismë e mirë e pozitive, por a ka llogaridhënie dhe përgjegjësi, pse kjo vonesë e panevojshme dhe përse kjo qasje në raport me blerjen e barnave me çmime abuzive për më shumë se një vit? Përse nuk u mbështet Projektligji për rregullimin e çmimit të barnave deri më tani? Pse nuk u zbatua Udhëzimi Administrativ?

Në shëndetësi çdo ditë po ndodhin skandale të njëpasnjëshme, keqmenaxhim, neglizhencë, nepotizëm, hajni e keqpërdorime, madje supermenët e Ministrisë së Shëndetësisë brenda natës edhe e ndërrojnë Udhëzimin Administrativ për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale, të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës, që u nënshkrua nga Dafina Gexha-Bunjaku, atëbotë ushtruese e detyrës së ministres së Shëndetësisë.

Ky veprim absurd dhe ilegal ishte bërë për ndikim në procedurat tenderuese, që po zhvilloheshin nga Ministria e Shëndetësisë, prandaj ngjalli dyshime të shumta edhe nga shoqëria civile, e krejt kjo u bë në emër të emergjencës. Por, për çfarë emergjence bëhet fjalë, asnjëherë nuk u dha përgjigje nga ministria. A u bë e gjithë kjo për shkak të implikimit në tenderin shtatë milionësh të insulinave?

Ky udhëzim e kufizon konkurrencën, duke e favorizuar monopolin dhe bashkë me tenderin për insulina, ishte bërë edhe mollë shërri në mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe OSHP-së, e cila edhe e kishte paditur OSHP-në, të cilën Gjykata e Apelit e ka rrëzuar, pra rreth tenderit shtatë milionësh të insulinave.

Pas dështimit të Ministrisë së Shëndetësisë për interferime në procedura tenderuese, dje e ka proceduar Projektligjin për rregullimin e çmimit të barnave, jo për me e rregullua këtë sektor, sepse vetë e refuzuan një gjë të tillë, por për të ndikuar në rastet, siç është bërë me Udhëzimin Administrativ.

E sot, gjendja në shëndetësinë kosovare është në kolaps. Sot shumica e njerëzve dhe profesionistëve shëndetësorë janë të pakënaqur me Ligjin e pagave. Deri më tani 45 ankesa për këtë projektligj janë drejtuar te Avokati i Popullit. Sikur të mos mjaftonin këto, qytetarët e Republikës së Kosovës sot marrin më pak shërbime shëndetësore. Sot në klinikat e QKUK-së ka lista enorme të pritjes për intervenime kirurgjike, lista për diagnostikim. Sot më shumë se kurrë, qytetarët blejnë vetë barnat, sepse ato nuk sigurohen nga shteti.

Me gjithë këto pakënaqësi Qeveria ende nuk shkarkon Bordin e SHKUK-së, edhe pse raporti i Auditorit i nxjerr një varg shkeljesh e keqpërdorimesh milionëshe që ka bërë ky Bord, i cili në mungesë të kryerjes së punës së vet, që ka dështuar pra dhe po tenton që tash të kapë edhe sindikatat e pavarura të punonjësve shëndetësorë, madje kërcënon punëtorët shëndetësorë me dërgim në Komision Disiplinor, kur ata shprehin pakënaqësitë e tyre në rrjetet sociale, siç është rasti dje me infermierin që u prezantua në media.

Pra, me këtë qasje dhe me këto shkelje, për të cilat askush nuk jep llogari e nuk shkarkohet, nuk mund të thuhet se kjo Qeveri e ka prioritet përmirësimin e gjendjes së shëndetësisë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash ia japim fjalën deputetes Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar,

Unë dua të ngre një çështje që ka të bëjë me Kuvendin, konkretisht me zgjedhjen e Komisionit për Ndhmën Shtetërore. Besoj që edhe ju jeni kontaktuar personalisht nga Zyra e BE-së.

Komisioni për Ndhmë Shtetërore nuk është funksional që nga data 7 mars të vitit 2022. Janë tri konkurse radhazi, që shpallen dhe anulohen. Unë vetëm ju njoftoj se në konkursin e fundit, domethënë konkursi i fundit është shpallur më 5 korrik 2022, në momentin kur është shpallur konkursi kanë konkurruar shtatëmbëdhjetë kandidatë. Komisioni është mbledhur më 13 tetor, sipas Ligjit për ndihmën shtetërore anëtarët e Komisionit përzgjedhës janë tre kryetarë të komisioneve, në këtë rast jam unë si kryetare e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, kryetari i Komisionit të Buxhetit dhe kryetari i Komisionit për Ekonomi.

Jemi takuar. Zoti Armend Muja ka kërkuar që ai ta udhëheqë procesin, edhe pse sipas renditjes në ligj më takon mua. Jam pajtuar që ai ta udhëheqë procesin dhe që nga data 13 tetor, kur është bërë lista e ngushtë për kandidatët, komisioni nuk ka qenë në gjendje të mbledhet dhe t'i caktojë datat për intervistim të kandidatëve. Po flasim, edhe një herë, për konkursin e shpallur më datë 5 korrik të vitit 2022.

Edhe një herë po ju them, nga data 7 mars 2022 Komisioni për Ndihmë Shtetërore nuk është funksional. Për më tepër, në Ministrinë e Financave ekziston një departament për ndihmën shtetërore, punojnë nëntë punëtorë, të cilët që nga 7 marsi i vitit 2022 nuk e kanë pasur as edhe një punë për ta kryer, për shkak se komisionit të cilit ata i shërbejnë, nuk është funksional.

Jua rikujtoj që ky komision është obligim sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ky komision është filtri, nëpër të cilin duhet të kalojnë të gjitha ndihmat, grantet dhe subvencionet, që Qeveria i jep për bizneset dhe qytetarët. Derisa Qeveria deklaroi se përgjatë dy vjetëve ka dhënë rreth 800 milionë euro, unë jua rikujtoj që asnjë prej këtyre masave nuk ka kaluar nëpërmes Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

Kryetar, unë me të vërtetë kërkoj nga ju që ta përdorni autoritetin, sepse ky nuk është juaji, për ta funksionalizuar këtë institucion kaq të rëndësishëm. Gjithashtu, ju informoj se nga data 1 mars ne e kemi edhe Trustin, fondin pensional, pa bord dhe unë po e shoh që historia po përsëritet. Do të thotë, e kemi pasur një kohë të gjatë Autoritetin e Konkurrencës jofunksional, si institucion shumë i rëndësishëm, e kemi pasur Organin Shqyrtues të Prokurimit jofunksional dhe besoni që pasojat nga mosfunksionalizimi i këtyre institucioneve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia vazhdoni edhe pak fjalën zonjës Bajrami, sa ta përfundojë.

**HYKMETE BAJRAMI:** Pasojat janë të pariparueshme, domethënë nga mosfunksionalizimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit, për shembull, ne e dimë që janë shtyrë dhe kemi pasur ekzekutiv dukshëm më të ulët të investimeve kapitale. Sot ata përballen me dhjetëra lëndë atje, derisa organizatat buxhetore presin për shqyrtimin e tyre. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash fjalën ia japim deputetes Albena Reshitaj.

**ALBENA RESHITAJ:** Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,  
Kabinet Qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Të dashur qytetarë,

Dje, emri im u lakua nëpër shumë media dhe portale nga një deklaratë emocionale dhe aspak e hijshme publike nga ana e kryesuesit të Kuvendit. Duke mbyllur seancën me një të pavërtetë të thënë fillimisht që unë paskam qëndruar disa sekonda në Kuvend.

Gjithashtu, zoti Konjufca, për disa deputetë të opozitës që qëndruan aty sa unë, ose edhe më pak kohë në Kuvend, sikur nuk i paskan penguar, ose gjithë mullëfin që kishte nga pamundësia për të koordinuar dhe bërë funksionale seancën, vendosi ta derdhte mbi emrin tim dhe mbi mua. Dhe, pikërisht në ditën më të veçantë të grave.

I nderuar zoti Konjufca, unë jam deputete në mandatin e dytë dhe unë vendos politikisht për vendimet, se a të qëndroj dhe kur të qëndroj në seancë. Kur kam qëndruar dikur, kur minutat kanë qenë aty të rëndësishëm, nuk ju ka penguar, as kur kam vendosur për votimin e disa projektligjeve dhe vendimeve që kanë qenë emergjente dhe shumë të rëndësishme për qytetarët e vendit.

Nuk e kuptoj këtë instalim të lidhshmërisë mes prezencës së deputetit në seancë dhe mëditjes. Për mendimin tim, këtu është një defekt, është një anomali, sepse prezenca e deputetit duhet të dokumentohet. Paramendoni, pas shumë dekadash kur nevojitet të dihet data dhe minutat kur unë kam qenë në seancë dhe nuk kam votuar për diçka, apo kam votuar, dhe nëse ju i lidhni me mëditjet, atëherë më vjen shumë keq, i bie që unë nuk kam qenë në seancë.

Prandaj, largojini këto defekte dhe anomali që janë prezentë në këtë Kuvend. Nuk jam unë deputetja e mëditjeve, zoti kryesues. As për mëditje e as për rrogë nuk vij në këtë Kuvend. Besoj, e dini profesionin tim dhe investimin tim shtatëmbëdhjetë vjeçar që kam bërë për të pasur një rrogë shumëfish më të madhe, se kjo që marr në këtë Kuvend. Por, unë jam këtu për popullin, për qytetarët, për ata që më kanë besuar dhe votuar dhe nuk ke të drejtë të më ofendosh publikisht.

Unë nuk marr mëditje. Për dy mandate vetëm një herë jam përkrahur nga Kuvendi, kur kam qenë jashtë vendit dhe atë me ftesë të Ambasadës Amerikane dhe Qeverisë Amerikane. Për dy mandate vetëm një vizitë e kam pasur jashtë vendit. Unë nuk kam përdorur kurrë as nga paratë e shpenzimet e deputetit. Prandaj, i nderuar kryetar i Kuvendit, shpresoj të reflektoni dhe të tërhiqeni nga ato fjalë të pavërteta, që keni thënë publikisht për mua. Beso, i bëni nder vetes.

Kurse, meqë e kemi kryeministrin këtu, dua ta falënderoj që dje të gjitha grave deputete na ka dhuruar nga një dhuratë. Faleminderit, kryeministër!

**KRYETARI:** Zonja Reshitaj, ju më njihni mirë dhe e dini shumë mirë që unë shumë rrallë bëj qortime publike të deputetëve. Por, ato i bëj zakonisht vetëm kur ia teprojnë, siç bëtë ju dje. Ia japim tash fjalën deputetes Yllëza Hoti.

YLLËZA HOTI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Tre vjetët e fundit kanë qenë mjaftë sfiduese për vendin tonë, duke filluar nga pandemia Covid 19 e deri te ndikimi zinxhiror që pati lufta në Ukrainë në gjithë botën, jemi mësuar kryesisht me lajme negative e aspak shpresëdhënëse.

Megjithatë, mendoj se është e rëndësishme, e madje edhe e nevojshme që të vihen në pah edhe zhvillimet pozitive të kohëve të fundit, e të cilat janë rezultat direkt i punës së mirë të Qeverisë Kurti.

Më 2 mars të këtij viti u publikua raporti i demokracisë i Institutit Suedez WIDEM, ku Kosova është përmirësuar për tri vende në indeksin e demokracisë, si dhe radhitet e para nga shtetet e Ballkanit Perëndimor për këtë indeks.

Një indikator i tillë, përveçse qartëson pozitën e shtetit tonë dhe përpjekjet tona për zhvillim të demokracisë, ndikon edhe në përmirësimin e perceptimit të shtetit tonë në rrafshin ndërkombëtar. Një shembull i qartë i këtij ndikimi është rritja e interesimit të kompanive të huaja për investim në Kosovë. Vetëm javët e fundit një delegacion i zyrtarëve të bizneseve të ndryshme amerikane kanë vizituar Kosovën, me ç'rast kanë takuar krerët e shtetit për të shprehur interesimin e tyre për investime të huaja direkte. Gjashtë nga këto kompani janë të interesuara për investime në sektorin e energjisë, e më specifikisht, në projekte që do të mundësojnë diversifikimin energjetik si dhe do të shtrojnë rrugën drejt energjisë së pastër.

Njëkohësisht, dy ditë më parë mësuam se tashmë është regjistruar në Kosovë kompania gjermane MUNDA, investim i cili do të hapë 200 vende të reja të punës në industrinë e tekstileve teknike. E kur flasim për vende të punës, mendoj se është e rëndësishme të përmendet edhe suksesi i deritanishëm i platformës Super-Puna, të implementuar nga Ministria e Financave.

Për vetëm tri javë në platformën Super-Puna janë regjistruar mbi tremijë punëkërkues të verifikuar, mbi dy mijë punëdhënës që ofrojnë punë dhe tashmë, janë aktive një mijë e pesëqind vende të punës. Përveç ndihmës që po u ofrohet bizneseve përmes subvencionimit të pagave për punëtorët e rinj që ata angazhojnë, njëkohësisht kjo platformë ndihmon të rinjtë tanë që të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, e po ashtu, që të ndërtojnë një fuqi punëtore të aftë dhe adekuate për zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë.



Prandaj, me këtë rast edhe një herë bëj thirrje që të gjithë të rinjtë e moshave 18 – 25 vjeç ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe ta përdorin platformën Super-Puna që të fillojnë zhvillimin e tyre në karrierë. Faleminderit!

KRYETARI: E fundit për diskutim, sepse e kaluam kohën, është Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Mbrëmë në Muzeun Etnografik të Kosovës është hapur ekspozita dhe është shfaqur premiera e filmit të shkurtër të Artan Korenicës, “Mirë se vini në tavolinë!”

Ishte e njëjta tavolinë, në të cilën tash e shumë vjet e shohim ulur Nënë Ferdonije, një nënë para së cilës ngelesh pa fjalë për të përshkruar gjithë vuajtjen, gjithë dhimbjen, pritjen dhe qëndresën e një gruaje të hekurt.

Për ta kuptuar të vërtetën e Nënës Ferdonije duhet të ulesh në atë tavolinë për ta ndier gjithë peshën, dhembjen dhe pafuqinë tonë si shtet, për të bërë më shumë për të dhe qindra familje të të pagjeturve në Kosovë. Ferdonija, bashkë me 1.600 familje të të pagjeturve të Kosovës na obligojnë edhe më shumë që të kuptojmë se për çfarë është duke u punuar dhe për çka po punojnë palët sot në marrëveshje? Cilat janë paralajmërimet e emisarit Miroslav Lajçak se palët janë dakorduar 99,5% lidhur me tekstin e marrëveshjes për të pagjeturit. Sepse, po shihet se ka një insistim të Serbisë që këta persona, të zhdukurit e të pagjeturit, t’i quajnë të zhdukur, kurse pala kosovare është dakorduar se po insiston t’i kualifikojë ata si persona të zhdukur me dhunë.

Ndërkohë, që ne, i nderuar kryeministër, nuk kemi pasur aspak informata të mjaftueshme nga Qeveria për ta kuptuar se në cilin drejtim është duke ecur marrëveshja për të pagjeturit. Jam shumë e vetëdijshme që Serbia asnjëherë nuk ka qenë konstruktive dhe e gatshme për t’u përballë me trashëgiminë e saj kriminele, këtë s’e kam pritur asnjëherë. Ashtu, siç më vjen thellësisht keq për të gjitha këto familje të të pagjeturve, të cilat janë mashtruar nga kryeministri Kurti, i cili disa herë ka thënë se nuk do të negociojë me Serbinë pa u kthyer edhe i pagjeturi i fundit dhe pa kërkuar falje Serbia për krimet që i ka bërë në Kosovë. Pra, sot po shohim se është ngadalësuar dukshëm dinamika e gërmimeve, madje po e shohim se Serbia pothuajse është ndalur tërësisht nga gërmimet për të identifikuar varreza të reja.

Si opozitarë temën e të pagjeturve dhe të ballafaqimit me të kaluarën e ke pasur në vazhdimësi. Sot në Qeveri, jo vetëm se nuk ka rezultate, por ka regres. Pra, përballë një marrëveshjeje, e cila vetëm në një vend i përmend personat e të pagjeturve, në fakt të pagjeturit. Në anën tjetër, në

hyrje të saj kërkohet që të tejkalohet ose të braktiset e kaluara. Ju pyes sot juve, i nderuar Kryeministër, se ku gjendet e vërteta e nënës Ferdonije dhe e 1 600 familjeve të të pagjeturve, sepse edhe ju dje jeni ulur në të njëjtën tavolinë me nënën Ferdonije.

**KRYETARI:** Këto ishin deklaratimet e deputetëve. Tash, nëse Qeveria ka nevojë për ndonjë deklaram të veçantë. Nëse jo, ministri i Shëndetësisë. Urdhëroni, ministër!

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Faleminderit, kryetar!

Arsyeja pse dola në foltore natyrisht ishin disa çështje që u përmendën nga deputetja në fjalë, që tash për momentin nuk gjendet këtu.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Dje ishte një lajm i mirë për Kosovën dhe një lajm i madh për Kosovën. U bë më në fund Ligji për çmimin e barnave, një ligj që mendoj që duhet t'i gëzohet secili qytetar, por natyrisht edhe ju si përfaqësues të qytetarëve t'i gëzoheni pa masë këtij ligji.

Shumë më lehtë për mua, edhe s'di a e keni parë, në asnjë prononcim timin publik dje nuk kam thënë pse nuk është bërë ky ligj më herët. Kisha pasur qejf që ky ligj të bëhet më herët. Fatkeqësisht nuk është bërë. Kisha pasur qejf të merrem me probleme të tjera. Fatkeqësisht, më është dashur të merrem me këtë ligj. Pse nuk është bërë më herët? Sepse në Qeverinë e PAN-it, a e di sa ligje janë proceduar në Ministrinë e Shëndetësisë? Qytetarë të nderuar, zero. Asnjë ligj në Ministrinë e Shëndetësisë, gjatë gjithë qeverisjes së PAN-it nuk është proceduar.

Unë edhe atëherë, edhe ish-ministrit, edhe deputetëve, edhe secilit i kam thënë: me udhëzim administrativ nuk zgjidhet kjo çështje, zgjidhet vetëm me ligj. Pse nuk është bërë, duhet t'i pyesni ministrat tuaj që kanë qenë më herët, jo neve, deputetë të nderuar.

Udhëzimi administrativ nuk ka mundur të zbatohet, e kemi thënë edhe më herët, sepse nuk zgjidhet kjo problematikë me udhëzim administrativ. Po shqyr u bë ligji, prej të cilit, deputetë të nderuar, pres që secili nga ju sa më shpejt ta miratojmë, sepse kjo kursen dhjetëra mijëra të parave nga xhepat e qytetarëve, e në anën tjetër edhe të institucioneve publike.

Sa i përket OSHP-së që e ngriti deputetja, për besë po çuditem. Si mund të kërkojë një ligjvënës nga Ministria e Shëndetësisë që ta shkelë ligjin. Por, unë nuk e shkel. Deputetë, nuk e shkeli! Kot më thoni. Edhe, a e dini pse? Ka kaluar koha kur deputetët vijnë edhe bëjnë presion në Ministri të Shëndetësisë e në zyrë të prokurimit për t'u shkelur ligji. Jo, nuk ndodh kjo më. Ky në asnjë moment, nuk do të lejoj as të shkelet ligji, as të bëhen tejkalime të ligjit. Në rastin e veçantë, unë ju bëj thirrje të gjitha kompanive pa dallim. Regjistroni produktet tuaja, sepse jam edhe unë kundër monopolit dhe jam që të mos jenë vetëm një ose dy produkte të regjistruara. Do ta marr

edhe përsipër vetë, bashkë me gjithë administratën në AKPM, që të jenë procedurat sa më të thjeshtëzuara të regjistrimit të këtyre produkteve.

Por, produktet e paregjisturara nuk do të lejohen në Republikën e Kosovës, sepse nuk garantojnë cilësinë. Nuk ka të bëjë me cilësinë e prodhimit, ka të bëjë me distribuimin nga prodhuesi deri te distributori. Ka të bëjë me distribuimin nga distributorit deri te institucionet dhe deri te dhënia e produktit final të pacientit. Nëse nuk ma garanton me autorizim-marketing cilësinë e këtij produkti, nuk do ta bëj këtë. Nuk do ta bëj, se përndryshe e shkel ligjin dhe e cenon sigurinë e qytetarëve të Republikës për të cilin ne si Qeveri jemi zotuar se nuk do ta bëjmë.

Sa i përket Ligjit të pagave, mund ta ketë dikë, por vetëm pyetni. Pyetini mjekët në tërësi sa janë të kënaqur me Ligjin e pagave. Mos jepni konstatime, kështu vetëm sa për të folur në aspektin po them diçka. Pyetini mjekët, se mua mjekët po më shkruajnë ndryshe. Edhe pyeteni rajonin se si janë të rregulluara, sa i kanë pagat specialistët, edhe pastaj vijmë edhe i diskutojmë.

Është e pavërtetë që shërbime ka më pak. Shërbime ka më shumë dhe po hapen çdoherë më shumë. Për herë të parë, në Klinikën e Urologjisë ka filluar dhe është funksionalizuar laparaskopia. Shekulli XXI dhe nuk ka pasur laparaskopi dhe nuk ka pasur staf të trajnuar deri vonë për laparaskopi në urologji. Edhe dita-ditës po shtohen. Është bërë rezonanca magnetike në Pejë. Deri në shtator a tetor do të bëhet edhe në Prizren. Do të bëhet rezonanca magnetike edhe në Klinikën e Peditrisë. D.m.th. të gjitha këto nuk po ankohe në asnjë moment pse nuk i keni bërë ju më herët...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Opozita kërkon që t'ia shtojmë fjalën.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit opozitës që ma shtoi fjalën.

Atëherë, listat e pritjes. Tash po harrojmë, po dy vjet kemi qenë në pandemi. Po harrojmë që shumica e klinikave në pandemi kanë shërbyer vetëm për pacientët të cilët kanë qenë me COVID. Natyrisht, se bëhen lista të pritjes. Por, nëse i keni informacionet 'update' e ju kisha lutur t'i bëni 'update', merrini e shikoni që listat e pritjes kanë filluar të zvogëlohen dhe me investimet që jemi duke i bërë, natyrisht se do të zvogëlohen dhe natyrisht se nuk do të ketë deri në fund, derisa të bëhet zero lista e pritjes nuk do të ndalemi.

Për bordin u përmend diçka.

Deputetë të nderuar dhe qytetarë të nderuar,

Vetëm një informacion: Bordi në qeverisjen e PAN-it ka nxjerrë një organogram, i cili ka qenë jo e nënshkruar nga ministri, me të cilin... *Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Zoti Vitia i marrim disa replika në formë të reagime, pastaj prapë e keni mundësinë në kohën tuaj.

Urdhëroni, z. Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Për shkak që deputetja e cila e ngriti çështjen nuk është prezente në seancë, më lejoni që shkurtimisht, disa çështje të cilat i potencoi ministri. Ky është i gatshëm të përgjigjet për gjithçka, por vetëm jo për periudhën në të cilën ky e udhëheq Ministrinë e Shëndetësisë. Ky është i gatshëm të përgjigjet për një organogram, që po thotë bordi të falet. Po nuk është i gatshëm të përgjigjet dymbëdhjetë milionë euro keqpërdorime nga Bordi i SHSKUK-së në vitin 2021 që i ka evidentuar Zyra e Auditorit Kombëtar. Ky thotë sot këtu unë nuk nënshkruaj kontrata pa autorizim marketingu, por po harron që në kohën e pandemisë, ky është ministri që ka nënshkruar kontrata pa autorizim marketingu. Për këtë çështje është hetuar edhe nga Komisioni Hetimor Parlamentar.

Ky për çdo gjë jep përgjigje, po jo vetëm për punën e tij. Sepse, ky po harron se këtu duhet të përgjigjet para deputetëve për përgjegjësitë të cilat i ka në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Udhëzimi administrativ për rregullimin e çmimit të barnave është nënshkruar në maj të vitit 2019 dhe ka qenë funksional. Nuk ka pasur ligj atë periudhë kohore dhe më vonë është menduar që të bëhet ligji dhe para një viti e kemi dorëzuar në Kuvend. Po na e dërgo nëse e ka atë brend, pse s'është bërë më herët, po pse s'është votuar para një viti nga mazhoranca, është sjellë tani. Ok, ne do ta shqyrtojmë se çfarë ka në atë ligj, mirëpo nuk dha përgjigje në atë që deputetja e tha esencialisht. Brenda 24 orëve është nënshkruar një udhëzim administrativ në emër të emergjencës, për të interferuar në tenderë. Nuk kanë marrë deputetët, as deputeti, asnjë deputet nuk ka ardhur për të interferuar në këtë çështje.

Ju mendoni se jeni më i madh se ligji në Kosovë, ose se gjykatat e Republikës së Kosovës. Është çështje të cilën ju e vlerësoni.

KRYETARI: E marrim vetëm edhe z. Lushtaku, pastaj ia japim fjalën z. Vitia. Pastaj znj. Rizvanolli kalojmë, sepse kemi edhe çështje të tjera që ka interes Qeveria për t'i ngritur.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

Meqenëse u ndërlihdh çështja e temës që desha të ngre në këtë pikë jashtë rendit të ditës. Dua të ngre të njëjtin shqetësim që e ngriti edhe deputetja. I tha disa replika ministri, që për mua nuk janë të arsyeshme. Për moszbatimin e vendimeve të OSHP-së dhe Gjykatës. Ju e dini shumë mirë që OSHP-në e ka zgjedhur po kjo legjislaturë, shumica e së cilës janë nga Vetëvendosja, që janë propozuar nga Qeveria e Kosovës. Janë po të njëjtit që kanë vendosur për një vendim katër herë. Ju nuk e zbatoni. Pastaj ka edhe nga gjykata që e kanë mbështetur vendimin e OSHP-së, ju prapë

jeni mbi ligjin, prapë jeni mbi vendimin e OSHP-së, prapë jeni mbi vendimin e gjykatës. Në rregull është. Sa po i kushton kjo buxhetit të Kosovës? Sa po u kushton qytetarëve të Kosovës?

Me burimet e negociuara jemi mësuar t'ju shohim juve, në të gjitha ministrinë, jo vetëm në Ministrinë e Shëndetësisë, po fatkeqësisht në këtë rast edhe në Ministrinë e Shëndetësisë. Ne e dimë shumë mirë se sa e nevojshme janë për pacientët e Kosovës, sidomos ata që kanë ndërlidhshmëri me insulinën. Sigurisht, këtu po preket edhe në emocionin e njerëzve e pacientëve dhe sigurisht edhe në xhepin e tyre, por edhe shëndetit publik.

Këtu po shihet qartë që ministri, nga ardhja e tij tashmë në pushtet, sërish në Ministrinë e Shëndetësisë, e ka një ton pak më ndryshe, pak me një ngjyrë me emocione.

Çfarë lidhshmërie ka i nderuar, kjo kontratë me Martin Berishën, a bën të më tregosh?

**KRYETARI:** Urdhëro, z. Vitia!

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Për besë, z. Lushtaku, po shihet që s'i keni lexuar asnjë, as vendimet e OSHP-së, as vendimet e gjykatave, as asgjë. Po t'i kishe lexuar, nuk e kishe bërë këtë fjalë që e fole, kështu që çka do që them është veç kot, se vetëm po bëjmë muhabet. Këtu nuk kam ardhur për muhabet, po t'i informojë qytetarët e Republikës se si qëndron situata, e para.

E dyta, z. Haxhiu, ju po e shfrytëzoni foltoren e Kuvendit të thoni të pavërteta. Po nuk është e vërtetë që kam nënshkruar asnjë pa autorizim marketing, o z. Haxhiu. Merre sillma këtu, jap përgjegjësi, o z. Haxhiu. Se komisioni për atë punë u bë.

Çka keni gjetur? S'keni gjetur asgjë, z. Haxhiu. Kështu që mos kallëzoni të pavërteta, aman. Mos e helmoni këtë popull, aman. Gëzojuni këtij Ligji për çmime të barnave, se është për popullin, është edhe për juve, se secili prej neve do të kemi raste të tilla.

Edhe një gjë, toni im z. Lushtaku është më emocional. Është shumë më emocional, se natyrisht edhe jam mjek, edhe natyrisht që detyra ime është që t'i kryej detyrat dhe natyrisht që ka shumë emocion në këtë farë pune. Pa emocion nuk mund t'i shtyjë këto. Mirëpo, në momentin kur diçka pres nga ligjvënësit që ta shtyjnë përpara ose t'i gëzohen një diçka, qysh i jemi gëzuar edhe ne si Qeveri shumë vendimeve të mira, po mendoj disa, se s'ka pasur shumë, dorën në zemër, disa vendimeve të mira që kanë qenë më herët, gëzohuni edhe ju.

Udhëzimi administrativ, z. Haxhiu, ka qenë i pazbatueshëm. E kam folur me ish-ministrin. Në mos gaboj, e kam folur edhe me juve. E kam folur me shumë deputetë. Nuk zgjidhet kjo çështje me udhëzim administrativ.

Po fatkeqësia është që për krejt mandatin, zero ligje. Tash, po e bëjmë Ligjin për fertilizimin, Ligjin për shëndetin riprodhues, Ligjin për sëmundjet ngjitëse, Ligjin për çmimet e barnave. Këtë vit Ligji për shëndetësi, Ligji për sigurime shëndetësore, e shumë ligje të tjera që është punë e Ministrisë, punë e Qeverisë, për t'i vënë standardet e duhura në sistemin shëndetësor.

Në fund, the për komisionin disiplinor. Po natyrisht, secili drejtor, secili punëtor shëndetësor pa dallim, i cili tregohet i papërgjegjshëm dhe tregohet jo i duhur në pozitën e vet, ose bën shkelje të detyrave të punës, po natyrisht se do të ketë konsekuencë. Do të ketë konsekuenca edhe për mua, do të ketë konsekuenca për secilin që e shkel ligjin, do të ketë konsekuenca edhe për ata. Prandaj, ju kisha lutur mos më kërkoni më ta shkel ligjin, sepse nuk e shkel ligjin.

**KRYETARI:** Vetëm një minutë z. Haxhiu dhe pastaj kalojmë te znj. Rizvanolli.

**BEKIM HAXHIU:** Për nder, ky ministri i Shëndetësisë qenka bërë nervoz shumë, por ky nuk është këtu për t'u dhënë leksion deputetëve edhe ta shfrytëzojë foltoren e Parlamentin për britma e piskama, kur ne i kërkojmë llogaridhënie. Për çështje të tilla, ky tha komisioni hetimor e ka hetuar dhe ia dorëzuar një material 45 faqe në Prokurorinë e Republikës së Kosovës dhe me të gjitha gjetjet të cilat i thashë.

Po e shfrytëzon foltoren e Kuvendit. Vetëm po ta kujtoj ministër, po kërkon llogaridhënie pse në kohën e PAN-it nuk është miratuar për tetëmbëdhjetë muaj të PAN-it. Po harron që je që dy vjet në Qeveri, zero ligje i ke sjellë në Kuvend. Zero për dy vite. Asnjë prej ligjeve substanciale në Kuvend nuk e ke sjellë. Ky është rezultati juaj. Mund të dalësh e të bërtasësh, e të flasësh të pavërteta, edhe të akuzosh deputetë, çfarë të duash mund të bësh këtu. Ke imunitet aty. Mirëpo, nëse dëshiron t'u drejtohesh qytetarëve, shfrytëzoje Kabinetin qeveritar dhe drejtoju prej Ministrisë së Shëndetësisë. Këtu je për të dhënë llogaridhënie para deputetëve.

**KRYETARI:** Znj. Rizvanolli e ka fjalën. U shterua çështja mendoj.

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Do të flas rreth vetëm disa prej çështjeve që u ngritën sot. Deputeti Shala i tha disa sugjerime në fund. Dua t'ju informoj, deputet Shala, se dje megjithëse ju nuk ishit këtu, u miratua Strategjia e energjisë deri në vitin 2031 dhe drejtimi është i qartë. Drejtimi ka qenë i qartë në fakt që nga qershori i vitit të kaluar kur kjo strategji është publikuar. Madje, ne në ndërkohë kemi filluar të zbatojmë në drejtim, kemi punuar në drejtim të zbatimit të kësaj strategjie.

Vetëm gjatë vitit të kaluar kemi siguruar mbi 440 milionë euro financim për sektorin e energjisë, ku mbi 340 janë grante, mbi 330 janë për investime kapitale. Ndërsa, sivjet lansohet ankandi, i cili do të sjellë nga sektori privat investim prej së paku 75 milionë euro.

Pastaj më erdhi një vendim për kapacitetet ekzistuese. Për kapacitetet ekzistuese, siç e dini ju shumë mirë, gjithashtu janë marrë vendime. KEK-u sivjet do të fillojë 75 milionë euro investime vetëm në Kosovën B për modernizim të turbinave, dilatom të bojlerëve e pastaj prej vitit tjetër duke vazhduar për vendosjen e filtrave, investim prej 80 milionë eurove. D.m.th. vetëm në projektet që i numërova, jemi duke folur për 560 milionë investime, investime që nuk janë bërë për njëzet vitet e fundit. Mjetet ndoshta edhe janë shpenzuar në KEK dhe nga KEK-u, mirëpo investime substanciale nuk ka pasur.

Në fund, thatë: merrni vendim për reformë ligjore. Po besoj që kjo ishte inspiruar nga raportimi im i fundit në komision parlamentar javën e kaluar, ku ju informova se koncept-dokumenti për ligjet e energjisë është i gatshëm dhe tri ligjet kryesore të energjisë: Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Ligji për energjinë dhe Ligji për energjinë elektrike, e kemi në agjendë legjislative sivjet. Ndërsa, gjithashtu e kemi edhe Ligjin për burime të ripërtëritshme të energjisë, i cili po bëhet për herë të parë në Kosovë.

Sido që të jetë, mua më bëhet qejfi kur rekomandimet tuaja janë në përputhje të plotë me punën tonë dhe ne kemi konsensus në sektor të energjisë.

Deputeti Tahiri foli gjatë. Ndër të tjera, tha: ka rënë produktiviteti. Gjithashtu tha: duhet të rriten pagat. Kush ka veç pak lidhje me ekonomi, e di që këto dy gjëra nuk do të duhej të thuheshin brenda një fjalie kurrë. E di që deputeti Tahiri nuk është ekonomist, mirëpo megjithatë meqë foli për këto çështje kisha dashur të di se cilit indikator të produktivitetit po i referohet kur thotë që ka pasur rënie të produktivitetit. Gjithashtu ku është logjika?

KRYETARI: Edhe një minutë për ministren, pra.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Në fund, por jo më pak e rëndësishme, i gëzohem informatës së deputetes Fejza që do të ketë një komision, i cili do të hetojë dhunën ndaj grave dhe punën e institucioneve dhe dështimet e institucioneve, aty ku janë në mbrojtjen e grave ndaj dhunës. Më erdhi keq që dëgjova nga një deputete që nuk ka femicid në Kosovë. Është rast i mirë që ta shohin të gjithë definicionin e femicidit dhe që të gjithë të jemi më mirë të informuar dhe ta luftojmë, ta pranojmë së pari e pastaj ta luftojmë me gjithçka që kemi këtë dukuri në vendin tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ia japim z. Shala, dy minuta. Urdhëro, z. Shala!

FERAT SHALA: Faleminderit kryetar!

E nderuar ministre,

Sinqerisht unë nuk ngrita shqetësim për debat, megjithatë mua do të bëhej qejfi sikur tarifat e energjisë të mos rriteshin dhe qytetarët të mos paguanin. Mua do të bëhej qejfi shumë sikur

sektori energjetik të mos ishte pikë e zezë në kuadër të Bashkimit Evropian, siç na thanë përfaqësuesit e MSI-së bashkë kur ishim me përfaqësuesit e partisë suaj.

Mua do të më bëhej qejfi shumë sikur qytetarët e vendit të mos i shpenzonin apo buxheti i konsoliduar vetëm vitin e kaluar mbi 400 milionë euro subvencionim të kompanive të cilat i keni dhënë. Unë sinqerisht ju rekomandoja, ju dhashë rekomandime dhe ju duhet t'i merrni ato. Do të më bëhej qejfi sikur të mos e kishim ligjin që e ndryshon Ligjin e energjisë, për të vetmen arsye, të legalizojë tenderët njëburimorë dhe tani e sa muaj e kemi në pritje për t'u ndryshuar. Do të bëhej qejfi sikur ta kishim një strategji të mirëfilltë, e cila tash e tre muaj pret.

Mirë keni bërë dje që e keni miratuar, por pa votën tonë, se edhe ne këtu kemi dhënë qëndrimet tona. Është strategji e keqe dhe e pazbatueshme. Nuk zgjidh asgjë. Do të më bëhej qejfi shumë sikur ta shihja sektorin energjetik duke prodhuar e jo A5 në remont me kompani që janë prodhues të dyerve e dritareve. Do të më bëhej qejfi shumë sikur ta shihja B2 me kapacitet çfarë e keni marrë, e jo me kapacitet çfarë realisht e keni sjellë me 60 MW më pak. Do të më bëhej qejfi shumë sikur këto të ishin të pavërteta që po jua them, por fatkeqësisht ky sektor është në gjendje dhe ju rekomandoja çka do të duhej të bënit. Prandaj, merreni rekomandim edhe njerëzor, edhe intelektual, edhe profesional. Nëse keni kundër-argumente, thojini.

**KRYETARI:** Nëse Qeveria nuk ka tema të tjera, kalojmë te pyetjet parlamentare.

Urdhëro dy minuta Ganimete Musliu.

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit kryetar Konjufca!

Prita që po reagoni ju ndaj deklaratës së Arjeta Fejzës, e cila tha që në Kosovë ka femicid. Ju lutem, kujt po i konvenon që ta bëjë shoqërinë tonë shoqëri femicide. Në Kosovë nuk vriten gratë veç pse janë gra. Kuptojeni njëherë e përgjithmonë. Fjala femicid d.t.th. urrejtje ndaj grave me përmasa të mëdha. Ka dhunë ndaj grave, ka që vriten gra, vriten edhe burra, po nuk guxojmë që në këtë Parlament t'i japim emrin femicid. Duhet të jemi të kujdesshëm, sepse shkruhen raporte mbi këtë se çka flasim ne këtu. dhe të trajtohem ne si shoqëri femicide, kjo është e papranueshme.

A jam për t'u dënuar vrasjet në Kosovë? po. A janë për t'u vendosur drejtësi efektive? Po! Por, nuk dua drejtësi selektive. Drejtësia duhet të jetë si për burrat, si për gratë. Prandaj, e them me zë të plotë, që në Kosovë nuk ka femicid. Ka dhunë ndaj grave që duhet ta luftojmë me ligje, norma e rregulla. Mos ta trajtojmë vetëm për pompozitet dhe për fjalë të bukura në Kuvend. Të jemi të kujdesshëm, sepse fjala publike ka peshë. Ne duhet ta mbartim peshën e përgjegjësisë për fjalët që i themi në Kuvend.



KRYETARI: Dëgjoni, kjo është pjesë e dialogut mes Qeverisë dhe deputetëve, jo e deputetëve me njëri-tjetrin.

Urdhëroni, znj. Fejza. Dy minuta!

ARJETA FEJZA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Besoj që edhe nëse e analizojmë prej kontekstit etimologjik fjalën e kemi të qartë se femicidi ka të bëjë me vrasjen ndaj grave. Tani ka diskutime të ndryshme të cilat bëhen në... dhe të cilat e përcaktojnë në masa të ndryshme shtrirjen dhe le të themi kështu përcaktimin në terma të saktë. Mirëpo tendenca për ta relativizuar një dukuri e cila në Kosovë i kemi 66 gra të vrara dhe të themi se gratë në Kosovë nuk vriten vetëm pse janë gra, unë konsideroj që kjo është e papranueshme.

Prandaj, në këtë linjë mendoj se është shumë e rëndësishme që ne të gjitha institucionet e të gjithë aktorët shoqërorë të angazhohemi që sa më shumë të ketë barazi, drejtësi dhe të gjithë mekanizmat përgjegjës, siç e kemi iniciuar dje me komision hetimor, të jenë në krye të detyrës që të sigurohet jeta e grave dhe të ketë trajtim të dinjitetshëm të grave në të gjitha fushat. Kurse, mendoj që s'do mend se në Kosovë ka femicid dhe ka vrasje të grave, sepse janë gra. Faleminderit!

KRYETARI: Nga një minutë atëherë duhet t'jua jap të dyjave.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Unë kisha pas qejf shumë që zonja Fejza të na i paraqiste statistikën e të burgosurve për vrasje, qofshin ata burra, qofshin ato gra. Në Kosovë gruaja i gëzon të gjitha të drejtat, të drejtën e shkollimit, të drejtën e punësimit, të drejtën e votimit, të drejtën e vendimmarrjes.

Ne duhet të punojmë shumë që të zbatohen ligjet në Kosovë. Kosova ka ligje që u garanton grave të drejtat e tyre. Nuk ka femicid në Kosovë. Shoqëria kosovare nuk është shoqëri femicide. Ta kuptoni njëherë e përgjithmonë. Nuk jemi Afganistan as Iran, ne jemi shoqëri demokratike, po jetojmë në mes të Evropës, dhe nuk ka femicid në Kosovë. Është e kotë që mundoheni ta katapultoni shoqërinë tonë me këtë pjesë të shoqërisë.

Ne jemi shoqëri demokratike. E dënoj çdo vrasje, qofshin ato vrasje të burrave, qofshin ato vrasje të grave.

KRYETARI: Zonja Fejza dhe kalojmë tek të tjerat një minutë. A ka diçka tjetër Qeveria. Urdhëro, zonja Haxhiu!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,  
Kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuara media,  
Qytetarë që po na ndiqni,

**KRYETARI:** Qetësi, ju lutem!

**MINISTRJA ALBULENA HAXHIU:** Në fakt, unë nuk do të doja asnjëherë që në këtë foltore të Kuvendit të kemi një deputete, deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ka një qasje të tillë, bën një deklaram të tillë. Sepse në fakt, ata dhunuesit e kriminelët potencialë kur ju dëgjojnë teksa flisni, sigurisht që inkurajohen nga fjala jote.

E nderuar deputete Musliu,

Që nga viti 2000 deri në vitin 2022 kemi pasur kemi 66 gra të cilat janë vrarë nga partnerët apo bashkëshortët e tyre, dhe arsye se pse, është vetëm sepse janë gra. Vetëm sepse burrat konsiderojnë që kanë të drejtë që të bëjnë gjithçka me trupin dhe jetën e grave.

E nderuar deputete,

Unë të pres dhe të ftoj që t'i bashkohesh angazhimit tonë për luftë ndaj dhunës në familje, fenomenit të dhunës në familje dhe femicidit. Po, në Kosovë ka femicid, por në fakt mendësia jote shpërfaq mendësinë e qeverisjes së PDK-së, sikurse edhe qeverisjeve të tjera, sepse asnjë veprim nuk e keni ndërmarrë asnjëherë për ta adresuar dhunën në familje, dhunën në baza gjinore, dhunën ndaj grave, dhe është hera e parë që Qeveria e Republikës së Kosovës po e adreson seriozisht duke marrë veprime konkrete për luftimin e këtyre dukurive.

Po, është e vërtetë, sipas ligjit gratë gëzojnë të drejtën e pronës, trashëgimisë, punësimit, por në praktikë vetëm 14% e grave janë pjesë aktive e tregut të punës. Prandaj, Qeveria po bën përkushtim maksimal, së pari për të pavarësuar ekonomikisht vajzat dhe gratë në Republikën e Kosovës, sepse për shkak të mungesës së pavarësisë ekonomike, vajzat dhe gratë ka raste edhe kur durojnë dhunën, sepse s'kanë kah t'ia mbajnë.

Por, unë prita që ky debat do të bëhet në kohën e interpelancës së ftuar nga PDK-ja, sepse kur është thirrur kjo interpelancë, kemi shikuar që nga 2008-ta veprime që janë ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë për luftimin e këtij fenomeni.

A e dini çfarë kemi bërë? Një Strategji. Dhe, e dini çfarë ka ndodhur me atë Strategji? Asnjëherë s'është zbatuar. Prandaj, unë mendoj që nuk e keni të drejtën që të flisni në atë mënyrë në Kuvendin e Kosovës, sepse kjo po inkurajon dhunuesit. Prandaj, të ndaleni! Nëse s'mund të na ndihmoni, atëherë, heshtni! Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Sinqerisht, të dalë një ministre e Drejtësisë të flasë në këtë formë, nuk do koment, prandaj jemi këtu ku jemi me këtë gjendje të cilën e kemi. Në Afrikë të Jugut vriten vajza edhe gratë në rrugë, veç pse janë gra dhe vajza. Dhe, në Afganistan mund të themi që ka edhe femicid. Unë, sikur të isha në vendin tuaj zonja Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë dhe të dali një deputete e grupit parlamentar timin dhe të kërkojë Komision Hetimor Parlamentar për dhunën ndaj grave, unë sot do të kisha dalë dhe do të kisha dhënë dorëheqje, sepse nuk jam duke e kryer punën qysh duhet si ministre.

Prandaj, keni kujdes, unë nuk e kam shpikur fjalën femicid, as ju s'e keni shpikur fjalën femicid, hyni dhe lexoni. Po flasim për vrasjen e grave vetëm pse janë gra. Më falni, a është nëna grua? A është motra grua? A është mësuesja grua? Prandaj, ju lutem shumë, të keni kujdes kur përdorni terminologji për t'u dukur high class. E keni gabim.

Tendenca për ta shpallur shoqërinë kosovare shoqëri femicide, është e rrezikshme. Kujt po i konvenon ky trend? Është bërë sakrificë në këtë vend. Asnjëherë në asnjë proces gjyqësor nuk është thënë që një grua është vrarë vetëm pse është grua, por janë rrethanat që e kanë sjellë deri te vrasja. Dhe e thashë edhe njëherë, a jam për dënimin maksimal të vrasësve të grave dhe të burrave? Jam. Por, nuk pranoj në këtë Kuvend të ulem dhe të hesht kur dikush tenton ta bëjë shoqërinë tonë shoqëri femicide.

KRYETARI: E kryem këtë debat tash dalim te pyetjet parlamentare. E keni gabuar qëllimin e kësaj pjese. Gabimisht e keni... Po mendojnë këto që është pjesë ku debatojnë deputetët me njëri-tjetrin. Nuk është kështu kjo pjesë. Nuk është e paraparë me Rregullore kështu. Nuk mund ta çojë dorën një deputet që s'ka folur në deklarime jashtë rendit të ditës, e t'i përgjigjet një deputetit që po i përgjigjet Qeverisë. A po e kupton, është krejt huqje e kësaj teme.

Kjo është flasin, ministrja ose Qeveria, kryeministri me deputetin. Kryhet aty edhe vazhdojmë me tema të tjera. Kalojmë te pyetjet parlamentare.

### **3. Pyetjet parlamentare**

Deputeti Mërgim Lushtaku pyetje për ministrin Xhelal Sveçla. Nuk është ministri këtu.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetar!

I kisha lutur deputetët për qetësi nëse ka mundësi! A mund të vazhdoj kryetar?

KRYETARI: Urdhëro-urdhëro, Mërgim!

MËRGIM LUSHTAKU: Në rregull! Kryetar, ju jeni të informuar realisht që ministri Sveçla që disa herë i shmanget kësaj pyetjeje. Unë i bëj thirrje edhe kryeministrit që ta gjejë ministrin e Punëve të Brendshme dhe ta kthejë për raportim dhe llogaridhënie në Kuvendin e Kosovës.

KRYETARI: Deputetja Rrezarta Krasniqi e ka pyetjen për zëvendëskryeministren Donika Gërvalla-Shvarc. Nuk është këtu. Herën tjetër. Deputetja Time Kadrijaj për po të njëjtën zëvendëskryeministre. Nuk i paskemi këtu të dyja.

Deputetja Shqipe Mehmeti-Selimi pyetje për ministrin Sveçla. Nuk është këtu. Deputeti Agon Batusha pyetje për ministrin e Kulturës, Hajrulla Çeku. Urdhëro! Nuk e kemi këtu ministrin.

AGON BATUSHA: I nderuar kryetar,

Kemi biseduar me ministrin, do të ma kthejë përgjigjen me shkrim. Çështja ka qenë për 1 300 dosje të Zyrës së Burgosurve Politikë dhe të Zhdukurve me Dhunë në Gjakovë. Zyra është në gjendje të keqe, dosjet janë në rrezik dhe kemi biseduar me ministrin. Tani do ta marr edhe përgjigjen me shkrim se si do t'ia bëjmë me ato dosje.

KRYETARI: Deputeti Shemsedin Dreshaj e ka pyetjen për ministrin Liburn Aliu. Nuk e kemi këtu ministrin. Deputeti Arijeta Rexhepi pyetje për ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Urdhëroni!

ARIJETA REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Delikuenca e të miturve është dukuri shoqërore e cila po manifestohet edhe në vendin tonë me mosrespektimin e normave morale dhe juridike. Ky fenomen shqetësues, atë të përfshirjes së miturve në vepra të ndryshme penale, po preokupon të gjithë shoqërinë.

Përveç dënimit të shqiptuar për të miturit që janë në konflikt me ligjin, rëndësi të veçantë ka më pastaj integrimi dhe rehabilitimi i tyre.

E nderuara ministre Haxhiu,

Pasi që në detyrën tuaj përveç infrastrukturës ligjore, tani i keni edhe shërbimet sociale, a mund të na njoftoni se çka keni ndërmarrë për të miturit, të cilët bien ndesh me ligjin, duke pasur parasysh fazën e parandalimit deri tek integrimi i tyre në shoqëri pas kryerjes së ndonjë vepre penale nga të miturit? Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, zonja Haxhiu!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Vazhdon të mbetet e papranueshme qasja e zonjës Musliu, më falni që po e përdor këtu. Sepse ju në njëfarë forme arsyetuat vrasjet ndaj grave.

KRYETARI: Të lutem, zonja Haxhiu nëse mund të merreni me pyetjen!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Jeni e papërmirësueshme zonja Musliu. Njësoj keni vepruar edhe në kohën kur kemi proceduar Projektligjin për njohjen e statusit të grave të dhunuara gjatë luftës. Njësoj keni vepruar. Prandaj, jeni e papërmirësueshme.

KRYETARI: Të mos e keqpërdorni zonja Haxhiu!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Atëherë, e nderuara deputete Rexhepi, faleminderit për pyetjen!

Më lejoni t'ju njoftoj që bazuar në mandatin ligjor dhe obligimet që derivojnë nga kompetenca e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, ministria dhe njësitë përkatëse përmes mekanizmave janë përgjegjëse për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë, dhe siguron që të gjithë fëmijët në gjendje të nevojës sociale të kenë qasje të pabarabartë në shërbime sociale dhe familjare pa asnjë dallim, as nga e racës, përkatësisë etnike, gjininë, gjuhës, religjionit apo ndonjë përkatësie tjetër.

Dhe, më lejoni t'ju njoftoj që në vitin 2021 janë ofruar shërbime për gjithsej 427 fëmijë që kanë në konflikt me ligjin, ndërsa në vitin 2022 bazuar në të dhënat e Departamentit për Politika Sociale dhe Familjare janë ofruar shërbime për gjithsej 579 fëmijë në konflikt me ligjin.

Natyra e shërbimit social për këta të mitur varet nga natyra e veprës dhe nevoja e palës për shërbim. Megjithatë, pavarësisht vullnetit të qendrave për punë sociale për të kryer të gjitha shërbimet, ne duhet të theksojmë faktin se këto qendra që nga koha kur është bërë decentralizimi i shërbimeve, nuk kanë marrë vëmendjen e duhur nga niveli komunal. Pra, qeverisja lokale, institucionit të cilit edhe i takon.

Si rezultat i kësaj, ne kemi nisur së fundmi, në janar të këtij viti, një politikë reformuese përmes së cilës pretendojmë të kthejmë vëmendjen institucionale në shërbime sociale, por edhe në shërbimet familjare. Si ministre, e kam formuar një grup punues, i cili do të analizojë dhe hartojë një raport mbi nevojat, vështirësitë, por edhe problemet me të cilat ballafaqohen qendrat për punë sociale, në mënyrë që të hartojmë politika të cilat do t'i fuqizojnë qendrat për punë sociale. Dhe, sigurisht që urojmë që ta kemi edhe mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës në kohën kur e procedojmë Projektligjin për shërbimet sociale, i cili është në agjendën legjislativë dhe është një reformë e madhe në qendrat për punë sociale.

Po ashtu, më lejoni t'ju njoftoj që në vitin 2021 kemi nënshkruar dy udhëzime administrative për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve, kryes të veprave penale nën moshën e përgjegjësive penale, por po ashtu edhe udhëzimin administrativ për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile, por edhe administrative. Faleminderit!

KYRETARI: Veç pak! Po ka të drejtë, sepse zonja Haxhiu nuk pati të drejtë të flasë ashtu. Urdhëro! Jo, jo të dyja nga një minutë. Ti e the fjalën tënde edhe Ganja do ta thotë të veten. Urdhëroni! Të mbyllet ky muhabet edhe të mësohemi për të tjera herë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar! Në bazë të asaj se çka po thotë ministrja sot në këtë vend, unë qysh sot kërkoj nga shteti që të më ofrojë ndihmë edhe të më mbrojë, sepse edhe unë jam një grua.

Petku i deputetes nuk më mbron mua nga fenomeni femicid që qenka pjesë e shoqërisë sonë. Prandaj, unë publikisht kërkoj nga ministrja e Drejtësisë, nga ministri i Punëve të Brendshme, nga kryeministri i vendit, nga të gjithë që janë përgjegjës, që mua sot më ofrojnë siguri, sepse del dikush dhe më vret veç pse jam grua, në sheshin e Prishtinës.

Nëse mund të vijmë në këtë përfundim që e tha ministrja e Drejtësisë që është tmërri, tmërri, tmërri i përfaqësimit institucional dhe mesazhi që e jep nga kjo foltore sot. Në Kosovë thotë, vriten gratë veç pse gra. Hej, kthjelluni!

KRYETARI: Deputetja Arijeta Rexhepi e ka pyetjen për ministrin Liburn Aliu. Nuk është ministri këtu. Deputeti Bekim Haxhiu pyetje për ministrin Arben Vitia.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Më datë 14 shtator, Qeveria e Kosovës themeloi Komisionin Ekzekutiv për Shëndetësi me këtë përbërje: kryeministri i Kosovës, kryesues, ministri i Shëndetësisë, anëtar, ministri i Financave, anëtar, ministrja e Arsimit, anëtare, zëvendësministrja e Shëndetësisë, anëtare, zëvendësministri i Shëndetësi, anëtar, Sekretari i Përgjithshëm, anëtar, këshilltari për shëndetësi i kryeministrit, anëtar, këshilltari për teknologji, informacione i kryeministrit, anëtar, zëvendësuesja e drejtores së SHSKUK-së, anëtare, dhe kryetarja e Bordit të SHSKUK-së, anëtare.

Me rastin e themelimit të këtij Komisioni Ekzekutiv për Shëndetësi u tha së ka këto përgjegjësi:

1. Të bëjë analizën dhe definimin e ndarjes dhe bashkëpunimit publiko-privat në shëndetësi,
2. Zhvillimin e sistemit informativ në shëndetësi, me theks për atë të sigurimeve shëndetësore,
3. Reformimi e SHSKUK-së përmes fuqizimit të QKUK-së dhe spitaleve rajonale,
4. Zhvillimi i sektorit publik të shëndetësisë në kuptim të ngritje së kapaciteteve e shërbimeve dhe kujdesit

shëndetësor, 5. Themeli i Spitalit Rajonal të Prishtinës dhe 6. Ndërveprimi me 5 odat e profesionistëve shëndetësorë.

Pyetja ime për ministrin e Shëndetësisë, shpresoj që të përgjigjet me qetësi e pa nervoz: a është ende funksional Komisioni Ekzekutiv për Shëndetësi? Nëse Komisioni Ekzekutiv për Shëndetësi është funksional a ka realizuar ndonjëherë nga përgjegjësitë që janë prezantuar pas takimit të parë të këtij komisioni?

KYRETARI: Urdhëro, zoti Vitia!

MINISTRI ARBEN VITIA: I nderuari deputet Haxhiu,

Faleminderit për pyetjen! Atëherë, siç e dini, ky komision është akoma aktiv dhe ka kryer detyrat e veta konform përgjegjësisë të cilat i ka pasur. Më lejoni vetëm t'i numëroj. Në pikën e parë është bërë Rregullorja për shtesat për profesionistët shëndetësorë për ata që punojnë vetëm në sektorin publik. Është bërë rritja e kapaciteteve monitoruese përmes rritjes së numrit të inspektorëve që tash do të dalë konkursi për 42 të tillë. Dhe, tema të tjera të cilat kanë ardhur si rekomandime dhe do të adresohen në ligjet, si Ligji për shëndetësi dhe Ligji për sigurime shëndetësore që këtë vit do të finalizohen.

Në pjesën e dytë, sa i përket SISH-it ka vazhduar puna në fuqizimin e SISH-it, duke filluar nga kujdesi parësor shëndetësor, si zonimi, i cili do të lancohet fillimisht në katër komuna me synim që secili qytetar ta përzgjedh mjekun familjar. Dhe, në qershor të këtij viti do të përfundojë edhe studimi i fizibiliteti për SISH-in dhe në bazë të rekomandimeve finale do të investohet dhe implementohet në tërë sistemin shëndetësor, përfshirë edhe atë privat.

Sa i përket pikës së tretë. Natyrisht, është duke u bërë dhe në fazën finale statuti i SHSKUK-së dhe shumë shpejt do të nënshkruhet dhe si derivat i tij është duke u hartuar edhe statuti i QKUK-ë.

Gjithashtu, spitalet e përgjithshme, është plani afatshkurtër dhe afatmesëm për këto spitale, plan i detajuar dhe i kostuar me vlerë mbi 40 milionë euro. Është në hartim dhe të përfundojë gjatë këtij muaji plani i resurseve humane në shëndetësi dhe me këtë do të përmbillet edhe me Strategjinë sektoriale për shëndetësi për periudhën 2023-2032 që do të përfundojë, po ashtu në fund të këtij muaji ose në fillim të muajit prill.

Sa i përket pikës së katërt, të zhvillimit të sektorit publik. Natyrisht, të gjitha këto shkojnë me dokumente paraprake, si plani i resurseve humane, gati duke u kryer, plani investiv, tashmë i nënshkruar, Strategjia sektoriale e shëndetësisë përfundon në muajin prill, statutet e SHSKUK-së dhe QKUK-së që janë në fazën përfundimtare, udhëzimi administrativ për shkollim specialistik

që do të nënshkruhet javën e ardhshme dhe udhëzimi administrativ për profesionistë të huaj shëndetësorë.

Përveç të tjerash, vetëm desha ta komentoj edhe këtë të fundit. Ky komision ka vazhduar takimet e pandërprera që të gjitha takimet që i kanë pasur publike, takime në mes të palëve për të dhënë këto rekomandime, të cilat në një mënyrë me shkrim ose në mënyra të tjera më janë dorëzuar mua, dhe të gjitha këto janë duke u pasqyruar në gjithë legjislacionin, por edhe në veprime të tjera që është duke i marrë Ministria e Shëndetësisë.

Dhe, me përfundimin e këtyre dokumenteve strategjike, natyrisht nuk do të ketë nevojë edhe për komisionin, dhe do të diskutohet edhe për pushimin e funksionimit të këtij komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Haxhiu, pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Ju e dini që në fillim mbledhjet e këtij komisioni kanë qenë transparente dhe publike dhe është raportuar çdoherë, mirëpo prej se ka dhënë dorëheqje Rifat Latifi do të thotë më nuk ka asgjë sa i përket këtij komisioni. E ka përbushur misionin që ta detyrojë Rifat Latifin të dorëhiqet.

Mirëpo, po çështja që mua më intereson, i nderuar ministër, është se në ueb-faqen e Qeverisë është i publikuar një program qeverisës për sektorin e shëndetësisë, dhe kur ju keni premtuar reformim të sektorit të shëndetësisë, keni premtuar shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta për të gjithë qytetarët e vendit, ndërsa në ditë dështojnë nga 15-20 operacione.

Keni premtuar zhvillim të sistemit shëndetësor, ndërsa kemi stagnim. Keni premtuar Strategji të re të shëndetësisë, e tani 2 vjet punojmë pa Strategji. Keni premtuar riorganizim të sektorit të shëndetësisë, asgjë nga ky premtim. Keni premtuar rishikim të kornizës ligjore në sektorin e shëndetësisë, për 2 vite zero ligje të sjella nga Qeveria në Kuvendin e Kosovës për sektorin e shëndetësisë. Pra, do të kujdeseni, keni thënë, për grupet e cenueshme në shoqëri...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Zoti Haxhiu urdhëro, veç përmbyle!

BEKIM HAXHIU: Shumë shkurt!

Tani, a do t'u përmbaheni deklarimeve të Komisionit Ekzekutiv me ato 5-6 pikat apo do t'i përmbaheni plani të Qeverisë për sektorin e shëndetësisë? A do të thotë kjo që keni hequr dorë nga plani i Qeverisë dhe tani i keni ndryshuar objektivat me këtë Komision Ekzekutiv për të justifikuar dështimin tuaj?



KRYETARI: Urdhëroni, ministër Vitia! Ministri e ka fjalën.

MINISTRI ARBEN VITIA: I nderuari profesor doktor i fizioterapisë, zoti Bekim Haxhiu, Ashtu siç thashë edhe më herët, të gjitha këto pika janë në kuadër të programit tonë qeverisës dhe të gjitha këto pika janë adresuar dhe tani të gjitha këto do të reflektojnë në të gjitha ato që i përmenda më herët që të mos përsëritëm.

Përndryshe, po jua rikujtoj edhe njëherë. Fatkeqësi ka qenë, jo vetëm te ne, në gjithë botën që për dy vjet pandemia COVID-19 natyrisht se ka stagnuar në shumë sfera, duke përfshirë sidomos atë të shëndetësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Haxhiu, fjalën përmbyllëse!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Qëllimi im ishte të kem një informacion se a do të zbatohet plani i Komisionit Ekzekutiv apo programi i miratuar i Qeverisë. Prandaj, i nderuar doktor i përgjithshëm, kandidat për specializim që 18 vjet, kërkova një përgjigje.

Çfarë të them, zoti Vitia, që 18 vjet një specializim s'ke qenë në gjendje ta kryesh. Uroj të punosh në sektorin privat më shumë herë si distributor, herë si koordinator për cilësi, por çfarë cilësie po e shohim të gjithë.

KRYETARI: Ministër, pse s'po e kryen doktoratën si Bekimi edhe ti?! Urdhëro, zoti Haxhiu! E keni pyetjen tjetërën për ministrin Vitia.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Shëndetësisë të gjithë duhet ta shikojmë si tërësi. Është e vërtetë që edhe Qeveria edhe Ministria e Shëndetësisë është duke i diskriminuar fizioterapeutët. E kam zgjedhur profesionin e fizioterapisë me vullnet me dëshirë për t'i ndihmuar qytetarët në rehabilitim dhe trajtim, por nuk ka pasur të drejtë Qeveria që t'ua humb edhe akreditimin e programeve të fizioterapisë dhe t'i ndëshkojë fizioterapeutët me Ligjin e pagave vetëm kanë zgjedhur të jenë fizioterapeutë.

Është e padenjë nëse një gjë të tillë e bëjmë edhe për profesionet e tjera. Ta zëmë, nesër një kryeministër vjen edhe t'i ndëshkojë inxhinierët e elektros vetëm se Albin Kurti është inxhinier ose pse dikush është mjek. Kjo është diskriminuese për profesionet shëndetësore. Uroj që të gjithë të marrim mësim, i nderuar ministër, nga këto lëshime të kësaj Qeverie.

I nderuar ministër, më 30 shtator, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Udhëzimin administrativ për licencimin e profesionistëve shëndetësorë të huaj. Me këtë Udhëzim administrativ rregullohen procedurat dhe kushtet e marrjes së licencës së profesionistëve shëndetësorë të huaj për ofrimin e

kujdesit shëndetësor. Është thënë se Udhëzimi administrativ do të lehtësojë angazhimin e profesionistëve të huaj në ofrimin e shërbimeve në sistemin tonë shëndetësor. Në fillim të majit nëntor Ministria e Shëndetësisë ka bërë publike këtë çështje. Prandaj, për shkak të minutazhës më lejoni të lexoj vetëm pyetjen, sepse besoj që e keni të shkruar.

Pas miratimit të Udhëzimit administrativ për licencimin e profesionistëve shëndetësorë të huaj, sa është numri i mjekëve që janë kthyer për të punuar nga mërgata në institucione publike shëndetësore me kontrata të rregullta pune dhe sa është numri i mjekëve nga mërgata që janë angazhuar në institucione private shëndetësore pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ?

**KRYETARI:** Fjala juaj, ministër, për t'u përgjigjur.

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar profesor doktor i fizioterapisë, zoti Haxhiu, ju përgëzoj për modestinë tuaj, sepse zakonisht profesor doktorët preken kur nuk u përmendet titulli, kurse sinqerisht po më vjen mirë që ju jeni kaq modest, pa hyrë në detaje të tjera.

Udhëzimi administrativ tashmë ka hyrë në fuqi dhe i rregullon dhe i lehtëson tej mase procedurat e licencimit të profesionistëve të huaj shëndetësorë. Synim i këtij udhëzimi është që eksperiencat e mjekëve, sidomos drejtimet specialistike dhe subspecialistike, si në nivelet akademike dhe profesionale, që të vijnë në Kosovë me përvojat e tyre të na ofrojnë edhe trajnime, edhe trajtime në nivele të ndryshme të sektorit tonë shëndetësor.

Lehtësimi i procedurave me këtë Udhëzim administrativ hap rrugët për kuadro tona, sidomos për specializantët gjatë shkollimit specialistik në kuptimin që mjekë specialistë nga mërgata mund të angazhohen në aftësimin profesional dhe akademik të specializimit.

Për informatën tuaj, në pyetjen tuaj, deri tani janë 23 mjekë, të cilët kanë shprehur gatishmërinë dhe kanë dërguar të gjitha informatat që të vijnë për të trajnuar dhe për të dhënë edhe trajtime në sistemin publik dhe jemi duke punuar bashkë me SHSKUK-në që t'i akomodojmë në vendet ku ka më së shumti nevojë, kurse sa i përket sektorit privat, prej kur ka hyrë ky Udhëzim administrativ janë 6 specialistë që kanë ardhur në sektorin privat. Faleminderit!

**KRYETARI:** Zoti Haxhiu, pyetje shtesë mund të bëni.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, ministër, edhe për respektin që po e tregoni ndaj meje.

Po besoj që ky reflektim juaj të pasojë edhe te kryeministri që të më adresohet njëjtë sikur ju, jo me terma pezhorativë që ka folur këtu në Kuvend për profesionin e fizioterapisë.

Prandaj, lejo që, për çështjen të cilën mendoj është shumë në interes të qytetarëve që ka të bëjë me profesionistët e huaj shëndetësorë, e konsideroj që ne duhet të mbrojmë fillimisht edhe të ruajmë kuadrin që kemi në Kosovë, sepse ky Udhëzim administrativ deri më tani vetëm është në shërbim të sektorit privat, ndoshta rastis që tre mjekët e parë kanë filluar punën në kompaninë, ku ju keni punuar në Oliva, dhe nuk kemi pasur kontrata të rregullta pune në sektorin publik, uroj që intenca është të mbështetet sektori publik dhe jo atë privat.

**KRYETARI:** Urdhëroni, zoti Vitia në përgjigjen shtesë!

**MINISTRI ARBEN VITIA:** Faleminderit, profesor!

Natyrisht që ky Udhëzim administrativ është për të lehtësuar kuadrot tona shqiptare nga mërgata që të vijnë në Republikën e Kosovës.

Një pjesë e tyre, thashë përmbi 20 tani më janë paraqitur dhe jemi duke i akomoduar që të vijnë këtu bashkë për atë çka thatë ju, sepse t'ju rikujtoj, deputetë të nderuar dhe profesor doktor Haxhiu që një nga arsyet nuk janë etëm mjekët që ikin vetëm për shkak të rrogave, një nga arsyet është pamundësia për zhvillimin e tyre profesional.

Prandaj e përmenda më parë, mendoj që edhe kjo është një çështje për t'u gëzuar, se edhe me ndihmën e mjekëve shqiptarë jashtë Kosovës ka filluar edhe është funksionalizuar Laparaskopia në Urologji dhe ky është edhe qëllimi ynë çdo herë që të forcohet vetëm sektori publik.

Për atë çka thatë ju në raport me sektorin privat dhe me mua personalisht, besoj që edhe ju e dini përgjigjen, mirëpo le të jetë në tuajën si doni të besoni. Faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëroni, deputet, e keni mundësinë që ta përmbyllni këtë diskutim.

**BEKIM HAXHIU:** Ky çka thashë unë ka qenë një informacion i publikuar në media që tre mjekët e parë në janar kanë filluar nga diaspora punën në kompaninë Oliva, nuk kam asgjë kundër. Mirëpo, Udhëzimi administrativ duhet të shërbejë dhe të fokusohet për të ruajtur ose për të mbështetur ata që dëshirojnë të punojnë dhe ta forcojnë sektorin publik. Deri më tani ne po shohim që ky Udhëzim administrativ është duke u shfrytëzuar dhe përdorur më shumë nga sektori privat.

Prandaj, qëllimi im është, një për të ruajtur këtë sektor këtu dhe pastaj këta që i kemi, profesionistët shëndetësorë, duke i mbështetur ata këtu dhe jo për qëllime biznesore, nëse dëshironi edhe të tregoj marrëveshjet ku i keni bërë, në cilat kafene të Gjermanisë, jua them edhe atë, nuk e kam asnjë problem. Prandaj, ka pasuar ky Udhëzim administrativ nga Qeveria për të mbështetur bizneset në sektorin privat. Ka rënie të operacioneve në sektorin publik, një shtim të operacioneve në sektorin privat në dy vjetët e fundit, kjo është e vërteta.

KRYETARI: Dalim te pyetjet të cilat shtrohen për herë të parë. Deputeti Mërgim Lushtaku ia bën pyetjen ministrit Liburn Aliut, të cilin nuk e kemi këtu.

MËRGIM LUSHTAKU: Po, faleminderit, kryetar!

Fatkeqësisht prapë ministrat nuk janë në krye të detyrës dhe nuk vijnë të prezantojnë përgjigjen dhe të japin llogaridhënie jo vetëm para deputetëve...

KRYETARI: Jo, qenka për ministren Nagavci.

MËRGIM LUSHTAKU: Për ministren Nagavci, për ministrin e Shëndetësisë ka të bëjë me përdorimin e drogës në shkollat parauniversitare dhe shqetësimin dhe informatat që i kërkoj nga Ministria e Arsimit për parandalimin, por që sigurisht që edhe luftimin e kësaj dukurie.

Sigurisht do ta parashtrij në një seancë tjetër, kur edhe ministrja është prezente.

KRYETARI: Tash deputeti Elmi Reçica e ka pyetjen për ministren Rozeta Hajdari.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të nderuar,

E nderuar ministre Hajdari,

Dua të dal veç në disa çaste jashtë pyetjes. Ne pyetjet, kryetar, i parashtrijmë si deputetë, nuk është mirë të bëjnë hajgare ministrat, profesor doktor, e çështje të tjera, ne i parashtrijmë si deputetë këtu, është mirë të përgjigjen si deputetë dhe të mos devijojnë rrugën, po është mirë t'i përmbahen asaj, se këtu parashtrijmë pyetje në cilësinë e deputetit, kështu që unë në cilësinë e deputetit ia parashtrij këtë pyetje zonjës Hajdari.

Çështja ka të bëjë me rezervat shtetërore të mallrave.

A janë përfillur procedurat ligjore dhe a është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës gjatë kontraktimit apo blerjes së rezervave shtetërore të mallrave nga ana e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Zonja ministre, çështja e rezervave shtetërore të mallrave është sensitive dhe me peshë. Si e tillë duhet të trajtohet edhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me seriozitet dhe përgjegjësi të lartë.

Paralel me këtë është e rëndësishme të respektohen dispozitat juridiko pozitive në lidhje me kontraktimin apo blerjen e tyre, duke pasur për bazë Ligjin numër 03/L-244 për rezervat shtetërore të mallrave.

Prandaj, zonja ministre, a mund të na thoni nëse janë përfillur procedura ligjore dhe nëse është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës gjatë kontraktimit apo blerjes së rezervave shtetërore të mallrave nga ana e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

KRYETARI: Zonja Hajdari, urdhëroni për t' u përgjigjur!

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: I nderuar kryeparlamentar,

Kryeministër,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për pyetjet, i nderuar deputet Reçica,

Lidhur me pyetjen tuaj për rezervën shtetërore më lejoni t' ju njoftoj dhe të konfirmoj po ashtu se gjatë blerjes së rezervave shtetërore të mallrave nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë janë përfillur të gjitha procedurat ligjore dhe me kompetencë të plotë ju them se nuk është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 13 i Ligjit që ju apostrofoni për rezervën shtetërore, pra të Ligjit 03/L-244, në paragrafin 1.1 thuhet se “rezervat shtetërore të mallrave krijohen nga buxheti i Republikës së Kosovës” dhe buxheti i ndarë për rezervën viteve të kaluara për fat të keq kishte qenë fare simbolik. Prandaj, Qeveria me prioritet të lartë ka marrë parasysh rritjen e buxhetit të rezervës shtetërore.

Kryesisht kemi trashëguar në vitin 2021 vetëm 350 mijë euro për buxhetin e rezervës shtetërore, kurse Qeveria Kurti në vitin 2022 ka rritur për 10 milionë euro rezervën shtetërore dhe për vitin 2023 15 milionë euro rezervën shtetërore.

Prandaj, meqë konsiderohet informatë e klasifikuar sensitive, ashtu siç ju e thoni, unë vetëm mund t' ju them, si dhe të gjithë qytetarëve se gjendja e rezervës shtetërore në momentin kur ne e kemi marrë qeverisjen ka qenë në nivel shumë të ulët, ndërkaq sot është në nivel optimal dhe është një storie suksesi për qeverisjen Kurti.

Pse, e them këtë, sepse kur e mora mandatin në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, unë gjeta një plan që ishte për tre vjet me buxhetin kërkesë për 7.5 milionë euro, por nga Qeveria Hoti nuk ishte përkrahur më shumë se 350 mijë euro për vitin 2021. Prandaj, kemi realizuar planin e tre vjetëve të Qeverisë Hoti, për një vit me 10 milionë euro dhe 15 milionë euro për vitin 2023, është storie e suksesit, sepse kemi dashur ta ruajmë sigurinë kombëtare, të ruajmë qytetarin, por edhe të përshtatemi në situatën që ishim me luftën në Ukrainë kur duhet të sigurojmë qytetarin e Republikës sonë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Reçica, pyetje tjetër për ministren.

ELMI REÇICA: Kam një pyetje plotësuese dhe që është shumë konkrete, kryetar, faleminderit! Unë e kam këtu një faturë të datës 9 mars 2022, faturë e një ndërmarrjeje turke, prej së cilës ju si ministri keni blerë grurë me çmim më të lartë se sa çmimi i tregut. Në kohën kur është bërë kjo blerje prej 10 tonësh, mars 2022, në bursa ndërkombëtare çmimi i grurit ka qenë vetëm 38 centë për kilogram, ndërsa ju në atë kohë i keni paguar 48 centë për një kilogram. Çka do të thotë kjo për ju si ministri dhe juve personalisht si ministre që 10 centë e keni paguar më shtrenjtë për kilogram dhe keni dëmtuar buxhetin e shtetit për 1 milion euro, në bazë të kësaj fature. A mund të më përgjigjeni rreth kësaj çështjeje që është shumë konkrete.

KRYETARI: Urdhëroni, ministre, ishte një pyetje konkrete shtesë.

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: I nderuar deputet Reçica, Gjatë vitit 2022, gjatë tërë vjeshtës ne kemi pasur dy shpallje publike për ofertues nga prodhues vendorë për grurin dhe nuk kemi marrë asnjë ofertë. Kur krisi lufta në janar 2022 në Ukrainë, ne kishim rezervën shtetërore në nivel minimal dhe për këtë kemi marrë procedurën sipas ligjeve në fuqi. Me vendimin e Qeverisë jemi obliguar që të sigurojmë rezervën me negociim direkt në import të grurit nga Ukraina, nga Franca dhe vende të tjera, kurse rezervat e tjera shtetërore, që janë vaji, sheqeri, kripa janë edhe nga vendi, Republika e Kosovës, por edhe nga operatorët ekonomikë lokalë. Ju mund të vlerësoni për çmimet e për të tjera, por kur kemi joofertues gjatë vjeshtës 2021 dhe në janar 2022 është dashtë të marrim veprim me procedura të drejtpërdrejta për shkak të luftës në Ukrainë dhe mbylljes së kufijve. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo ishte përgjigjja shtesë, zoti Reçica, mund ta përmbyllni këtë, të jepni një epilog.

ELMI REÇICA: Meqenëse i ngatërroi ministrja vitet, për vitin 2021 s'keni qenë, po në fund jeni duke menduar për vitin 2022, thatë në fund të 2021, po kjo është çështje juaj.

Unë e kam këtu një deklaratë të kryetarit të Shoqatës së Mullisëve të Kosovës që ka deklaruar se kompania në fjalë, e kam unë faturën, që është kompani turke dhe që ju faktikisht ia keni humbur buxhetit të Kosovës 1 milion euro, nuk e njih fare dhe ju nuk u përgjigjët pse e keni bërë këtë.

Lufta në Ukrainë nuk është as arsyetim, as fshehje para dështimeve. Unë kërkova diçka shumë konkrete dhe ti u përgjigje me luftën në Ukrainë dhe me ofertë tjetër, unë pata fjalën rreth kësaj kontrate dhe kjo është e zeza në të bardhë dhe e dëshmuar, plus kryetari i Shoqatës profesioniste të mullisëve ka deklaruar që nuk e njih këtë kompani dhe këtu po shihet që ka keqpërdorim, ministre.

Ne kemi kërkuar si grup parlamentar shkarkimin tuaj, mandatarin, kryeministri...

*(Ndërprerje nga regja)*

KRYETARI: Jo, nuk mundesh më, është e fundit kjo, kështu është Rregullorja e Kuvendit!  
Po tash i njëjti deputet e ka pyetjen për ministrin Mehaj, nuk e kemi ministrin këtu. Urdhëro!

ELMI REÇICA: E kam një pyetje rreth trashëgimisë së Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Ne e dimë që faktikisht Trupat e Mbrojtjes së Kosovës janë në vazhdimësi e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, qysh është FSK-ja ose ushtria e tashme. Dhe realisht ne jemi fatkeqësisht të njohur se pak e ruajmë trashëgiminë tonë dhe pyetja ka të bëjë me këtë çështje. Mirëpo do ta shfrytëzoj të drejtën që në seancën e radhës nëse ministri është këtu, t'ia parashtroj pyetjen dhe të marr përgjigjen prej tij. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Deputeti Luan Aliu e ka pyetjen për ministrin Libur Aliu, nuk e kemi këtu ministrin, herën tjetër.

Deputetja Arjeta Fejza pyetje për Hajrullah Çekun, kur të vijë ministri.

A i keni pasur, e nderuar deputete, dy pyetje për të njëjtin ministër? Mirë!

Deputeti Driton Selmanaj, pyetje për kryeministrin. Urdhëroni, zoti Selmanaj!

DRITON SEMANAJ: Faleminderit!

I nderuar kryeministër,

Në njërën nga pikat e marrëveshjes së Uashingtonit të nënshkruar më 4 shtator 2020 në Shtëpinë e Bardhë thuhet: “Palët janë pajtuar që të punojnë me Departamentin Amerikan të Energjisë dhe subjekte të tjera të Qeverisë amerikane, në një studim fizibiliteti me qëllim të përdorimit të përbashkët të liqenit të Ujmanit, si furnizues i sigurt i ujit dhe energjisë”.

Më 23 qershor 2021 ju është dorëzuar dhe publikuar raporti final i fizibilitetit për liqenin e Ujmanit, i përgatitur nga Departamenti Amerikan për Energjinë. Tri ditë pasi keni pranuar këtë raport, keni deklaruar për media se ende nuk e keni lexuar dhe se sapo ta lexoni, do të jepni përgjigje. Edhe pas 21 muajsh nuk keni dhënë asnjë përgjigje për përmbajtjen e këtij raporti.

Pyetja: zoti kryeministër, cili është vlerësimi i Qeverisë së Kosovës për këtë raport dhe a cenon sovranitetin e Republikës së Kosovës studimi i fizibilitetit për liqenin e Ujmanit, i përgatitur nga mbrojtësi më i madh i sovranitetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Kurti!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Së pari, raporti në fjalë në tërësi flet për Ujmanin në kontekst të Kosovës dhe të shfrytëzimit të tij për përfitime të Kosovës, jo për përdorim të përbashkët.

Pjesa më e madhe e raportit, 3 nga 4 pikat përmban pika për veprime teknike inxhinierike në kuadër të sistemit të Ibër-Lepencit.

Raporti e ka korigjuar atë që e ka bërë gabim ish-kryeministri, ku ka pretenduar dhe i cili deklaroi publikisht që Ujmani mund të shfrytëzohet bashkë me Serbinë. Pra, raporti askund s'e përmend një pasaktësi të tillë dhe, siç e thotë parashtruesi i pyetjes retorike, mbrojtësi më i madh i sovranitetit tonë, pra e ka kuptuar më mirë se sa e pasaktë dhe e pamundur ka qenë ai pretendim për shfrytëzim të përbashkët.

Serbia është thirrur në atë marrëveshje, mirëpo jo edhe në atë raport. Po të kishte qenë i mirë ai raport për Serbinë, pa dyshim që e kishte përdorur Serbia, ne nuk e kemi përdorur, sepse në vazhdimësi kemi qenë në të drejtën tonë dhe kemi theksuar e insistuar se nuk kemi se çfarë të flasim për pronën tonë.

Por është indikative që ju si deputetë opozitarë, pa nevojë e sillni këtë temë, e cila nuk i shkon përshtati Kosovë. Mbase edhe për shkak se subjekti tuaj e ka nënshkruar atë marrëveshje që e hap çështjen e Ujmanit si temë, shfrytëzimin e përbashkët të një asemi të Kosovës, por për fat të mirë kjo ide nuk është marrë seriozisht e nuk është shtyrë përpara nga askush.

**KRYETARI:** Zoti Selmanaj, pyetja shtesë për kryeministrin.

**DRITON SELMANAJ:** E para, ju jeni personi që përgjigjeni për këtë pyetje. Unë nuk jam një parashtrues i pyetjes, por jam deputeti Driton Selmanaj.

Zoti kryeministër, ju keni thënë që me këtë pikë të marrëveshjes shkelet dhe cenohet sovraniteti i Kosovës. Tani kontradikta e juaj sa po ishte, ju thatë që nuk i ka shkuar përshtati Serbisë, prandaj Serbia nuk e përdor këtë. Po nga ana tjetër thoni që ju me këtë kërkesë që i keni bërë departamentit të energjisë sikur i keni bërë dëm Kosovës, ju s'po dini çfarë po flisni, kryeministër. A e keni lexuar diku në këtë raport kur thuhet që Ujmani nuk është ujë, Ujmani është tokë, sepse një herë është tokë e pastaj është ujë, Ujmani është tokë e mbushur me ujë. A kanë arritur edhe amerikanët ta konfirmojnë këtë.

**KRYETARI:** Zoti kryeministër, përgjigje shtesë.

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Unë e shpjegova shumë qartë se cilësimet, vlerësimet që i jep raporti, nuk janë në përputhje me përdorimin e përbashkët çfarë ka nënshkruar ish-kryeministri. Ka qenë gabim ai formulim në marrëveshje të nënshkruar nga ish-kryeministri, e para.



E dyta, pa dyshim që unë e kisha parasysh e besoj që të gjithë edhe në këtë sallë, edhe qytetarët që na ndjekin, që parashtruesi i pyetjes është deputeti Driton Selmanaj. Nëse dikush s'ë ka pasur të qartë, e sqaruar ju, nëse dikush serish s'ë ka pasur qartë, ja po e rritem edhe unë.

Dhe, ish-kryeministri deklarohej se Serbia mund të na ndalë ujin, po në fakt këtë e bënte, sepse nuk e kuptonte të drejtën elementare ndërkombëtare të ujërave, ku një shtet nuk mund t'ia ndalë ujërat një shteti tjetër. Përndryshe ne vetëm 10% të ujërave i kemi ujëra të jashtme, nga burimi i Ibrit në Malin e Zi që del në Serbi, e pastaj futet në Kosovë dhe prapë del në Serbi, të gjitha ujërat e tjera në pellgun e Ibrit dhe të Moravës së Binçes burojnë në Kosovë. Ne nuk mund t'ia ndalim ujërat Serbisë, ashtu sikurse as ajo nuk mund të na i ndalë neve. Por këso pyetje dhe këso pretendimesh çfarë janë bërë në të kaluarën, mund të bëhen vetëm prej atyre, qofshin deputetë ose ish-kryeministra që nuk e kuptojnë të drejtën ndërkombëtare të ujërave.

**KRYETARI:** Zoti Selmanaj, për t'ia jepni një fjalë përmbyllëse kësaj pike.

**DRITON SELMANAJ:** Për dallim prej juve, kryeministër, që jeni elektrikist, unë studimet postdiplomike i kam pasur në të drejtën ndërkombëtare. Dhe, po ju them kështu. Rekomandimi i këtij raporti është që të merret parasysh raporti mes SHBA-së dhe Kandasë për lumin Kolumbia dhe të jeni të sigurt që sikur të gjitha çështjet e tjera që po i përpini çdo ditë e më shumë, një këshillë, një sugjerim.

Raportet e SHBA-së, qasjen e SHBA-së, aleatit tonë strategjik, merre seriozisht, shumë seriozisht, sepse do të vish në Kuvend këtu dhe do të na flasësh për këtë raport sa i mirë është, po të këshilloj merre seriozisht. Faleminderit!

**KRYETARI:** Vazhdojmë me pyetje të tjera. Deputeti Vendenis Lahu, pyetje për ministrin Liburn Aliu, nuk e kemi ministrin këtu, herën tjetër. Si do të veprosh, i nderuar deputet?

Visar Korenica, pyetje po ashtu për Liburn Aliun, nuk e kemi këtu ministrin.

Deputetja Fjolla Ujkani, po ashtu për Liburn Aliun, pyetje, herën tjetër.

Edhe deputeti Vendenis Lahu, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, e kemi këtu zotin Vitia.

**VENDENIS LAHU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Pyetja ime ka të bëjë me mungesa në disa prej profileve specialistike në sistemin tonë shëndetësor. Pra, në kontekstin e përgatitjes së kuadrove të reja për këto profile, të cilat janë

deficitare, janë deficitare për shkaqe të ndryshme, qoftë për shkak të pensionimit të mjekëve specialistë të këtyre lëmenjve, por edhe për shkak se në të kaluarën gjatë proceseve të specializimeve nuk janë trajtuar ashtu siç është dashur, ose nuk janë trajtuar për një kohë të gjatë, prandaj edhe ka mungesë të tyre.

Kështu që pyetja ime direkte është: Duke pasur parasysh se edhe në planifikimet e Qeverisë dhe të Ministrisë ka qenë hapja e specializimeve të reja gjatë këtij viti, unë dua t'ju pyes se deri ku kemi ecur me këtë proces dhe kur pritet hapja e specializimeve të reja, sidomos për lëmenjtë deficitare që janë në sistemin tonë shëndetësor?

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Vitia, për t'u përgjigjur.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, deputet!

Atëherë, po. Është evidente, kemi deficit, kemi mungesë të disa profileve në shëndetësi. Natyrisht, kjo për shkak edhe të mungesës së planifikimeve të resurseve njerëzore më herët dhe moshapjes së specializimeve. Prandaj, këtë herë në Udhëzimin administrativ që do të nënshkruhet javën e ardhshme jemi munduar t'i adresojmë secilin nga këto probleme që janë identifikuar, që nëse më lejoni do ta listoj edhe përgjigjen që e kam marrë në bashkëpunim edhe me Bordin për shkollimin specialistik.

Me konkursin e ri të specializimeve në përputhje ekskluzivisht me nevojat e sistemit tonë shëndetësor do të ndajmë specializime me prioritet për lëmenjtë ku ka më shumë nevojë dhe për profile tashmë të identifikuar si deficitare, me të cilat po përballet sistemi ynë shëndetësor. Bordi për shkollim specialistik dhe Ministria e Shëndetësisë ka përpiluar rregulla të reja në funksion të mbarëvajtjes edhe më të rregullt të shkollimit specialistik dhe ngritjes së nivelit të përfitimit të njohurive profesionale nga specialistët tanë gjatë shkollimit të tyre.

Më lejoni, ju lutem, të përmend vetëm disa prej tyre. Është standardizuar dhe normalizuar procesi i mbikëqyrjes së vijueshmërisë së shkollimit specialistik, duke monitoruar procesin në baza ditore dhe mujore në linjën e raportimit. Sipas të dhënave të Bordit, janë plotësuar dhe përditësuar plan-programet, kurrikulat specialistike dhe të gjithë lëmenjtë specialistikë.

Pas rekomandimit të Bordit e kemi iniciuar plotësim-ndryshimin e Udhëzimit administrativ aktual për shkollim specialistik 05/2017, i cili tashmë është, siç thashë edhe më herët në përgjigjen ndaj zotit Haxhiu, në fazën finale dhe do të nënshkruhet në javën e ardhshme.

Pas raportimit të Bordit për problemet e mosfillimit të shkollimit specialistik në lëminë e Psikologjisë klinike, së bashku me Bordin dhe Komitetin e Psikologjisë klinike kemi arritur për

të rifilluar procesin mësimor në lëmin Psikologji klinike pas bllokimit pa ndonjë arsye, apo edhe arsye të tjera të ndryshme.

Kemi bashkëpunuar me të gjitha institucionet shëndetësore në vend, kemi identifikuar kapacitetet monitoruese, kapacitetet infrastrukturore dhe nevojat potenciale për specializime të reja dhe kemi bërë përgatitjet e nevojshme paraprake për konkursin e ardhshëm për specializime. Kemi vënë në funksion ditarin e punës për specializantët, i cili kishte munguar, e që është i domosdoshëm për përcjelljen e punës dhe progresit të specializantit e që më tepër ka qenë edhe obligim nga Udhëzimi administrativ 05/2017.

Bordi, së bashku me inxhinierët e IT-së në Ministrinë e Shëndetësisë, kanë përgatitur databazën elektronike të specializantëve, e cila do të lehtësojë monitorimin e tyre, administrimin e të dhënave dhe transparencën e punës së tyre. Për këtë është bërë tanimë trajtimi i mentorëve dhe komiteteve dhe presim fillimin e implementimit të këtij programi: implementimi i modulit elektronik i regjistrimit të të dhënave të specializantëve, mentorëve, komiteteve specialiste dhe dokumenteve të tjera relevante në këtë proces; përpilimi i planit afatmesëm dhe afatgjatë, mbi të cilin do të duhej të bëhet planifikimi i nevojave nacionale të specializimeve, siç thashë, është në fazën përfundimtare dhe brenda 30 - 40 ditë pritet edhe të hapet konkursi për specializime. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Lahu, a ke pyetje shtesë tjetër? Urdhëro?

VENDENIS LAHU: Jo. Ishte përgjigjja e plotë e ministrit, kështu që nuk kam pyetje shtesë.

KRYETARI: E po, mirë. Kalojmë tash te projektligjet. Ju lutem, zini vendet tuaja.

Të nderuar deputetë,  
E kemi Projektligjin për pyjet.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Mirë! Uluni nëpër vendet tuaja. Votojmë tash! Bjerini ziles!

*(Ndërprerje e incizimit)*

Mirë! Tash mazhoranca i bëri 61 deputetë. Mund të vazhdojmë, meqenëse prej opozitës e morëm qëndrimin që nuk do t'i votojnë projektligjet, kështu që varet krejt prej mazhorancës. 76 deputetë janë tash.

Të nderuar deputetë, po vazhdojmë me:

#### **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-137 për pyjet**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Mjedis e ka shqyrtuar projektligjin. Na e ka rekomanduar miratimin e tij. Ka edhe amendamentet, 39 amendamente i ka ky projektligj.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji përmban implikime buxhetore shtesë, por që janë të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës, kurse amendamentet nuk përmbajnë të tilla.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën, si dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat e komuniteteve.

Po ia japim fjalën tash kryetares së Komisionit për Mjedis, Fitore Pacolli-Dalipi, që ta paraqesë raportin.

**FITORE PACOLLI-DALIPI:** Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim në pajtim me nenin 76.9 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21. 2. 2023 ka shqyrtuar Projektligjin për pyjet, i propozuar nga Qeveria, si dhe ka shqyrtuar vërejtjet nga komisionet e përhershme dhe ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë raportin me 39 amendamente.

Komisioni njëzëri i ka miratuar amendamentet dhe e ka mbështetur këtë projektligj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nëse nuk ka diskutime, atëherë i hedhim këto amendamente në votim. Përgatituni për votim!

Janë 39. Të gjitha janë prej komisionit, kështu që nuk ka ndonjë kontradiktë.

I hedhim ato në votim. Përgatituni për votim!

Kush është për amendamentet e Projektligjit për pyjet?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

62 deputetë votuan. Të gjitha votat për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kështu që kalojnë amendamentet e Projektligjit për pyjet.

Tash e hedhim projektligjin në votim, së bashku me amendamentet.

Kush është për Projektligjin për pyjet?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Gjithsej 63 vota për këtë projektligj, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kështu kalon ky projektligj.

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-172 për sigurinë e përgjithshme të produkteve**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Ekonomi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni i Buxhetit vlerëson se amendamentet e projektligjit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se edhe Projektligji dhe amendamentet janë në përputhje me Kushtetutën.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se amendamentet nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se edhe Projektligji edhe amendamentet nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Prandaj, po ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Ekonomi, deputetit Shala, që ta arsyetojë raportin e këtij komisioni për këtë projektligj.

**FERAT SHALA:** Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti e shqyrtoi Projektligjin nr. 08/L-172 për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe ka hartuar e miratuar 17 amendamente.

Andaj, në bazë të raportit të vet amendamentues të datës 14 shkurt 2023, si dhe në bazë të raporteve të komisioneve të përhershme, më 28. 2. 2023 vendosi t'i paraqesë Kuvendit këtë:

## Rekomandim

Të miratohet në shqyrtim të dytë Projektligji nr. 08/L-172 për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

KRYETARI: Ky ishte raporti i komisionit. Për këtë projektligj janë propozuar 17 amendamente. Të gjitha janë të komisionit, kështu që i hedhim në pako ato. Përgatituni për votim, të nderuar deputetë zini vendet tuaja.

Të nderuar deputetë,

Kush është për këto amendamente për Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 deputetë votuan për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. U miratuan amendamentet e këtij projektligji. Tash e hedhim në votim projektligjin.

Kush është për këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Vetëm 60 deputetë votuan. Nuk është kuorumi. Tash kthehet edhe një deputet.

E hedhim në votim edhe një herë, vetëm projektligjin së bashku me amendamentet. Sepse ato kaluan. Pra, Projektligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve është në votim.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

61 deputetë votuan për projektligjin. Asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-172 për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Shëndetësi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ia japim fjalën ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, që të na e paraqesë këtë projektligj para Kuvendit.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Aktualisht, shëndeti riprodhues ku përfshihet edhe fertilizimi i asistuar mjekësor është i rregulluar me Ligjin nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues me Udhëzimin administrativ nr. 06-2013 për frytnim të asistuar mjekësor.

Deri tani, shëndeti riprodhues dhe fertilizimi i asistuar mjekësor është ndikuar, mospasja e legjislacionit adekuat, mungesa e resurseve njerëzore, infrastrukturës, pajisjeve dhe mungesa e financimit në sektorin publik.

Kosova nuk ka pasur të planifikuar program parandalimi depistimi të organizuar për kancerin cervikal dhe atë të gjirit dhe për të kapërcyer këtë situatë duhet që të ndërtohen kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe të planifikojmë buxhet për pajisje dhe materiale shpenzuese që do të jetë bazë edhe në këtë ligj.

Legjislacioni joadekuat dhe mungesa e politikës adekuate shëndetësore për fushën e shëndetit riprodhues dhe fertilizimit të asistuar mjekësor, shkakton rrezikimin e jetës dhe shëndetit të pacientëve, pamundësinë e ofrimit të shërbimeve përkatëse, mungesën e cilësisë së shërbimeve, mosdefinimin e qartë të roleve dhe përgjegjësiive institucionale, mosdefinimin e qartë të përgjegjësiive të profesionistëve shëndetësorë dhe rrezikun për keqpërdorime eventuale.

Në këtë drejtim, është paraparë plotësim-ndryshimi i kornizës ligjore dhe hartimi i Projektligjit për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor.

Në vitin 2017 është aprovuar koncept-dokumenti për këtë projektligj, por prej atëherë nisma nuk është finalizuar dhe në nëpërmjet kësaj periudhe ka pasur zhvillime dramatike në këtë sektor, veçanërisht në vitin 2018 dhe 2019, ku u paraqitën raste të abuzimit, edhe më qartë se sektori publik dhe konkretisht Ministria e Shëndetësisë dhe SHSKUK duhet të marrin përgjegjësinë e organizimit dhe ofrimit të garancive profesionale dhe etike për qytetarët e Republikës.

Për një kohë të gjatë, grupet punuese në Ministri të Shëndetësisë punuan dhe hulumtuan gati të gjitha rastet në vendet e Bashkimit Evropian për të dalluar se deri ku ka mbërri zhvillimi i procedurave në këtë fushë dhe standardet etiko-profesionale. Ky rregullim ligjor është çështje mjekësore, aq sa është edhe çështje shoqërore. Si i tillë është trajtuar nga profesionistët që kanë punuar në draftimin e këtij projektligji.

Kryesorja dhe më e rëndësishmja është që shtylla e rregullimit të kësaj fushe do të jenë institucionet publike, të cilat kanë edhe përgjegjësitë përballë ligjit dhe Kushtetutës, të kujdesen dhe të japin garanci për jetën, shëndetin dhe dinjitetin e qytetarëve.

Konkretisht, projektligji rregullon shëndetin riprodhues, procedurat e fertilizimit të asistuar mjekësor, realizimin dhe këshillimin për këto procedura si e drejtë riprodhuese e njeriut, kur nuk arrihet shtatzania e dëshiruar me forma natyrale.

Ky projektligj përcakton të drejtat e shëndetit riprodhues, pra përfshirë të gjitha ato që thamë dhe parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme si HIV-AIDS, si dhe infeksioneve dhe sëmundjeve të traktit riprodhues, parandalimin, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e sëmundjeve malinje të sistemit riprodhues dhe karcinomës së gjirit dhe jetën seksuale e riprodhuese me vullnetin e saj ose tij si dhe sëmundjet e trashëgueshme.

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i kësaj fushe që do të krijojë mundësi për organizimin, funksionimin, rolin dhe përgjegjësitë institucionale dhe profesionale, mbikëqyrjen, inspektimin për kujdes shëndetësor, të sigurt dhe cilësor.

Për kujdes shëndetësor, të sigurt dhe cilësor që ofrohet në fushën e shëndetit riprodhues me qëllim të ruajtjes, promovimit, përmirësimit të të drejtave të shëndetit seksual dhe riprodhues.

Praktikisht, kjo rregullativë adreson: fertilizimin e asistuar mjekësor, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësiive institucionale dhe profesionale, sanksionet administrative dhe çështje të tjera të përcaktuara në përmbajtjen e ligjit, organizimin e një programi sistematik të 'screening' që do të përfshinte ndërtimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së duhur, duke siguruar promovimin dhe pranueshmëri të programit, depistim të grave në moshën e caktuar dhe jo vetëm kaq, ofrimin e trajtimit adekuat dhe kujdesin për rastet e detektuara të kancerit dhe gjendjeve prekanceroze.

Sa i përket planifikimit familjar, Ministria e Shëndetësisë do të përfshijë sigurimin e mjeteve kontraceptive në listën esenciale të barnave për kategoritë e liruara nga bashkëpagesa.

Projektligji për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor do të ndikojë në: krijimin dhe rregullimin e kapaciteteve dhe shërbimeve për shëndetin riprodhues, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit riprodhues, përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore, pra edhe parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.

Projektligji për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar ka për synim përmirësimin dhe ruajtjen e shëndetit seksual dhe riprodhues për të gjithë qytetarët e Kosovës, ashtu që tash, ku përfshihen përkufizimi i fushave, ofrimi i shërbimeve shëndetësore përkatëse për shëndetin seksual dhe riprodhues, roli dhe kompetencat e institucioneve shëndetësore që kryejnë



veprimtarinë e shëndetit riprodhues, detyrat dhe përgjegjësitë e profesionistëve shëndetësorë që kryejnë veprimtarinë e shëndetit riprodhues, themelimin e institucionit shëndetësor publik referent për fertilizimin e asistuar mjekësor, themelimin e komisionit për fertilizimin e asistuar mjekësor dhe kompetencat, themelimin e bankës për ruajtjen e qelizave gjinore, procedurat për ruajtjen dhe asgjësimin e qelizave gjinore dhe embrioneve, krijimin e databazës për ruajtjen e të dhënave për fertilizimin e asistuar mjekësor, procedurat e aplikimit për fertilizimin e asistuar mjekësor, transportin e qelizave gjinore, përcaktimi i sanksioneve administrative, përcaktimi i procedurës dhe kushteve për evokimin e licencës së institucioneve, realizimin e ‘screening’ të kancerit të qafës së mitrës si dhe sigurimin e mjeteve kontraceptive.

Ky projektligj përmban dispozita të cilat janë për aq sa është e mundur për Kosovën, në përputhje të gjitha ato dispozita që janë në përputhje me aktet vijuese të Bashkimit Evropian: direktiva 2004-23 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e 31 marsit 2004, mbi vendosjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë për dhurimin, prokurimin, testimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e indeve dhe qelizave njerëzore. Direktiva 2006-86 e Këshillit të Evropës e dt. 24 tetor 2006 për zbatimin e direktivës 2004-2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat e gjurmueshmërisë, njoftimin e reaksioneve dhe ngjarjeve të padëshirueshme serioze dhe kërkesave të caktuara teknike për kodimin, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e indeve dhe qelizave njerëzore. Direktiva 2006-17 e 8 shkurtit 2006 për zbatimin e direktivës 2004-23 të Këshillit të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kërkesat teknike për donacion, prokurim dhe testim të indeve dhe qelizave njerëzore.

Projektligji në tërësi përmban 56 nene të ndara në gjashtë kapituj, të cilët janë: kapitulli i parë: dispozitat e përgjithshme, kapitulli i dytë: fertilizimi i asistuar, kapitulli i tretë: realizimi i procedurës së fertilizimit të asistuar mjekësor, kapitulli i katërt: ruajtja e qelizave riprodhuese dhe embrioneve, kapitulli 5: komisioni, kapitulli 6: dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Me këtë projektligj janë paraparë të derivojnë këto akte nënligjore: banka për ruajtjen e qelizave riprodhuese dhe embrioneve, kushtet, struktura e bankës dhe njësisë brenda institucionit shëndetësor, procedurat e marrjes, ruajtjes dhe shenjzimi i qelizave riprodhuese, indeve dhe embrioneve përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria; distribuimi i qelizave riprodhuese dhe embrioneve, po ashtu me akt nënligjor, ku parasheh mënyrën e distribuimit dhe masat për sigurimin e cilësisë së qelizave riprodhuese, vlerësimin e rrezikut të qelizave riprodhuese dhe embrioneve gjatë bartjes, gjithashtu pra do të përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria; sistemi i identifikimit dhe karakteristikat dhe cilësitë kryesore të qelizave riprodhuese dhe embrioneve në pajtim me sistemin evropian të kodimit gjithashtu do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria në sistemin e kodimit, organizimi, menaxhimi, prokurimi, kushtet, hapësira, kuadri profesional, kriteret...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Ia shtoni edhe një pjesë të kohës ministrit derisa ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI ARBEN VITIA: Atëherë, organizimi, menaxhimi, prokurimi, kushtet, hapësira, kuadri profesional, kriteret dhe kualifikimet për personin përgjegjës, pajisjet mjekësore të institucionit shëndetësor për fertilizimin e asistuar mjekësor. Gjithashtu do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Projektligji i miratuar nga Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më dt. 25 janar 2023 dhe prandaj sot është para jush për t'u miratuar në shqyrtim të parë. Siç dihet, shumë shpesh nisma të reja që prishin në njëfarë mënyre edhe status quo-n, e veçanërisht ato të cilat vendosin ose synojnë të vendosin rregull dhe të hapin atë fushë për më shumë përfitues pasohen shpesh edhe nga kritika, e nganjëherë edhe sulme të pabaza.

Nuk është që nuk presim të tilla edhe për këtë nismë kaq shumë të nevojshme për vendin tonë dhe veçanërisht në këtë fushë specifike. Ne të gjithë e dimë, pavarësisht profesioneve që kemi se sa vështirësi dhe sa shpenzime kanë ata që duan të kryejnë këto intervenime. Shumica prej tyre, prej vitesh vizitojnë spitale jashtë vendit apo edhe në sektorin privat brenda vendit.

Dua të theksoj se paralel me këtë nismë ligjore, ne kemi bërë gati edhe fillimin e IBF-së në SHSKUK. Përveç shpenzimeve dhe vështirësive të këtij lloji, nuk janë të pakta rastet kur qytetarët janë përballur edhe me situata shumë komplekse, si në rastin e embrioneve në kohën kur organet e rendit i mbyllën klinikat që patën kryer procedura jashtë standardit. Ndaj, me këtë nismë, ne e themelojmë bankën në institucionet publike dhe procedurat standarde për veprimet dhe sigurinë në to.

Kështu, sigurohemi që kurrë më askush...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: I nderuar ministër,  
Nëse mundesh, se projektligji i gjatë qenka pak.

Urdhëro një kohë të caktuar ministrit.

MINISTRI ARBEN VITIA: Është i gjatë, sepse është i rëndësishëm. Është shumë i rëndësishëm. Ndaj, në këtë nismë ne themelojmë bankën në institucionet publike dhe procedurat standarde për veprimin dhe sigurinë në to. Kështu sigurohemi që kurrë më askush të mos përballet me situata të ngjashme. Si dhe ata dhe ato që do t'i marrin këto shërbime të kenë një jetë të qetë dhe të sigurt, sepse shteti merr përsipër rregullimin e këtyre procedurave.

Për këto që ju paraqita, pavarësisht gjatë, të jemi koshientë për rëndësinë e këtij ligji, prandaj deputetë të dashur, deputetë të nderuar, ju ftoj që me votën tuaj ta përkrahni, bile edhe pa dallime partiake, marrë parasysh të gjitha ato që i thashë më lart. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ky ishte prezantimi i këtij projektligji të rëndësishëm pa dyshim. Tash, ua japim fjalën grupeve parlamentare. Apo kryetares së komisionit, znj. Fatmire Kollçaku.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Ju falënderoj kryetar i Kuvendit!

Falënderoj edhe ministrin për projektligjin që e ka sjellë në Kuvend, ashtu siç tha që pretendon ta rregullojë këtë fushë dhe të rritet numri i përfituesve dhe gjithë atyre qytetarëve që për këto shërbime që ofron ky projektligj dhe i rregullon, është dashur të drejtohen jashtë vendit.

Fillimisht do t'ju drejtohem pra si kryetare e Komisionit për ta lexuar raportin e komisionit.

Komisioni në bazë të nenit 74 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt, shqyrtoi në parim Projektligjin për shëndetin riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor, dhe me shumicë votash ka konstatuar se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim të parë në mbledhjen plenare, dhe rekomandon këtë seancë dhe deputetët e pranishëm që ky projektligj të miratohet në parim. Pra, Projektligji nr. 08/L-212 për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor.

Kjo ishte sa i përket funksionit tim si kryetare e komisionit dhe në emër të komisionit.

Nëse më lejohet unë do të vazhdoja edhe në emër të grupit parlamentar.

**KRYETARI:** Po, lirisht zonja Kollçaku.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Atëherë, duke e falënderuar edhe një herë ministrin, i cili në fjalën e tij elaboroi më gjerësisht nevojën për rregullimin e kësaj fushe dhe për nevojën për miratimin, fillimisht në parim, të këtij projektligji, i cili është e qartë që mes dy leximeve edhe deputetët do të kenë mundësi që me vërejtjet dhe sugjerimet ta pasurojnë me siguri edhe me ndonjë amendament këtë projektligj.

Megjithatë, unë meqenëse siç e ceka, ministri foli më gjerësisht për projektligj, unë vetëm do të them se ku buron obligimi për miratimin e këtij projektligji. Pra, fillimisht nga programi qeverisës 2021-2025, në kuadër të prioritetëve strategjike 2.1 shëndeti publik dhe mbrojtja sociale, ku përcaktohet reformimi i sektorit të shëndetësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore.

Pastaj nga dokumenti i rëndësishëm strategjik, Strategjia Sektoriale dhe plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë Sektoriale 2017-2021, ku objektive strategjike është ruajtja dhe përparimi i shëndetit dhe strategjia për shëndetin e nënës, fëmijës dhe shëndetit riprodhues. Dhe, Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për vitin 2021, kapitulli 28, mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik në kuadër të masave legislative ka paraparë miratimin e Ligjit për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor.

Siç i tha, është synim afatgjatë dhe tashmë e arritëm ky synim që ky projektligj të sillt në Kuvend. Vetëm shkurt, mund të ritheksoj se Projektligji për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor përcakton të drejtat e shëndetit riprodhues, përfshirë riprodhimin, informimin, edukimin dhe këshillimin mbi shëndetin seksual dhe riprodhues përgjatë gjithë ciklit jetësor, amësinë e sigurt, planifikimin e familjes, parandalimin dhe trajtimin e përshtatshëm të infertilitetit, ndërprerje e sigurt të shtatzënisë, shërbimet për parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, HIV AIDS-in, si dhe infeksioneve dhe sëmundjeve të traktit riprodhues, parandalimin, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e sëmundjeve malinje të sistemit riprodhues, karcinomën e gjirit dhe jetën seksuale dhe riprodhuese me vullnetin e saj, të tij.

Po ashtu, ky projektligj rregullon kujdesin shëndetësor, procedurat e fertilizimit të asistuar mjekësor, realizimin dhe këshillimin për këto procedura, si e drejt riprodhuese e individit kur nuk arrihet shtatzëni e dëshiruar me rrugë natyrore. Ju falënderoj dhe edhe njëherë e ritheksoj kërkesën që në parim ky projektligj të votohet nga deputetët prezentë dhe ndërmjet dy leximeve do të kemi mundësi ta japim edhe kontributin tonë si deputetë.

**KRYETARI:** Kush e jep qëndrimin e Grupit të PDK-së? Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Po bëhen tani dy vjet që në Kuvendin e Kosovës po na vjen projektligji i parë nga sfera e shëndetësisë. Pra, u deshën të kalojnë dy vjet që Qeveria më në fund ta procedojë në Kuvend një projektligj të rëndësishëm për sektorin e shëndetësisë.

Unë nuk dua të hyj në çështje të cilat janë përcaktim i prioriteteve të Ministrisë së Shëndetësisë, se a do të duhej dhe a ishte më e rëndësishme që në Kuvend të vije Ligji për transplantimin e organeve apo Projektligji për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor. Secila nga këto janë dhe do të duhej të ishin prioritete në sektorin e shëndetësisë.

Sido që të jetë, është politikë qeverisëse dhe kemi tani një projektligj, i cili rregullon një fushë të caktuar, e që është bërë përpjekje edhe në të kaluarën të rregullohet, mirëpo për shkak të ndryshimeve në legjislaturat e kaluara nuk ka arritur të votohet një projektligj i tillë.

Ka nevojë Kosova që ta rregullojë këtë çështje, mirëpo gjithsesi duhet pasur në konsideratë edhe faktorët të cilët janë në këtë sferë, e që deri më tani kryesisht janë përdorur edhe për sferat e biznesit. Uroj që masat parandaluese të cilat ne duhet t'i vendosim për aspektin e biznesit që mund të ndodhë e të shfrytëzohet ky projektligj, të vendosim masa të rrepta ndëshkuese, të cilat ky projektligj aktualisht që është i propozuar, ato të cilat janë të parapara në Kodin Penal në kapitullin 22 për vepra penale kundër shëndetit publik, me këtë projektligj, tek sanksionet, parashihen vetëm sanksione kundërvajtëse.

Prandaj, e them që ky projektligj te ndëshkimet, momentalisht si është i propozuar nga Qeveria, është në kundërshtim me Kodin Penal. E marrim shembull, nëse ndërprerje a shtatzënisë është vepër penale me Kodin Penal, me këtë projektligj është vetëm kundërvajtje. Prandaj, ju e dini që nesër në sistemin e drejtësisë, gjykata për të akuzuarit e mundshëm e përdor ligjin më të favorshëm për të akuzuarit. Në këtë rast do të shfrytëzohej ky projektligj dhe mund të kishte ndëshkime kundërvajtëse dhe jo penale për ata që e dëmtojnë shëndetin publik.

Çështja për mua edhe që e kemi diskutuar në komision dhe për çka ne si opozitë kemi abstenuar në komision, ka qenë neni 31 tek përcaktimi i gjinisë. Aktualisht me këtë projektligj, pra, kjo çështje lë mundësinë që te përcaktimi i gjinisë të vendos një komision i cili themelohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Mendoj që kjo çështje duhet të ndalohet me ligj rreptësisht dhe nuk duhet të lënë mundësinë të interpretimeve të ndryshme, të cilat mund të krijojnë ose mund ta shfrytëzojnë të tjerët, ashtu qysh aktualisht e shkruar tek neni 31.

Prandaj, më lejoni të nderuar kolegë deputetë, ta lexoj. Neni 31, zgjedhja e gjinisë, citoj: “Ndalohet zgjedhja e gjinisë me procedurat të FAM-it me përjashtim të rastit me indikacione mjekësore gjenetike trashëguese me pasoja për nënën dhe frytin”. Dhe, paragrafi 2: “Me pëlqim për procedurat nga paragrafi 1, e jep komisioni për FAM”. Pra, nuk po flet për diagnozë të verifikuar mjekësore, por po flet për indikacion mjekësor.

Prandaj, ky indikacioni mjekësor mund të abuzohet me të, dhe me këtë të ketë një ndërhyrje në strukturën gjinore të popullatës. Jam i bindur dhe duhet të jetë kështu, që përcaktimin e gjinisë nuk duhet vendosur te një komision, i cili për arsye të caktuara të indikacioneve mjekësore mund ta aprovojë. Përcaktimin e gjinisë e ka vetëm Zoti dhe askush tjetër.

Prandaj, jam këtu për këtë çështje që këtu nuk duhet të ketë ndërhyrje të dorës së individit në përcaktimin e gjinisë për asnjë arsye. Duke e ditur edhe mentalitetin e popullatës tonë që është i prirë më shumë që te përcaktimi i gjinisë të anojë kah gjinia mashkullore, atëherë brenda disa viteve për shkak të masave ndëshkuese kundërvajtëse të dobëta, mund të ketë ndryshim në strukturën gjinore të popullatës në Republikën e Kosovës, e kjo do të ishte një dëm shumë i madh.

Shikojeni te sanksionet kundërvajtëse, variojnë për personat fizikë nga 1 mijë deri në 6 mijë euro, ndërsa më të lartat për personat juridikë janë 20 mijë euro. Ju e dini që ka persona në Kosovë që ta përcaktojnë gjininë janë në gjendje të paguajnë edhe më shumë se 20 mijë euro. Prandaj, kjo nuk duhet të lejohet në këtë formë që të kalojë.

Për shkak të këtyre vërejtjeve të cilat i themi dhe të cilat duhet të korrigjohen mes dy leximeve, në këtë periudhë ne abstenojmë nga votimi i këtij projektligji. Nëse vërejtjet tona merren në konsideratë, atëherë do ta mbështesim një projektligj të tillë, sepse mendojmë që, po, Kosova ka nevojë që ta rregullojë këtë sferë dhe këtë sektor të shëndetësisë, por se prioritetet e sektorit të shëndetësisë, mendoj që do të duhej të ishin te Ligji për transplantimin e organeve, te Ligji për shëndetësinë, te Ligji për sigurimet shëndetësore dhe te përmirësimi i komplet sistemit tonë shëndetësore.

Andaj, do të duhej që fillimisht të kishim një Strategji të miratuar për shëndetësi dhe pastaj të kishim edhe legjislacionin për implementimin e asaj Strategjie. Aktualisht, nga viti 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës vepron pa Strategji në sektorin e shëndetësisë.

Strategjia e fundit Sektoriale për shëndetësi është votuar në vitin 2017 që e ka vlejtur deri në vitin 2021, dhe nga viti 2021, shëndetësia po udhëhiqet ad-hoc herë me një ministër, herë me një ministër tjetër, herë me një komision, herë me një komision tjetër, por jo diçka përmbajtësore që do ta përmirësonte këtë sektor.

Prandaj, në këtë fazë derisa nuk merren në konsideratë vërejtjet të cilat i thamë, ne do të abstenojmë si grup parlamentar në votimin e këtij projektligji.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)*

KRYESUESJA: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës nuk janë deputetët këtu. Nga Aleanca a e merr fjalën dikush? Jo. Nga Grupi Multietnik? Jo!

Meqë nuk kemi deputetë të paraqitur për fjalë, ia jap fjalën ministrit Arben Vitia që ta përmbyllë diskutimin.

MINISTRI ARBEN ALIU: Faleminderit të nderuar deputetë!

Faleminderit për qasjen konstruktive, zoti Haxhiu. Më lejo ta shpjegoj vetëm nenin 31; ndalohet. Domethënë, ndalohet përcaktimi i gjinisë, mirëpo ashtu siç e dimë, janë disa sëmundje të trashëgueshme që barten vetëm njëra gjini, dhe në raste të tilla rrezikon që fëmija të lind me sëmundje që janë edhe vdekjeprurëse. Domethënë, kjo ka qenë arsyeja.

Natyrisht, komisioni që e kemi thënë aty nuk është komision me paragjykimin që mund të blihet ose ku e di unë. Janë qartë të përcaktuara, sëmundje hereditare me rrezikshmëri të lartë. Kjo ishte aty.

Natyrisht, një pjesë e këtyre problematikave do t'i diskutojmë edhe në të ardhmen. Një pjesë e këtyre problematikave që u përmend do të sqarohen edhe me udhëzime, akte nënligjore ashtu siç thashë më herët, por mbi të gjitha prapë mendoj se është një ligj, i cili është i domosdoshëm, sepse një herë e mirë po vë rregull në këtë fushë shumë të ndjeshme, po aq edhe të rëndësishme për qytetarët e Republikës. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)*

KRYETARI: Fjalën për replikë e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni edhe njëherë, i nderuar ministër, ta lexoj nenin 31, zgjedhja e gjinisë: “Ndalohet zgjedhja e gjinisë me procedurat FAM me përjashtim të rasteve me indikacione mjekësore, gjenetike, trashëguese me pasoja për nënën dhe frytin, dhe jo me diagnozë të përcaktuar”. Kjo çështja e indikacioneve mjekësore, po flas në nivelin profesional, lë elemente për të abuzuar. Me diagnozë definitive të përcaktuar mjekësore, është çështje tjetër. Unë kështu kam qenë, i nderuar ministër, çdoherë kritik ndaj atyre që mendoj që nuk kanë punuar mirë ose kanë qenë dekonstruktivë çdoherë, dhe këtë e kam bërë për të qenë në dobi të përmirësimit të sektorit shëndetësisë. I tillë kam çdoherë. Ndoshta kritikata, shumë prej ministrave, nuk u kanë pëlqyer, sepse kanë menduar ata që i dinë të gjitha ose janë edhe mbi ligjin, por i tillë kam qenë çdoherë. Kështu do të jem.

Prandaj, unë edhe pyeta te çështja e prioriteteve. A është më prioritet, sepse sapo folët më herët për laporaskopinë tek urologjia. A është i rëndësishëm Projektligji për transplantimin e organeve, sepse ju e dini që miliona euro shpenzohen për trajtim jashtë vendit vetëm për transplantim të veshkave, pa i llogaritur shpenzimet e tjera. Dhe, sa do të kursenim me atë Buxhetin e Republikës së Kosovës, sepse IVF nuk ka që mbulohen shpenzimet nga Ministria e Shëndetësisë. E kanë bartur vet qytetarët.

E dini sa procedurat janë në spitalet private, të cila për shkak të vendimeve të Inspektoratit kanë pasur pasoja edhe financiare për buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Prandaj, këto çështje duhet të rregullohen tek aspektet ndëshkuese që njëherë e përgjithmonë ato të jenë në harmoni me Kodin Penal dhe të mos jenë në kundërshtim me Kodin Penal.

**KRYETARI:** Po ia japim fjalën një herë deputetit Eman Rrahmani, sepse u kryen replikat. Kjo ishte përjashtim bile, sepse mendoj që pas fjalës përfundimtare të Qeverisë nuk duhet të ketë replika. Ashtu janë rregullat. Një herë shteren debatet mes Qeverisë, dhe kur konkludojmë që nuk ka më debat edhe diskutim, fjalën përfundimtare e ka Qeveria. E bëme këtë përjashtim. Ia japim fjalën edhe zotit Rrahmani.

**EMAN RRAHMANI:** Faleminderit, kryetar!

**KRYETARI:** Zoti Rrahmani!

**EMAN RRAHMANI:** Faleminderit, kryetar!

Natyrisht që ky është një ligj që për qëllim ka të rregullojë një sferë shumë të rëndësishme, e cila prek jo vetëm shëndetin, por edhe parime etike e morale të lidhura me familjen dhe konceptin e saj.

Unë, meqë edhe nuk vij nga kjo fushë, nuk dua që të futem thellë edhe të diskutoj rreth përmbajtjes së përgjithësi, mirëpo parimisht mendoj që duhet të rishikohet ky projektligj i propozuar nga ministri, për shkak që e cenon familjen, të cilën ne ose të paktën unë personalisht besoj dhe angazhohem për mbrojtjen e vlerave të saj.

Një njërin prej neve, ku këtu sqarohet e drejta e fertilizimit u jepet edhe vajzave të pamartuara, por edhe çështje të tjera të cilat u përmendën nga deputetët parafolës, andaj unë personalisht nuk do të marr pjesë në këtë votim, dhe do të kërkoja nga ministri që ta tërheqë dhe ta diskutojë edhe t'i marrë parasysh kritikën e deputetëve.

**KRYETARI:** Fjalën e dëshiron edhe nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci.

**SARANDA BOGUEVCI:** Faleminderit, kryetar!

E mora fjalën për t'i sqaruar disa gjëra pa pasur dëshirë, në fakt, të kyçem në replika. Mendoj që është ligj tepër i rëndësishëm dhe kemi diskutuar shumë herë në rrafsh të ndryshme.

Në aspektin kur ne i rregullojmë gjërat në shoqërinë tonë, sa e lehtë është që vendimet të merren për ta determinuar ne si gra qysh vendosim ta jetojmë jetën tonë, diçka që nuk parashihet në pjesën e burrave. Unë po dua të jem e sqartë dhe publikisht ta them këtë pjesë, që unë përderisa



nuk e kam pasur mundësinë të jem në lidhje apo të jem në lidhje martesore ose çfarëdo forme tjetër, kam dashur të bëhem nënë. Edhe unë duhet të jem e limituar në bazë të asaj që the, vetëm pse një shoqëri mendon që një normë duhet të jetë në një formë të caktuar.

Përderisa unë kam dashur të bëhem nënë, për mua ka qenë me rëndësi çfarë ka ofruar shkenca për të ma mundësuar atë të drejtë, e jo të ma determinojë një burrë që duhet doemos ta kem një burrë me të cilin martohem për ta pasur mundësinë që të bëhem nënë.

Ndërsa, ke raste të tjera kur kjo as nuk diskutohet në shoqërinë tonë, ku gratë dhunohen me jo dëshirën e tyre, shtyhen të bëhen nëna. Burrat nuk marrin përgjegjësi në këtë drejtim. Ka raste të familjes, ku gratë shtyhen të kenë fëmijë pa marrë parasysh a kanë probleme shëndetësore apo të tjera, dhe prapë burrat nuk marrin përgjegjësi në këtë drejtim.

Unë mendoj që kjo është e padrejtë. Unë mendoj që jemi në një pikë, ku nuk mund të krijojmë ligje dhe të marrim rregulla, ku gruaja duhet të kufizohet në çdo aspekt, se kjo bart edhe të tjera debate në aspektin global, ndërsa kur vjen puna te përgjegjësia e burrave, është zero. As nuk është e rregulluar me ligj, por as në shoqëri, e as në vlerat e familjes nuk merret si përgjegjësi kjo pjesë.

Duhet të jemi pak më të kujdesshëm dhe të jemi më të qasshëm ta kuptojmë edhe pjesën tjetër, edhe të anës të një gruaja.

Sinqerisht, po çuditëm që po biem në një debat të tillë, në një pikë të tillë, ku i cenohet e drejta një gruaja pse ne mendojmë që vlerat shoqërore e familjare janë në një formë apo tjetrën.

Secili e sheh mënyrën e jetesë së vet në mënyrën e vet, dhe detyra jonë është që ta respektojmë atë pjesë, dhe detyra jonë është që të sigurohemi që secili i ka të drejtat e barabarta në vendimmarrjen e tyre në jetën të cilën e kanë.

Jo të gjithë mund të zgjedhim dhe kemi mundësinë të zgjedhim në mënyrën se si e përcakton shoqëria ta kemi mënyrën e jetesës. Kështu që, duhet t'i kemi parasysh edhe këto elemente.

Më vjen keq ndoshta që e mora fjalën dhe reagova në këtë mënyrë, por e kam parë si debat të vazhdueshëm që ka ndodhur dhe sqerisht mendoj që ka ardhur koha që t'i lëmë gratë rehat të vendosin për veten e tyre, pa u imponuar vlera të cilat mendojnë që janë vlerë shoqërore. Faleminderit!

**KRYETARI:** Veç pak! Deputeti Rrahmani e ka kërkuar replikën ndaj kësaj që e tha Saranda, nënkryetarja jonë.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Natyrisht, që e mirëkuptoj edhe e respektoj qëndrimin e deputetes Saranda, mirëpo në asnjë mënyrë që qëndrimet e as deputetes Bogujevci e as të dikujt tjetër nuk ndikojnë në qëndrimet dhe mendimet e mia edhe për atë se për çka jam këtu.

Është e drejtë që natyrisht që edhe të propozohen gjëra të tilla, por është shumë e drejtë imja si deputet që të kundërshtoj dhe të paraqes vlera të tjera, të cilat unë i mendoj që janë si vlera.

Natyrisht, që ashtu siç nuk kemi të drejtë askush t'ia ndalojmë askujt të bëhet nënë, as fëmijëve nuk kemi të drejtë që t'ua ndalojmë që të kenë baba. Kështu që, nëse i shohim prej asaj perspektive, atëherë i bie që ne, duke u bazuar në fatkeqësi të shumta, ku shumë burra kanë sjellje jo të duhura, bëjnë krime e çfarëdolloj gjërash të tjera, dhe mbeten gra të dhunuara për shkak të tyre, nuk besoj që duhet të bëjmë këso lloj krahasime e barazime, ku e stimulojmë dhe e ndihmojmë një proces krejt të kundërt të natyrës së familjes dhe asaj që ka krijuar Zoti.

KRYETARI: Janë paraqitur tash edhe deputetë të tjerë, sepse kjo e provokoi një lloj të debatit. Ia japim fjalën fillimisht ministrit. E kërkoj më herët. Fjalën e ka ministri Vitia.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

Vetëm një sqarim të shkurtër në atë që u tha me zotin Haxhiu. Zoti Haxhiu, janë disa sëmundje gjenetike që nuk lidhen domosdoshmërisht me diagnozë. Po, nuk lidhen me diagnozë, sepse nuk ka diagnozë.

Hemofilia, nëna që lind fëmijën nuk është e sëmurë, nuk është e sëmurë. Mirëpo rreziku që djali që lind ajo nënë është rrezik jo i madh, ai do ta trashëgojë hemofilinë, domethënë edhe pse nëna nuk është e sëmurë. Po flasim për sëmundje të trashëguara te fryti, ku nëna nuk ka diagnozë paraprake, është sëmundje hereditare, ku jodomosdoshmërisht prindi është i sëmurë, mirëpo fëmija për shkak të problemeve gjenetike që ka nëna mund të lindë si i tillë, domethënë vetëm këtë ta sqarova, prandaj nuk është bërë diagnoza se jodomosdoshmërisht nëna duhet të jetë e sëmurë ose baba nuk lidhet me këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Deri te përcaktimi i fëmijës ka një procedurë dhe në fund ka një diagnozë, ka një procedurë për përcaktimin e hemofilisë, në këtë rast që e potencuat ju dhe në fund përcaktohet kjo si diagnozë, në këtë rast për persona që kanë dispozita gjenetike trashëguese për hemofilinë, pa i bërë të gjitha këto procedura diagnostikuese nuk vijnë në këtë përfundim.

Prandaj, vetëm me indikacion, ku mund të dimë që iks, ipsiloni ka indikacion për këtë, me indikacion nuk bën, nuk mund të ndodhë me indikacion, mund të bëhet me përcaktim të diagnozës. Po, prandaj po them është çështje që buron ose dikush ka predispozita trashëguese, prandaj e thashë vetëm këtë çështje që të mos abuzohet me këtë.

**KRYETARI:** Burim Meta i fundit dhe po e qesim në votim.

**BURIM META:** Faleminderit, kryetar!

Kryeministër i nderuar,

Ministër Vitia,

Ne pa dashur të bëjmë debat për këtë ligj, për shkak se nuk jemi duke diskutuar ndoshta për Kodin Civil ose ligje të tjera, kërkoj që natyrisht të ruajmë edhe nivelin e diskursit këtu, nuk mendoj që në ndonjë proces jetësor familjar pozita e burrit është zero, do të thotë nuk duhet t'i japim karakter feminist këtij ligji.

Ne edhe në kontakte të shpeshta me ministrin Vitia kemi vlerësuar që natyrisht për një ligj të tillë kanë nevojë qytetarët e Kosovës, ka nevojë edhe vetë Kosova. Por ne kemi mundësi që t'i japim impaktin në mënyrë që një ligj i tillë të jetë sa më i kompletuar, do të thotë ne jemi këtu në sallën ku vendosen ligjit, ku japim kontribute për themelimin e ligjeve të tilla. Aktualisht një projektligj i tillë është në kolezion me Ligjin mbi familje, është në kolezion me Ligjin edhe për shëndetësinë dhe natyrisht do të jetë në kolezion edhe me Kodin Civil e me libra të veçanta, Kodi Civil kur të vijë për miratim këtu.

Andaj, pse duhet t'i japim impaktet tona për ndryshime, për ndryshim-plotësim, për amendamente, është nevojë imediate. Këtë e kemi diskutuar edhe si Komision për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe nuk kemi nevojë që të afektohem apo të atakohemi dikush këtu.

Qëllimi ynë është jo t'i japim ndonjë komponentë eventuale religjioze apo diç tjetër, këtu bëhet fjalë për një ligj kaq të rëndësishëm, një ligj i rëndësisë së veçantë dhe t'i minimizojmë apo të mos lëmë hapësirë as për të vetmin abuzim që mund të ndodhë në të ardhmen e afërt sapo ky projektligj të hyjë në fuqi, duke pasur parasysh që përfitimet eventuale materiale të ndonjë grupi mund të jenë jashtëzakonisht të mëdha dhe natyrisht unë këtu para vetes kam edhe disa propozime të ekspertëve të shoqatave të mjekëve, të cilët kanë dhënë imputet e tyre dhe akoma nuk i kemi diskutuar.

Andaj, të jemi të vëmendshëm, në mënyrë që mes këtyre dy leximeve ne natyrisht të mos lëmë asnjë mëdyshje për realizimin e këtij ligji. Faleminderit!

**KRYETARI:** Urdhëro, zoti Vitia!

MINISTRI ARBEN VITIA: Për besë, ndoshta po keqkuptohemi pak.

E para përcaktimi i gjinisë është i ndaluar, rastet që fliten janë aq të rralla sa mund të ndodhë që të mos ketë kurrë nevojë për këtë punë.

E dyta, në asnjë moment nuk bie në kundërshtim as me Ligjin e familjes, as me ligje të tjera, as me Ligjin e shëndetësisë, as me Ligjin për sigurime shëndetësore në të ardhmen edhe këtu e ngriti edhe zoti Haxhiu këtë pjesën që ndoshta është më mirë të vijë ky ose ai ligj, secili ligj është i rëndësishëm. Unë mendoj që ky ligj përnjëmend ka një rëndësi të veçantë, është përkujdesur edhe grupi punues në Ministrinë e Shëndetësisë, besoj edhe Komisioni Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që në asnjë vend nuk ka pasur kundërthënie me asnjë ligj tjetër që sot është në fuqi.

Domethënë vërejtjet, sugjerimet, këshillat natyrisht se në fund ju do t'i votoni. Por për besë këto që u ngritën këtu, nuk qëndrojnë, me keqardhje them, nuk qëndron.

KRYETARI: Vazhdojmë e votojmë projektligjin.

Zonja Kurti, ju u paraqitët pasi thashë se nuk ka diskutime më. Është mirë që deputetët, ju e keni agjendën për këtë projektligj 2-3 javë më herët, përgatitet njeriu vjen, a fol a s'fol. Urdhëro, zonja Kurti!

TINKA KURTI: Faleminderit, kryetar!

Megjithatë unë isha përgatitur që të votoj për këtë ligj, por ka të bëjë me diskutimet që u zhvilluan këtu dhe fjala ime do të jetë e shkurtër në mbështetje të fjalës së nënkryetares së Kuvendit, zonjës Bogujevci, për të shtuar atë se askush nuk ka të drejtën njëjtë, siç nuk ka të drejtë të detyrojë dikë të mbajë një shtatzëni të padëshirueshme, as nuk mund të aludojë mbi të drejtën që t'ia heqë të drejtën dikujt të bëhet nënë, pra as burrat, as dikush tjetër.

Dhe po ashtu familja nuk e ka vetëm një formë dhe asnjë familje në fakt nuk i ka anëtarët e njëjtë. Pra, duhet mësuar të pranojmë atë që gratë pikë së pari vendosin për trupat e tyre dhe u takon vetëm atyre kjo e drejtë, dhe është e dhimbshme nëse hapim tema mbi të drejtat që janë krejtësisht themelore.

KRYETARI: Mirë! 69 qenkemi këtu.

Nëse ka deputet në bufe, i lajmërojmë që po hyjmë në proces të votimit, i thërrasim të na bashkohen.

Përgatituni për votim!

Kush është për projektligjin në fjalë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

62 deputetë votuan, 51 kanë votuar për, kundër nuk kishte, mirëpo 9 deputetë kanë abstenuar. Kuvendi e miraton në parim Projektligjin për shëndetin riprodhues e fertilizimin.

Jo, 60 qenkan, nuk paska kuorum, faktikisht. Me të vërtetë mazhoranca më thonë që 61 janë, mirëpo ndoshta dikush, një deputet nuk mori pjesë as abstenim, as kundër, kjo është arsyeja. Mirë.

Jo, administrata më thotë që nuk ka votuar vetëm një deputet prej mazhorancës, jo më shumë, siç po pretendon zoti Rrahmani.

EMAN RRAHMANI: Këtu afër meje dhe Gramosi nuk ka marrë pjesë në votim, po ka edhe deputetë të tjerë që s'kanë marrë pjesë në votim.

KRYETARI: E qesim edhe një herë në votim.

Përgatituni për votim për Projektligjin për riprodhim, të nderuar.

Kush është për këtë projektligji?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Vetëm 53 deputetë po marrin pjesë në votim të këtij projektligji, kjo i bie që nuk ka kuorum.

Për janë 43, 10 abstenime, nuk po e mbajmë kuorumin në këtë mënyrë. Po e konsideroj si një rezultat i cili është përfundimtar.

Prandaj, ky projektligj i bartet seancës së re.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Ekonomi e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Kush e bën prezantimin e këtij projektligji? Zoti Shala.

Meqenëse edhe paska debat qysh po flitet, atëherë shkojmë në pushim dhe kthehemi në orën 16:00. Kërkoj ndjesë që kaq gjatë, po më duhet të shkoj në Prizren edhe të kthehem, kjo është arsyeja.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Ishim te Projektligji për minierat dhe mineralet, tash ia japim fjalën propozuesit të këtij projektligji, në emër të komisionit me siguri, sepse e keni bërë bashkë, të deputetëve propozues. Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në bazë të nenit 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për nisma legjislative dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës kemi iniciuar nismën legjislative për ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale. Ky projektligj, që është i propozuar dhe që prezantohet sot para jush, përbëhet nga tri nene, apo plotësim-ndryshim në tri nene, përmes të cilave synohet të eliminohen paqartësitë ligjore, me qëllim harmonizimin dhe unifikimin e rregullimit ligjor të agjencive të pavarura.

Më konkretisht, paragrafët 3 dhe 4 të nenit 60 të Ligjit bazik propozohet të fshihen. Sipas Ligjit aktual, Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve në raport me të gjitha agjencitë e tjera rregullatore që i raportojnë Kuvendit ka dy dispozita, ku në procedurën e shkarkimit të Bordit parasheh edhe kontestin administrativ në Gjykatën Administrative. Përkundër faktit se në të gjitha institucionet e tjera është e rregulluar qartë që kur të shkarkohet nga Kuvendi një trup që i raporton Kuvendit, instanca ku mund të ankohen është Gjykata Kushtetuese.

Me këtë rast i kemi analizuar dhe kemi parë se kjo dispozitë është në kundërshtim me konceptin e Republikës parlamentare, ku Kuvendi është organi më i lartë legjislativ dhe vendimet e Kuvendit mund të kundërshtohen vetëm në Gjykatën Kushtetuese. Po ashtu, sipas rregullimit aktual, proceduralisht ne mund të ballafaqohemi me bllokim të institucionit të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve në situatën kur të njëjtit nuk mund të vazhdojnë të ushtrorjnë funksionin e tyre, por vazhdojnë të paguhen me pagë të plotë, përderisa Qeveria bllokohet të propozojë dhe Kuvendi të emërojë anëtarë të rinj të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve.

Sipas paragrafit 2 të nenit 60 anëtari përkatës i Bordit mund të kundërshtojë vendimin e Kuvendit në përputhje me Ligjin e Kosovës për konfliktin administrativ. Në rast të paraqitjes së një ankese të tillë, anëtari përkatës i Bordit pezullohet deri në nxjerrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Supreme e Kosovës, lidhur me faktin nëse vendimi i Kuvendit ka qenë apo jo në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

Sipas paragrafit 4 të nenit 60, gjatë kohëzgjatjes së pezullimit anëtari i Bordit vazhdon të marrë pagën, megjithatë nuk merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë, në çfarëdo çështjeje, veprimtarie ose procesi vendimmarrës të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, ose Bordit të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve.

Të nderuar deputetë,

Projektligji ka kaluar me sukses mekanizmat vlerësues të Kuvendit dhe të Qeverisë, sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin vendor dhe atë të Bashkimit Evropian si dhe është vlerësuar se nuk ka ndikime buxhetore. Duke u bazuar në këtë fakt dhe duke u bazuar në domosdoshmërinë e vendosjes së një proporcionaliteti dhe përputhshmërie me ligjet aktuale, të cilat rregullojnë të gjitha agjencitë e tjera që i raportojnë Kuvendit, ju ftoj që ta miratojmë këtë plotësim-ndryshim të Projektligjit për minierat dhe mineralet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Mirë. Ky ishte prezantimi i projektligjit. Tash ia japim fjalën kryetarit të komisionit. Jo, grupet një herë, pas komisionit. Njëherë komisioni na duhet, çka po mendon.

**FERAT SHALA:** Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në bazë të nenit 74, paragrafi 2, i Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më datë 21.02.2023 e shqyrtoi në parim Projektligjin 08/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale, i ndryshuar dhe i plotësuar sipas Ligjit nr. 04/L-158 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

#### R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-214 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ky ishte qëndrimi i komisionit. Tash grupet parlamentare. Në emër të Vetëvendosjes deputeti Armend Muja.

**ARMEND MUJA:** I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e mbështet këtë iniciativë, marrë parasysh që neni 60, respektivisht paragrafët 3 dhe 4 janë në bartje nga ish-Rregullorja e UNMIK-ut 2005/5 dhe rrjedhimisht nuk i ka paraparë në atë kohë ingerencat kushtetuese të Kosovës dhe pas shpalljes së Pavarësisë është e natyrshme dhe është praktikë juridike, edhe në bazë të Rregullores së Kuvendit, që Kuvendi të nxjerrë akte juridike, jo akte administrative dhe asnjë institucion tjetër i pavarur nuk e ka një rast ku vendimet e Kuvendit të sfidohen në gjykata të rregullta. Në fakt, në të gjitha rastet që ne i dimë dhe i kemi shqyrtuar të gjitha, vendimet e Kuvendit sfidohen

proceduralisht, ligjshmërisht dhe kushtetutshmërisht pranë Gjykatës Kushtetuese. Dhe rrjedhimisht, këto nene janë anomali dhe ne i mbështesim në tërësi.

KRYETARI: Ky ishte qëndrimi i Vetëvendosjes. Tash PDK-ja, kryetari i grupit, zoti Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pra, ndryshimet në këtë projektligj kanë të bëjnë me shkarkimin e Bordit, pra në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, një bord të cilin para një viti e gjysmë e keni miratuar në këtë Kuvend dhe ne si opozitë e kemi kundërshtuar. Dhe, çfarë po kërkonte sot? Sot po kërkonte të ndryshoni një ligj, i cili mundëson shkarkimin e tyre, ashtu siç e quani, për shkak të paqartësive që janë në ligjin aktual.

E para, një gjë që duhet ta dini dhe besoj se secili jurist që do ta pyesni, me një dije mesatare që ka, një e drejtë e fituar me një ligj nuk mund të ndryshohet në proces e sipër. Prandaj, ne jemi që t'i shkarkojmë këta njerëz, sepse kemi qenë kundër edhe kur janë emëruar. Mirëpo, ndryshimi i këtij ligji për shkarkimin e tyre është i pavlefshëm, sepse një e drejtë e fituar me ligj nuk mund të ndryshohet në proces e sipër me një ligj tjetër. Këtë duhet ta keni të qartë.

Apo ndryshe, është sikur të vendosë kjo legjislaturë për ta ndryshuar mandatin tonë tash si deputetë, i kemi pasur katër vjet mandat dhe të ndryshojë në proces e sipër Kushtetutën. Pra, ky parim nuk vlen. Kjo çfarë ju por bëni sot, është e pavlefshme dhe veçse po e krijon një katrahurë edhe më të madhe ligjore. Nuk është rruga për t'i shkarkuar.

E dyta, ajo që e thanë dy parafolësit, se vendimet e Kuvendit nuk mund të atakohen në administrative, është komplet e pavërtetë. Pra, çështjet individuale, këto janë shkarkime individuale, kuptojeni, atakohen së pari në departament administrativ, në Gjykatë të rregullt dhe mund të shkojë deri në Gjykatë Kushtetuese. Pra, çështje të tilla individuale të shkarkimeve të tilla nuk mund të shkojë e para në Gjykatë Kushtetuese.

Mirëpo, ju e keni parë zonjën Valdete Daka, pse s'ka mundur ta çojë fillimisht drejt në Gjykatë Kushtetuese? Është dashur të hyjë e para në Gjykatë Themelore, në Apel, Supreme, pastaj në Gjykatë Kushtetuese. Pra, kjo nuk vlen. Kjo rrugë për t'i shkarkuar këta persona, të cilët kanë shkaktuar dëm, e të cilët i keni emëruar ju, është e pavlefshme. Ata nesër do ta dërgojnë vendimin me të cilin ju do t'i shkarkoni në bazë të këtij projektligji të ri dhe gjëja e parë, që ju garantoj që departamenti administrativ në kuadër të Gjykatës Themelore do ta ngrijë këtë vendim të Kuvendit. Pra, e para është ngrirja e këtij vendimi të Kuvendit.

Pra, të nderuar kolegë deputetë, ne jemi që t'i shkarkojmë këta njerëz. Absolutisht, nuk kemi asgjë kundër dhe arsyet e mëtutjeshme besoj që edhe zoti Shala do t'i japë pikërisht pra edhe për



punën e tyre, mirëpo kjo rrugë që e keni ndjekur me ndryshimin e projektligjit, kur ata janë zgjedhur me një ligj tjetër dhe kur të drejtat individuale, absolutisht e para gjë që duhet të ndodhë, të atakohen në departament administrativ në Gjykatën Themelore, këto janë dy çështje që janë fundamentale. Dhe, nuk mundemi me bë këso gabimesh, domethënë Kuvendit të Kosovës t'i prezantohen e të thonë që nuk kanë të drejtë të atakohen në gjykata të rregullta vendimet e Kuvendit, sepse kanë të drejtë, sepse është çështje individuale. Shkarkimi i tyre nuk është kolektiv. Vetëm vendime që janë kolektive nuk kanë të drejtë të atakohen në gjykata rregullta, ndërsa individuale e para fillon në atakimin në gjykata të rregullta. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash ia japim fjalën deputetit Ferat Shala.

**FERAT SHALA:** Faleminderit, kryetar!

Sot po bisedojmë për të përmirësuar situatën e gabimeve, që kanë ndodhur para një viti, kur ne këtu kemi deklaruar që nuk është mirë që ekzekutivi të ndërhyjë në rregullator, nuk është mirë që kryeministri të luajë rolin e intervistuesit të paneleve të pavarura të Parlamentit.

Megjithatë, ne për hir të institucionit atëherë kemi thënë që e lëmë të lirë këtë punë dhe kemi marrë pjesë sipas vullnetit të lirë dhe i kemi votuar një pjesë të tyre.

Ajo çfarë sot jemi në një situatë tepër të rëndë, është sektori ku ky panel, apo ky Bord nuk ka arritur të kryejë detyrën e vet më shumë se një vit e gjysmë dhe sot kemi rreth 200 lëndë të kompanive biznese, them seriozisht, kryetar, që presin përgjigje. Nëse e kthejmë në numër të punëtorëve janë me mijëra, që marrin përgjigje nga ta për licenca, për leje pune dhe për shumë veprimtari.

Ç'është e vërteta, unë nuk kam pritur që ne tash duhet ta ndryshojmë ligjin për ta përmirësuar një gabim të mazhorancës. Ka rrugë edhe në ligjet aktuale të shkarkimit, vetëm është dashur që ne të koordinohemi pak dhe të respektojmë Rregulloren e re, të raportojmë dhe brenda ditës kemi mundur të gjejmë rrugë, pa hyrë në këtë krahurën tjetër legjislative.

Sidoqoftë, Bordi e meriton që të trajtohet, apo të shkarkohet, unë kisha thënë se do të duhej t'u kërkojmë një dorëheqje morale shpejt, që ata ta lirojnë vetë punën, për shkak të dëmit material, për shkak të dëmit financiar, për shkak të dëmit juridik, që i kanë krijuar Komisionit të Pavarur, Shtetit dhe kompanive, po edhe për shkak të dëmeve juridike dhe dëmtimit të imazhit kompanive biznese, me të cilat i kanë apostrofuuar padrejtësisht.

Ju them me përgjegjësi të plotë, i nderuar kryetar, se e di që jeni në ngjarje dhe janë marrë edhe mediat, afera e improvizuar, e sponsorizuar, gjoja për keqpërdorim financiar në ndërmarrjen Ferronikeli nuk ka bazë, as juridike, as shkencore, nuk ka bazë as ekonomike. Është improvizim total, sepse Udhëzimi administrativ për rentën minerare është i qartë, është i shkruar në tri gjuhë,

dhe neni 6, pika 2 dhe neni 6 pika 3 përcaktojnë saktë çështjen e rentës. Po ashtu, mënyrën e kalkulimit e përcakton neni 9 i Udhëzimit administrativ, pika 5.

Gabimi, me ose pa dashje, në interpretim të gabuar juridik, apo joprofesionalizmi i Auditorit dhe i komisionit, gjegjësisht panelit, na ka futur të gjithëve në qorrsohak, nëse nuk ka qenë kjo porosi politike që ata të kryejnë, të zbulojnë ose të bëjnë edhe një lloj CD-je të marketingut. Pra, e them me përgjegjësi profesionale, nëse e lexoni mirë udhëzimin, asgjë nuk ka që nuk është e kuptueshme.

Dhe për më keq, pikërisht këta njerëz që punojnë me vite, me dhjetëra vjet aty, e kanë audituar, e kanë inspektuar Ferronikelin më shumë se pesë herë dhe të njëjtit, vetëm kur vjen ky bord i ri puro politik e vëren anomalinë dhjetëvjeçare dhe kthehen në retroaktivë.

Pra, porosi të tilla në Rregullator nuk lejohen. Prandaj, gabojnë edhe profesionalisht, gabojnë edhe juridikisht dhe i bëjnë dëm shtetit, sepse nëse marrim, t'ua lexoj pak nja tre rreshta: "Askund në asnjë vend të botës, në asnjë mënyrë, në asnjë praktikë juridike, as shkencore, nuk qëndron që renta të llogaritet në lagështinë për mineralet metalore. Nuk ka praktikë shkencore që mund të kalkulojë sasinë e metalit në xehe të lagësht, pa e terur atë. Nuk ka praktikë në tregtinë e metaleve, që paguhet me lagështi në mineral", pra nuk paguhet lagështia në metal. Nuk ka praktikë globale, që e pranon lagështinë, e paguan atë, as për gjysmëproduktet minerale dhe metalore.

Ne e kemi rastin konkret të rastit Trepça, ani pse minierat substancialisht dhe në origjinë e gjenezë ndryshojnë, është vendburim metalor. Shihni faturën e datës, për ta ilustruar këtë që po them, 13.02.2023 shitja e gjysmëprodukteve të Trepçës bëhet pa lagështi. 12% është lagështi sipas berzës ndërkombëtare të Londrës dhe fatura është, dokumentacioni është. Historikisht të gjitha berzat ndërkombëtare lagështinë nga metalet e largojnë, kryetar, nuk e marrin parasysh. S'paguan kush rentë për ujin e zotit, të natyrës. Nuk ka kund në botë kjo çfarë po kërkohet, as çfarë po spekulohet. Këto janë gabim, ose juridik, ose politik, që ju kanë dhënë rekomandim atyre të paditurve, apo të dëgjueshmëve politikë. Po dëmtohet sektori, nuk ka aferë, po edhe nëse ka pasur, ma gjeni një praktikë diku, pra ne po flasim për mineralin e nikelit në xehe, nuk po flasim për lagështinë e ujit, është minierë sipërfaqësore dhe nuk ka kund në botë që e pranon një formulë të tillë.

Udhëzimi administrativ e thotë, neni 6 thotë: "...në gjendje natyrore.", interpretohet keq me dashje, sepse në kllapa thotë: "... sipas elaboratit të shfrytëzimit." E, elaborati i shfrytëzimit e pasqyron të vërtetën shkencore që e kanë bërë hulumtuesit, që ka lagështi në minierat e plumb-zinkut, se janë sipërfaqësore. Ka lagështi edhe në minierat e plumb-zinkut të Trepçës, është më e vogël, po edhe ajo zbritet në gjysmëprodukt, në koncentrat. Kështu e kemi shitur gjithnjë, kështu

e kam shitur edhe unë kur kam qenë, kështu e shitni edhe ju sot që jeni. Shihni faturat, shihni kalkulimin!

Formula që është në Udhëzimin administrativ është e punuar nga tetë profesorë dhe intelektualë meritorë të kohës, nuk po i përmend me emër, sepse një pjesë e tyre nuk jetojnë më. Është marre dikush që s'ka lidhje me këto shkencë të çohet e ta kontestojë atë. Është në udhëzim. Shihni historikun e ardhjes së udhëzimit, shihni debatet që janë bërë në 2008, 2009 për të. Janë profesorë me renome, janë kuadro që 90% janë të subjektit tuaj, të LDK-së dhe të Aleancës, me respektin më të madh, s'po i përmend me emër se s'jetojnë sot.

Prandaj, nuk ka aferë të tillë, ka improvizim, ose mosdije dhe na ka futur në situatë, por pasojat janë të mëdha, sepse kanë precizuar një dëm prej nëntë milionë euro. Po i njëjti ekip, i njëjti bord, çohet më vonë dhe thotë: Nga nëntë, veç paguaj nja një milion e njëqindmijë e të tjerat janë të vjetra. Kush e merr atë guxim juridik t'ia falë dikujt tetë milionë? Ose më vonë, e obligojnë kompaninë që është në fazën e tranzicionit, e ka blerë tash, kompani e jashtme, e obligojnë t'i paguajë paratë dhe nuk ia japin licencën tash, nuk ia bartin aksionet tash.

Në anën tjetër, kanë krijuar precedent juridik. Është e vërtetë që këta duhet të shkojnë, se s'ka kush e zgjidh më këtë. Sepse, kur lë procesverbal, kur lë vendime, kur lë akte, duhet tash një organ juridik t'i trajtojë këto. Por, t'ju them me përgjegjësi që shkencërisht dhe juridikisht nuk ka gabime. Nuk pretendoj që në kalkulim gabon dikush, por Udhëzimi administrativ është i qartë, procedurat janë të qarta, mineralet janë të qarta, dihet për çfarë minerali bëhet fjalë. Të gjitha të tjerat janë të porositura, ndoshta në Drenicë, ndoshta në Ferronikel, ndoshta dikush po del atje historikisht ka pasur kalkulime e gjëra të tilla.

Pra, nuk ka të vërtetë gjë. Nesër, ose pasnesër, kushdo që e ankimon vendimin e Komisionit të Minierave, ju garantoj me përgjegjësi të plotë që do ta fitojë çdo instancë gjyqësore, dëmi do të jetë shumë më i madh. Prandaj, kërkohet që të ndërpritet kjo fushatë joprofesionale ndaj diçka që është e prekshme, diçka që është e matshme, diçka që është juridike, diçka që mund të kalkulohet.

E mira e së mirës është, kryetar, që të gjendet një mekanizëm, nga institucionet, nga Kuvendi, ta bëjë një prerje të kësaj situatë, t'u kërkojnë dorëheqjen atyre, ose të gjejnë rrugën më të shpejtë ligjore edhe t'i shkarkojnë, por që me kujdes të veçantë të mos i lëndojnë bizneset, të mos krijojnë situata të paqena, sepse e vërteta është edhe e matshme, edhe e njohur dhe e shkruar. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Kusari-Lila, zoti Muja, a e keni në formë të replikave, apo fjalën? Fjalën? OK, Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, e mora fjalën për t'i sqaruar disa gjëra që erdhën shumë konfuzë nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

E para, kryetari i Grupit Parlamentar e mori fjalën dhe filloi t'u japë instruksione anëtarëve aktualë të Bordit, që në rast të shkarkimit të tyre të suksesshëm nga ky Kuvend, se cilat janë hapat që ata duhet të ndjekin për t'u kthyer edhe për ta paditur Kuvendin, për ta bllokuar në fakt shkarkimin e mëtejshëm të tyre, gjë që prapë do e bllokojë punën e Komisionit të Pavarur të Minierave.

Në anën tjetër, kryetari i Komisioni për Ekonomi, i cili ka qenë prezent në ditën kur komisioni ka mbajtur takim, kur anëtarët e Bordit kanë qenë totalisht konfuzë, totalisht të çakorduar, kur ka shkelje të brendshme në raport edhe me komunikimin në mes tyre, kur vendimmarrja prej Kuvendit ka kaluar tek anëtarët e Bordit, ata janë ata që kanë filluar të përzgjedhin kush e kryeson Bordin, kush të flasë, kush të mbajë takim, gjë që s'ka ndodhur asnjëherë me sa di unë. Në këto tri mandate si deputete nuk na ka ndodhur që brenda një Bordi të ristrukturohen ata dhe të vendosin kush është kryesuesi.

Gjithashtu, u tha një e pavërtetë e madhe. E tha zoti Tahiri, tha: Ne i kemi kundërshtuar edhe atëherë.

Zoti Tahiri, ne si pozitë, kur kemi ardhur, kur është votuar Qeveria kemi ardhur me 67 vota. A e di sa vota janë votuar anëtarët e Bordit të KPMM-së? Me 76. Për pak vota, jo absolutisht jo, për 76 vota, bile të gjithë ju mund ta merrni edhe transkriptin, edhe incizimet, të gjithë ju keni dalë edhe keni votuar atë ditë. Çka është e thënë e çka është kontestuar në vazhdimësi është kontestuar kryeministri është përzier.

Neni 60 i Ligjit për miniera dhe minerale të përzgjedhja e Bordit, pika 3 dhe pika 4, pika 4 e parasheh konkursin e hapur që administrohet nga Qeveria, përzgjedhjen që e bën Qeveria me një komision dhe emrat që ia sjell Kuvendit ai komision për t'u votuar. Prapë, jemi ne, deputetët e Kuvendit, që u japim atyre legjitimitet, apo jo. Nëse s'ka pasur besim të mjaftueshëm, kanë mundur të rrëzohen. Dhe, siç e thatë, ata njerëz të gjithë kanë qenë me përvojë përbrenda Komisionit të Pavarur, ne nuk i kemi sjellë nga jashtë, as s'kanë qenë të rekrutuar politikisht, as përkundëjt që jeni munduar t'ua gjeni njëqind vija, edhe jeni mundua ta gjeni një takim të cilin kryeministri e ka mbajtur me ta pesë minuta në raport me strategjinë për punën e Komisionit të Pavarur të Minierave, ka synuar që "kryeministri i ka rekrutuar". Jo, jo, i ka rekrutuar komisioni, i ka sjellë këtu me CV, i ka sjellë me pikë të përzgjedhura, e natyrisht ka qenë ajo ndoshta më e mira e mundshme në rrethanat që ke mundur të bëhej.

E në situatën kur ne prapë jemi ata të njëjtit që i kemi zgjedhur dhe që i kemi vënë para Komisionit për Ekonomi, e pastaj, thashë edhe këtu në seancë, në pah shkeljet e tyre, nuk na bën neve komplic me ta, në të kundërtën, po e ushtrojmë detyrën tonë fiduciare si deputetë të Kuvendit të Republikës, që ju kemi dhënë mandat dhe kërkojmë ta tërheqim atë mandat kur e konsiderojmë se janë shkelje evidente ligjore dhe procedurale dhe kur ka shkelje të interesit strategjik të shtetit. Sikur të kishin qenë këta njerëz të kryeministrit, ose të pozitës, çështjet për të cilat ne i kemi ngritur publikisht, i kishim kryer privatisht. Ju e dini shumë mirë këto punë si kryhen. Nuk i kishim bërë publike ne çështjet e problemeve përbrenda Bordit të KPMM-së, sikur të ishin njerëz të besueshëm të dikujt.

Por, natyrisht se ata e kanë marrë mandatin prej Kuvendit, duke besuar që janë profesionistë dhe më të mirët e atij grupi që kanë konkurruar, kanë aplikuar për këtë pozitë, kanë dorëzuar CV-të, kanë pasur background ose përvojë akademike, ose profesionale në fushën e minierave dhe mineraleve dhe i kemi votuar. Edhe 76 vota ata që i kanë marrë këtu, i kanë marrë prej deputetëve që keni marrë pjesë në votim, nuk është se ky ka qenë votim i mbyllur, ose votim i izoluar, ose votim që është bojkotuar nga opozita. Pozitë e opozitë kanë votuar, që është krejtësisht në rregull, për arsye se është një institucion që i raporton Kuvendit.

Dhe tash, të kontestohet krejt procesi që ka pasur çrregullime dhe anomali të paparë ndonjëherë, ne ende në këtë komision, mandati i tretë po them, në Komisionin për Ekonomi nuk kemi pasur rast të na vijë një bord, në të cilin duhet të ftohen individualisht këta përfaqësues të Bordit dhe pastaj prej tyre ne të dëgjojmë që ata njëri-tjetrin e mohojnë. Po ata njëri-tjetrit mandat nuk u kanë dhënë, ua kemi dhënë ne atyre mandatin, ashtu siç ua kemi dhënë mandatin, mund t'ua marrim mandatin, në rast se nuk janë në krye të detyrës, ose në rast se vërehen shkeljet.

Prandaj, unë nuk e kuptoj prej nga tash gjithë kjo kundërshti në raport me një proces, i cili ka qenë i pastër si loti.

Ndërsa, sa i përket procedurës dhe së drejtës së fituar, që prapë zoti Tahiri iu referua, më lejoni t'ju them se si akt juridik dhe ligjor ai nuk është proceduar në Kuvend. Nuk është proceduar në këtë seancë për votim, është proceduar e është tërhequr, por Kuvendi nuk ka marrë vendim. Përderisa ne po flasim, ata tash për ta treguar mungesën e çfarëdo parimi, përkundrejt se kanë qenë 3 me 2, tash janë bërë pesë. Tash ne të gjithë këtu deputetë të Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare, kemi pranuar letra nga ata, tash janë të pestit bashkë, se tash po ballafaqohen para një rreziku, të cilin ata e konsiderojnë se u konvenon që t'i bashkojnë forcat dhe t'i kundërvihen një padrejtësie që ata mendojnë se po u bëhet.

Kemi shkarkuar edhe më parë në këtë Kuvend anëtarë të një bordi, ose një anëtare, ose një anëtar të një bordi, sipas shkeljeve të evidentuara. Në situatën kur flasim për një sektor strategjik minerar, i cili e ka si bazë, ose duhet ta ketë parimin bazë, jo vetëm transparencën dhe

profesionalizmin, po edhe mundësinë e mbajtjes së konsistencës në vendime të drejta dhe vendime që rrisin kredibilitetin e vendit, me një vendim, me një qasje dhe me një sjellje, ku ata në mes vete e kanë problemin bazik të funksionimit, nuk ka as kredibilitet, as transparencë, e aq më pak se do t'i bëjnë mirë, ose do t'i shtojnë vlerë sektorit, qoftë për investime strategjike apo për sjellje të ndonjë investitori nga jashtë brenda, e lëre më që kanë treguar lëndueshmëri të lartë ndaj komunikimit dhe ndaj kontaktit të drejtpërdrejtë me kompani në raport me vendimet që i marrin, për arsye se ka vazhdimisht ndryshime të vendimeve të tyre në raport me rastin e njëjtë.

Dhe, kur ballafaqohemi me gjithë këto situata, nuk mund se si të mos i mendojmë hapat një pas një. Se si mund të rregullohet një situatë, të cilën natyrisht që nuk e sollëm ne. Ne u dhamë atyre të drejtën për të vendosur si duhet, por ata nuk janë fëmijë, ose nuk do të duhej të ishin persona që duhet të mbikëqyren. Nëse s'ka interes tjetër, përveç interesit madhor. Ata e kanë pasur lirinë edhe të drejtën e plotë profesionale dhe institucionale të sjellin vendime. Fatkeqësisht kanë sjellë vendime të këqija. Për atë, ne i kemi hyrë një procesi i cili synojmë që ta nxjerrë ose ta përmbyllë në fakt këtë procedurë të filluar në komision për të ndalë deri në momentin kur kemi plotësim-ndryshim të ligjit, në mënyrë që sektorit t'i mundësojmë vazhdimin e mëtutjeshëm të zhvillimit.

Nëse ju në ndërkohë keni pasur konfuzion ose keni komunikime të ndryshme nga kompania në fjalë apo nga anëtarët e bordit, ajo është çështje krejtësisht e juaja. Për ne çështja është e pastër. Edhe atë ditë takimi në komision, jo vetëm nga ne, por edhe nga gjithë deputetët e pozitës dhe opozitës ka qenë një situatë e qartë, e paparë ndonjëherë në Kuvendin e Kosovës, ku një grup në një trupë të votuar nga Kuvendi e merr të drejtën e vetëmërimit, e vetë shkarkimit, e vetë vendimit, për gjëra të cilat votohen këtu në Kuvend.

Për të mos lejuar këtë situatë të vazhdojë, fillojmë me procedurën ku është ligji i vetëm nga të gjitha agjencitë që i raportojnë Kuvendit, që në këtë mënyrë e bllokoi procesin e zgjedhjes së emërimit të të tjerëve, u ofron mundësinë e marrjes së pagës së plotë dhe bllokoi secilin institucion prej Qeverisë e deri te Kuvendi të bëjë një përzgjedhje tjetër për anëtarët që do të duhej të kryenin punën e tyre me integritet dhe profesionalizëm ashtu siç është e paraparë edhe me ligj. Ju faleminderit!

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)*

**KRYESUESJA:** Replikë nga deputeti Abelard Tahiri.

**ABELARD TAHIRI:** Faleminderit!

Unë tash vërtet e kam problem, sepse edhe të jesh i paditur edhe të mos kuptosh në proces, ky është një problem goxha i madh.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk mund të bëjmë pjesë e një vendim të tillë i cili është jashtëzakonisht shumë dëmtues. Pse është dëmtues? Pra, unë po ia sqaroj edhe njëherë znj. Kusari. Nuk po flasim për vendimin e shkarkimit të tyre që është proceduar në Kuvendin e Kosovës, sepse ai s'ka kurrfarë vlere. Ai është proceduar, është tërhequr. Po flasim për zgjedhjen e drejtë të tyre, në kohën kur i keni zgjedhur anëtarë të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Pra, ne e kemi kundërshtuar.

Nëpër secilin votim që kanë ndodhur në këtë Kuvend me kuti, opozita ka marrë pjesë. E kemi kundërshtuar me votë, në votimin e fshehtë edhe emërimin e tyre. Besa kemi folur edhe për lidhjet e tyre familjare. Pra, veç mundohu të më kuptosh. Një të drejtë të cilën e ke fituar me një ligj që e zgjedh, nuk mund ta ndryshosh në proces e sipër, sepse është parim juridik.

E dyta, çka është shumë e rëndësishme. Ne s'po ju akuzojmë, se përgjegjësinë penale nuk po themi që e keni ju, sepse s'jemi ne hetues këtu as prokuror. Ne hetim për këtë punë s'kemi bërë, po përgjegjësinë politike për dëmin që e keni shkaktuar e keni ju, e penale besoj ata për dëmin që e kanë shkaktuar rreth nëntë milionë euro.

Prandaj, kjo mënyrë e shkarkimit është e paligjshme. A po kuptoni? E dyta, të thoni nuk ka të drejtë ankimi në çështje administrative, pra të drejtat individuale, është gabim. Është mosdije. Pra, një person, një individ, absolutisht që kur shkarkohet nga Kuvendi i Kosovës, shkarkohet si individ dhe ai person ka të drejtë plotësisht t'i drejtohet Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore.

**KRYESUESJA:** Ferat Shala, replikë!

**FERAT SHALA:** Faleminderit, kryesuese!

Vetëm sa për sqarim. Në mënyrë absolute, të gjithë jemi që ata duhet të shkarkohen apo të dorëhiqen, sepse dëmi tash është edhe juridik, edhe financiar, edhe moral, edhe shumëdimensional. Por, rruga dhe mënyra mbi të cilën aferë ata janë komplikuar në gjithë këtë mekanizëm, ne po e trajtojmë, po e diskutojmë, po rekomandojmë.

Unë kam qenë edhe ditën e parë dhe jam edhe sot, por rrugën e që ka ndërmarrë grupi parlamentar, znj. Kusari, që me nismë të veçantë ta ndryshojë ligjin, jo nuk pajtohem këtu, sepse nëse duhet ndryshuar ky ligj, është dashur të na vijë në vijë zyrtare. Duhet ndryshuar edhe pikat e tjera. Ka qenë ky ligj edhe më herët në Kuvend, diku pesë herë në këtë Kuvend dhe nuk e kanë votuar mazhoranca. Por, që jemi dakord që dëmi është bërë, po. Që jemi dakord që gjithë ai dëm që është bërë, në fund do të rezultojë zero aferë dhe zero problem financiar, saktë, dëmi është shumëdimensional. Por ne nuk mund ta zgjidhim, sepse ata kanë lënë dokumente të shkruara dhe vendime për të cilat pajtohem.

Tash duhet hapur rrugë drejtësisë. Por mënyrën qysh të vijnë deri te ajo, ne duhet sa më shpejt ta gjejmë rrugën që legjislacioni na jep krejt mundësitë, ai që është aktual në fuqi, në mënyrë që ne ta kthejmë normalitetin në institucion. Pastaj edhe mund të shtyhem ne mes vete. Pra, kërkoj që normaliteti në institucion të kthehet sa më shpejt. Normaliteti në institucion nuk kthehet me nismën ligjore që Vetëvendosje ka ndërmarrë sot.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)*

KRYETARI: Kundër-replikë!

MIMOZA KUSARI-LILA: Më lejoni vetëm më herët z. Tahiri e përmendi tha: ne nuk e kemi mbështetur. Po e citoj, e mora transkriptin e ditës kur janë votuar anëtarët e Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Zoti Ferat Shala si kryetar i Komisionit, deklarata juaj: t'ju them të drejtën lista është shumë kredibile, çka është përparësi e madhe për ne sot të gjithë në komision dhe të gjithë dhe komisioni, ekonomia e vendit, sektori e meriton të ketë sa më shpejt Bordin. Vazhdon më tutje faqen tjetër: fat i mirë që thashë se lista është kredibile, ne do ta mbështesim si komision, ne do ta mbështesim edhe si grup parlamentar për hir të sektorit. z. Tahiri, e keni mbështetur. për hir të kredibilitetit të këtyre kandidatëve, për hir të procesit që tash e më shumë se një vit pa bord. Nëse ndodh që dështon procesi, atëherë e kemi shumë të qartë që Kryeministrit nuk ia kanë plotësuar kërkesat minimale që atij i duhet në këtë proces. Kjo ishte deklarata juaj z. Shala. Prandaj, lus që të votohet dhe të kompletohet bordi. Këtë e keni deklaruar në ditën kur është votuar. Konsultohuni me kryetarin e grupit parlamentar, se tjetër gjë deklaroi.

KRYETARI: Kjo kundër-replikë ishte. Po ke të drejtë ashtu, se ke folur në emër të grupit. Merre fjalën, urdhëro. Pse kush ishte në radhë? Po, pra PDK-ja e ka radhën të flasë ashtu-kështu.

Të dy patën replika, kjo ka pasur të drejtë e fundit t'jua përmend emrin, po Abelardi është e vërtetë se ka të drejtë edhe një dhjetëminutësh tjetër. urdhëro.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Po dal në foltore, kryetar, sepse e kam problem për shkak të zhurmës.

KRYETARI: Në foltore? Mirë!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, znj. Kusari!

Kur ta marrësh një informatë, merre të plotë. Ajo listë është përbërë prej disa kandidatëve që kanë qenë më shumë sesa anëtarë që janë zgjedhur. Pa dyshim ka pasur në mesin e tyre që e kanë



gëzuar përkrahjen tonë, po s'kanë kaluar me votë. Pra ka pasur anëtarë të cilët i kemi votuar, po s'kanë kaluar me votë.

Njerëzit tuaj, që e keni pasur shumicën në këtë Kuvend, i keni zgjedhur në këtë komision. Pra, a jam i qartë? Pra, ka ardhur dyfishi i anëtarëve, të cilët ne ata që i kemi votuar si opozitë, që jemi në total dyzet deputetë, s'na kanë kaluar. Tuajt kanë kaluar. Normalisht që e kemi dhënë dakordimin, sepse ai është kryetar komisioni dhe ka pasur njerëz të cilët i kemi mbështetur. pra, a po më kupton?

Ne po flasim për një votim, i cili ka ndodhur në kuti. Është një votim i fshehtë. E para. E dyta, po ta sqaroj edhe njëherë. Këta njerëz, unë bile po ju propozoj se në kohën sa flisje ti, unë mendoj që ndoshta është mirë të bëhet një komision hetimor për këtë punë.

Meqenëse është një organ i Kuvendit, hajde të ulemi bashkë si deputetë të këtij Kuvendi, le të ndodhë një hetim parlamentar, pesë a gjashtë muaj, a dy-tre muaj në kuadër të ligjit, aq sa na lejon ligji, hajde të ulemi ta bëjmë një hetim parlamentar dhe ta shohim punën e tyre. Pra, është pikërisht një institucion i cili i përgjigjet këtij Kuvendi dhe kemi plotësisht të drejtë ta marrim dhe ta shohim komplet punën e tyre edhe për aferën të cilën po i akuzojmë që e kanë dëmtuar buxhetin e Kosovës rreth nëntë milionë euro, edhe për çështje të tjera.

Mirëpo, mënyra, edhe njëherë po ta them, se si keni filluar ta shkarkoni këtë bord është e paligjshme. Pra nuk vlen. Pra, kuptojeni, sepse të drejtat e fituara me një ligj kur zgjidhesh, nuk mund të ndryshojnë në proces dhe të vijë një ligj tjetër që ta shkurton a ta heq të drejtën e ankimit. Pra, kjo nuk mund të ndodhë. Nuk mundet. Jo absolutisht ia heq. Nuk mund t'ia heqësh të drejtat individuale. Në radhë të parë, a jeni duke i parë të gjitha këto ankesa të ambasadorëve të shkarkuar, ankesën e znj. Valdete Daka, ankesat individuale. Po, pra! Kuptojeni një send, ankesat individuale nuk shkojnë në gjykatë kushtetuese. Po nuk po flasim për politikë, sepse edhe kur t'i sillni për shkarkim ato do të jenë individuale. Ju e keni parë gabimin që e keni bërë në të kaluarën, që i shkarkoni në tërësi komplet bordet dhe e keni parë që është e paligjshme dhe keni filluar t'i shkarkoni individualisht. Kur njeriu shkarkohet si individë, ai ka plotësisht të drejtë që vendimin ta ankimojë në departamentin administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Pra, jeni duke e futur në një kaos, të cilin tani nuk do të mund t'i shkarkoni, e që është dëm i madh të mos i shkarkoni. Ne krejt çka po ju themi, po mundohemi të ju qesim në një rrugë ligjore t'i shkarkoni këta njerëz të cilët kanë shkaktuar dëm. Pra, kjo është e rëndësishme edhe për neve, edhe për juve. Pra dëmin e keni shkaktuar ju, jo ne, që e keni sjellë në këtë pozicion. Dëmin politik e bartni ju, jo ne. Përgjegjësinë penale e bartni ta, që unë besoj që ka vepër penale, për të cilën ata duhet të japin llogari. Kjo formë, atyre veç do t'ua mundësojë të vazhdojnë punën

e tyre edhe për një kohë të pacaktuar, të gjatë, ndoshta edhe ta përfundojnë mandatin krejt, sepse po bëjmë hapa të paligjshëm.

Pra, ne po ju themi mos bëni hapa të tillë dhe hajde të gjejmë mundësi dhe t'i shkarkojmë sa më shpejt. Pra, ju po kërkoni gjithqysh të hyni në këtë formë e cila është e paligjshme. Pra, qëllimin e keni të përbashkët, shkarkimin e tyre, mirëpo dallojmë në metoda, dallojmë në qasje. Dëmin e keni shkaktuar ju, nuk e kemi shkaktuar ne. Pra, nëntë milionë euro dëm i keni shkaktuar ju. Prandaj, znj. Kusari-Lila si kryetare e grupit parlamentar, mendoj që më e pakta është d.m.th.

KRYETARI: Lapsus-lingua, keni dëgjuar për këtë fenomen, nuk është kjo kurrëgjë.

ABELARD TAHIRI: Që i adresohesh t'i kesh edhe informatat në tërësi.

KRYETARI: Qetësi, ju lutem!

ABELARD TAHIRI: Ajo që tha z. Shala, kaosin që e kanë shkaktuar këta njerëz dhe ky institucion në sektorin minerar, është e tmerrshme, sepse janë me qindra kompani të cilat afektohen. Janë punëtorë të cilët punësohen nëpër ato kompani. pra dëmin të cilin janë duke e bërë është i pafalshëm. Pra, veprën penale të cilën e kanë bërë, as ju as ne nuk mund t'ua falim. Askush. Këta njerëz duhet të japin përgjegjësi për atë dëm, të cilin e kanë shkaktuar për ato vepra penale të cilat i kanë shkaktuar. Por, mos e bëni këtë gabim, sepse do t'u jepni mundësi këtyre njerëzve ta përfundojnë mandatin këtu ku janë me atë komision dhe të vazhdojnë të shkaktojnë dëm edhe më të madh.

Pra, krejt ajo kërkesë e jona është shumë e sinqerë ndaj juve, mos bëni gabim t'u mundësoni këtyre njerëzve të vazhdojnë të punojnë edhe më tutje. Pra, neve na duhet një analizë e thellë ligjore me të cilën arrijmë t'i shkarkojmë edhe pa pasur efekt dëmtues në kuadër të institucioneve, në kuadër të Komisionit për Miniera dhe Minerale.

KRYETARI: Po keni të drejtë në replika ju. Kush e merrni fjalën? Kryetarja e grupit, Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike u drejtua me kërkesën që ne bashkërisht mund të gjejmë një zgjidhje për këtë situatë, por kjo zgjidhje që ne e kemi propozuar nuk bën. Megjithatë, në ndërkohë, pas gati një muaj kur ka ndodhur takimi në komision, në të cilin do të duhej të ishte edhe z. Tahiri, nuk e di a ke qenë kur ka raportuar ky bord dhe nuk keni pasur ndonjë propozim konkret për këtë situatë. D.m.th. propozimi i vetëm dhe forma e vetme e qasjes së një procesi, të cilin ashtu siç e lexova, e kanë mbështetur edhe zyrtarisht. Nuk ka thënë: disa prej anëtarëve të propozuar janë profesionistë. Por kanë thënë: t'ju them të drejtën lista është shumë kredibile dhe ne të gjithë do ta mbështesim. D.m.th. këta e kanë

mbështetur këtë listë. Këta kanë besuar në këtë proces. Bile-bile sikur procesi të kishte dështuar, tha: duhet ta pyesim Kryeministrin, cilën kërkesë nuk ta kanë plotësuar.

Sidoqoftë, ajo çka është shumë e rëndësishme është të thuhet se ne kemi ardhur me një propozim konkret. Për të dalë nga kjo situatë që këta po e kërkojnë. Po nuk po propozojnë asgjë tjetër.

Themelimi i një komisioni hetimor parlamentar në gjashtë muaj procedurë, pos që u zgjat atyre mandatin, pos që ofron mundësi këtu tash të krijohet një fazë krejt tjetër, rrethana të tjera të cilat e ndalin plotësim-ndryshimin e ligjit, e ndalin shkarkimin e tyre. Ne s'jemi asgjë kundër komisionit hetimor parlamentar dhe e mbështesim atë, por kjo procedurë duhet të vazhdojë. Edhe ne konkretisht e kemi ofruar këtë zgjidhje dhe shpresojmë dhe i ftojmë që të bëhen pjesë e kësaj zgjidhje edhe subjektet e tjera apo grupet e tjera parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Po, ju takon replika z. Tahiri juve.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Pra, hetimi parlamentar dhe shkarkimi i tyre janë dy çështje të ndryshme. Pra komplet të ndryshme. Ne po flasim të ndodhë një hetim parlamentar dhe t'i shohim dëmet të cilat i ka shkaktuar një bord të cilin e ka votuar ky Kuvend. Pra, ajo është çështje të cilën ne po duam ta evidentojmë. Ndërsa, shkarkimi i tyre është çështje komplet tjetër, për të cilën ne pajtohemi, sepse aludojmë të gjithë që dëmin që ia kanë shkaktuar Kosovës është rreth nëntë milionë euro.

Kjo rrugë të cilën ju po e ndiqni dhe po doni të hyni sot, këta njerëz nuk do të shkarkohen. Këta do të vazhdojnë të bëjnë punën e tyre, sepse kanë bazë ligjore të mjaftueshme, të cilën gjykata ua aprovon kërkesën. Ne me një dije mesatare duhet ta dimë, duhet ta kuptojmë qartë që nuk mund t'ia heqësh një të drejtë të fituar me një ligj të caktuar tash me një ligj të ri. Nuk mundesh. Është e pamundshme. Faleminderit!

KRYETARI: Përfundoi ky cikës i shkëmbimeve.

Tash është radha e Vetëvendosjes. Kush e ka fjalën. A keni kërkuar në emër të Vetëvendosjes? Po, keni të drejtë.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Këtu sot po dëgjojmë që qenka problem rruga. Më kujtohet që ky Kuvend para tre muajsh, e kemi nxjerrë një rekomandim për shkarkim të tyre të menjëhershëm. Edhe atëherë, para tre muajsh, opozita, ose PDK-ja na tha që nuk është rruga e duhur.

Thënë të drejtën, unë kam pasur pritja të vogla. Unë e kam konsideruar interesin e shkarkimit ose abrogimit të vendimit të tyre, më i madh dhe më i urgjent, për shkak se etablon një precedent të rrezikshëm. Ekzistojnë 31 milionë euro të cilat operatorët ekonomikë i detyrohen Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Çfarë kanë bërë këta zotërinjtë? Këta kanë thënë: vendimi i tyre është që në momentin kur ti e ndryshon pronarin, lirohesh prej të gjitha obligimeve. Ai precedent i rrezikon 30 milionë euro detyrime. Pra, nëse vazhdon ky vendim i tyre i palogjikshëm, në kundërshtim me Ligjin për shoqëritë tregtare, në kundërshtim me çdo ligj tatimor, e atëherë po i bie që 30 milionë euro mund të fshihen në çdo moment kur ndryshohet pronari.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që të abrogohet ai vendim. E para.

E dyta, është sa i përket rrjedhës. Ka pasur përpjekje që nga shtatori në Komisionin për Ekonomi, jemi duke e bërë një përpjekje t'u tregojmë deputetëve dhe Komisionit. Dëgjo, në këtë rast ka pasur manipulim. Ja ku është çështja. Çështja e parë është sa i përket rentës minerare. Thuhet se ka paqartësi sa i përket rentës minerare, demek e thatë ose natyrore. Nuk është kontestuese që deri në vitin 2011, renta minerare në Kosovë është llogaritur në bazë të thatë. Por në vitin 2011, Qeveria e Kosovës në konsultim me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale i propozon këtij Kuvendi që gjendjen nga e thatë ta kalojë në gjendje natyrore, në 4,5 për qind. Komisioni për Ekonomi atëkohë, dy persona kanë qenë, Zenun Pajaziti dhe Teuta Sahatqija, i bëjnë të gjitha konsultimet me palët e interesit ashtu siç parasheh neni 51 i Ligjit për Miniera dhe Minerale. Ata thonë kështu: kemi marrë kërkesën e palëve të interesit, nuk ka pasur kundërshtime ndaj rentës së re minerare, përjashtimisht thotë Ndërmarrja Ferronikeli, e cila ka kërkuar që të rikthehet renta në të thatë. Mirëpo, kjo kërkesë është refuzuar dhe është vendosur nga Komisioni që të propozohet mbi bazën e gjendjes natyrore.

Pra, renta minerare në vitin 2011 është rritur. Deri në vitin 2011, Kosova i ka marrë shtatë milionë euro nga renta minerare. Nga viti 2012 e tutje i ka marrë midis 20 deri 30 milionë euro. Asnjë dyshim sa i përket bazës ligjore nuk ekziston. Po jua lexoj udhëzimin administrativ, neni 6, që thotë: renta minerare përlllogaritet nga sasia e xehes e nxjerrë në gjendjen natyrore. Edhe ndërmarrja Ferronikeli ka raportuar mbi bazën e gjendjes natyrore. Ajo çfarë ka ndodhur është që në KPMM, stafi atje nuk e ka zbatuar që nga viti 2011. A e di kush kanë qenë? Kanë qenë dy persona të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale që kanë qenë në diskutime në bazë të dokumenteve përgatitore. Ka qenë Selvete Grajqevci, kryetarja e bordit, si u.d. drejtoreshë e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, e cila pretendon që s'e ka ditur, po ka qenë në diskutime. Atëkohë ka qenë u.d. drejtoreshë dhe drejtoreshë e zyrës ligjore, si dhe ka qenë Ahmet Tmava si kryetar i bordit. Të gjithë, edhe ndërmarrja e ka ditur, edhe Kuvendi e ka ditur, çështja kryesore, veç pse nuk është zbatuar, është çështje që duhet të diskutohet.

Nuk është hera e parë që Auditori ka potencuar që ka shkelje sa i përket rentës minerare. Më lejoni t'ju lexoj disa raporte të auditorit. Në vitin 2015, Zyra Kombëtare e Auditimit, në raportin e auditimit të vitit 2015 të KPMM-së kishte nënvizuar se në KPMM zbardhësit e licencave nuk raportojnë në baza vjetore për vëllimin dhe sasinë e nxjerrë nga minierat. Në raportin e vitit 2016, nënvizohet një vit më vonë, KPMM nuk po zbaton rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe KPMM nuk siguron raportim vjetor të shumë kompanive në gjeologji, gjeodezi dhe financa.

Në raportin e vitit 2017, Zyra Kombëtare e Auditimit thotë: nga mostrat e testuara është vërejtur se në disa raste bartësit e licencave po shfrytëzim të pasurisë minerare nuk kanë raportuar mbi aktivitetet e shfrytëzimit si detaje të sakta për tonazhin, vëllimin, përbërjen, shkallën dhe vlerën minerale të prodhuara.

Ajo çfarë ka ndodhur është që nga viti 2011 nuk është më kontestuese. Renta zbatohet mbi bazën e gjendjes minerare. Prej që jemi ne në pushtet nuk është problemi. Problemin ne e kemi pasur çka ka ndodhur ose pse nuk është faturuar në vitin 2011 deri në vitin 2020. Zyra Kombëtare e Auditimit e ka nënvizuar për dhjetë vjet këtë problem dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, auditori i brendshëm në vitin 2021 e gjen që kompania nuk ka raportuar sipas gjendjes natyrore dhe kjo i ka kushtuar buxhetit të Kosovës nëntë milionë euro.

Kështu ka vendosur edhe Bordi i KPMM-së në qershor të vitit 2022, por çfarë ngjau. Kur shkoi ky Kuvend në pushim, ata u mblodhën më 8 gusht deri më 20 gusht dhe ia hoqën ato obligime. Çka është problemi këtu? është evidente që nuk është zbatuar ligji për dhjetë vjet. E dyta, është marrë një vendim i cili paraqet rrezik për të gjitha detyrimet që operatorët i kanë ndaj KPMM-së. Për këtë arsye, shkarkimi i këtij bordi nuk është vetëm çështje e shkeljes së ligjit e cila është evidente, dhe dosjen që ne e kemi dhe t'ua paraqesim deputetëve dhe Prokurorit të Shtetit është se të gjithë e kanë ditur se çka po ndodh, por është rikthim i të drejtës së vjeljes së taksës, sepse ky precedent është i rrezikshëm.

Sa i përket mbështetjes, shikoje tash, shumica e këtyre anëtarëve, përfshirë edhe kryetarja e bordit, i ka pasur mbi 80 vota, kështu që i ka pasur edhe votat e PDK-së. Është shumë evidente kjo. edhe PDK-ja e ka mbështetur. Ata nuk janë, ata nuk kanë pasur asnjë lidhje të vetme me Lëvizjen Vetëvendosje. Ata kanë qenë profesionistë. Po ju përmendi znj. Selvete Grajçevci ka qenë u.d. drejtoreshë e KPMM-së në vitin 2012, ka qenë drejtoreshë e zyrës ligjore në vitin 2012. Jahir Gashi ka qenë kryeinspektor, inspektor dhe kryeinspektor që nga viti 2014. Të gjithë e kanë ditur që renta minerare nuk po raportohet dhe nuk po mblidhet. T'i ikim këtij debati. Të gjithë e kanë ditur që renta raportohet mbi bazën e gjendjes natyrore. Kështu e paguan KEK-u, kështu e paguan Trepça. Ky debati i terur-i thatë ka qenë në vitin 2011. Nga 2007 deri 2011 vërtet ka qenë i thatë, po nuk është bërë relevante kur ka ndryshuar legjislacioni. Ka dalë një legjislacion i ri, Besim Beqaj me Bedri Hamzën e kanë sjellë këtë propozim dhe e ka votuar ky Kuvend. Më 25

maj të vitit 2012, ky Kuvend ka marrë vendim që renta minerare raportohet mbi bazën e gjendjes natyre 4,5% në ton. Ndërmarrja ka kërkuar të rikthehet qysh ka qenë më herët, Kuvendi ka refuzuar dhe rrjedhimisht KPMM-ja e nxjerr një qarkore, e cila është shumë e qartë sa i përket mënyrës se si mblihet renta minerare.

Por, çfarë ka ndodhur këtu? Komisioni profesional i KPMM-së, pas raportimit të auditorit të brendshëm, mblihet ndërmjet janarit dhe prillit të vitit 2022 edhe vërtet e konstaton që ndërmarrja i ka pasur dy probleme: 1. Nuk e ka raportuar vëllim e xehes siç duhet dhe 2. Nuk ka raportuar sipas gjendjes natyrore, dhe kjo i ka kushtuar buxhetit të Kosovës 9 milionë euro.

Nuk po thotë për gjendjen tash, zoti Tahiti. Po thotë, kohën ndërmjet vitit 2011 deri në vitin 2020. Por, renta tash paguhet mbi bazën e gjendjes natyrore. Ne e kemi çështjen, pse duhet të falet një ndërmarrje ose çfarëdo ndërmarrje të tjera për këtë periudhë, kur ligji e parash në nenin 51, që kurdo që renta minerare përcaktohet se është llogaritur gabim, atëherë ti mundesh retroaktivisht t'i detyrosh ndërmarrjet që t'i paguajnë të gjitha detyrimet ndaj KPMM-së.

Andaj, nuk ka kurrfarë dyshimi që shkelja është e konstatuar edhe e përcaktuar ndër vite nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe auditori i brendshëm dhe komisioni profesional. Nuk ka kurrfarë dyshimi që baza ligjore është jashtëzakonisht e qartë dhe ka ndryshuar në vitin 2011. Është e qartë. Ka qenë në gjendje të thatë, por nuk është më nga viti 2011. Atëherë, të mos i përziejme debatet.

Nuk ka kurrfarë dyshimi që këta kanë qenë, përfshirë edhe kryetarët e bordit dhe anëtarët e bordit kanë qenë të vetëdijshëm për mënyrën se si raportohet. Por, edhe ndërmarrja ka raportuar xehen në dy gjendje edhe në të thatë edhe natyrore. Po çka kanë bërë këta në KPMM? E kanë tatuar vetëm për gjendje të thatë, por jo ashtu siç e ka paraparë ligji në gjendjen natyrore.

Rrjedhimisht, kjo i ka kushtuar buxhetit të Kosovës 9 milionë euro. Falë syrit të mprehtë të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje kjo është detektuar. Nuk është detektuar më herët, por është detektuar tash, për shkak të përkushtimit që e kanë pasur deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje në komision.

Andaj, unë kam pasur pritje më të vogla, thënë të drejtën...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia shtoni edhe një minutë, zotit Muja! Po.

**ARMEND MUJA:** Unë kam konsideruar që për shkak të interesit që ky precedent duhet të hiqet, se është vendim i rrezikshëm për industrinë dhe duhet të vepohet më shpejtë. Fillimisht, të

abrogohet ai vendim i paligjshëm që këta e kanë marrë në kundërshtim me ligjin, dhe e dyta, të detyrohen të gjithë t'i paguajnë tatimet.

Por, ka shkuar burokracia e Kuvendit. Ja ku jemi këtu. Një herë na ka thënë PDK-ja që më mirë është kështu, ja tash ju po tërhiqeni. Por, e rëndësishme është, zoti Tahiri, që ka 1 vit që ne e përcjellim këtë çështje. Ju nuk keni qenë asnjëherë në raportim të kësaj ndërmarrjeje. Pesë herë kanë ardhur, pesë herë e kemi trajtuar këtë çështje. Ju lutem, është me interes për sektorin që të veprohet. Faleminderit!

KYRETARI: I kemi dy replika, sepse kanë të drejtë në to, zoti Tahiri dhe zoti Shala.

ABELARD TAHIRI: Zoti Muja, nuk ka pasur ndonjë bord ndonjëherë të KPMM-së që ka shkaktuar një dem prej 9 milionë euro se sa ky tani. Ajo është e evidente. Këta njerëz kanë bërë vepër penale. Ajo është e evidente. Dhe, kjo është përgjegjësi politike juaja. Ju i keni emëruar këta njerëz, ju i keni votuar këta njerëz, dhe ju në këtë mënyrë se si po doni t'i shkarkoni, do t'i lini këta ta përfundojnë mandatin, sepse është mënyrë e cila nuk ju çon në shkarkimin e tyre. Këta njerëz i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës rreth 9 milionë euro, dhe kjo është me fajin tuaj, jo me fajin tonë.

Unë e kam kundërshtuar në komision, ti ke qenë prezent, ndryshimin e ligjit për shkarkimin e tyre. Se kam thënë atë ditë ende pa e pasur materialin përpara, kjo mënyrë, nuk mundesh në këtë mënyrë t'i shkarkosh këta njerëz, sepse është e jashtëligjshme.

Prandaj, unë po të them që përgjegjësinë politike për dëmin që është shkaktuar e bartni ju, besoj që penale, shpresoj që prokuroria punon. Ia ndihmojmë edhe ne me Komision Hetimor Parlamentar, i nxjerrim të gjitha ato gjetura që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe që dëmin që e kanë shkaktuar dhe pastaj ndoshta përfundojnë edhe në burg.

Pra, dëmin që e kanë shkaktuar ata njerëz që ju i keni emëruar është 9 milionë euro. Kjo është e evidente. Dhe, tash ju nuk mund të fshiheni pas procedurave edhe të ikni prej dëmit të cilin e kanë e shkaktuar. Unë po të them, gjejeni bazën ligjore, bashkë me Zyrën Ligjore të Kuvendit, së bashku me Komisionin për Legjislacion, e cila na çon sa më shpejt në shkarkimin e tyre, dhe besoj ndoshta edhe me një aktakuzë as më shpejt për ta.

Por, jo në formën si jeni duke shkuar, sepse këta do të vazhdojnë ta bëjnë punën e tyre si anëtarë të bordit. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Shala replikën tjetër. A po i do të dyja? A po i do të dyja replika më mirë, se më gjatë e strukturon mendimin. Urdhëro, zoti Shala!

FERAT SHALA: Kryetar, vetëm një sqarim, të lutem! Po e lexoj saktësisht nenin 9, kalkulimi i rentës minerare, pika 5, ku thuhet: “Te mineralet metalore renta është e caktuar në përqindje të kalkulimit dhe do të bëhet sipas formulës; totali i sasisë së larguar nga miniera herë përqindja e mineralit të caktuar, (mbani mend, të caktuar në këtë rast, i caktuar është minerali i ujit, nuk është i ujit), herë çmimi i shitjes në tregun botëror herë përqindja e caktuar në listën rentës minerare e barabartë me rentën minerare”.

Mineral i caktuar në udhëzim administrativ nuk është uji, është nikeli. Pastaj më lejo nëse kam kohë ta lexoj edhe nenin 6, është mirë të lexohet komplet. Pika e 2 e nenit 6, thotë: “Sasia e shfrytëzuar e lëndës minerale që kalkulohet më metër kub (metër kub), sipas listës së mineraleve të rentës minerare nënkupton sasinë e mineralit në gjendje natyrore-në vend. (Po vazhdoj prapë, se nuk e lexoi kolegu). Të dhënat merren nga projekti i shfrytëzimit”. Pra, për kë është fjala? Cili projekt i shfrytëzimit? Për rastin konkret, Ferronikël.

Çka ka në projekt të shfrytëzimit? Ka saktësisht atë që e kanë thënë ekspertët, prezencën e lagështisë në mineral. E tash a duhet të llogaritet apo jo, e vërteton gjykata. Por, udhëzimi është i qartë. Ai që do ta respektojë dhe lexojë dhe që ka pak ditë përvojë apo shkollë, e ka të qartë.

Më lejoni ta lexoj edhe pikën. Të lutem 30 sekonda, kryetar! 30 sekonda.

KRYETARI: Po, 20 janë. Po, urdhëro!

FERAT SHALA: Sasia e shfrytëzuar e lëndës minerale që kalkulohet në ton, atje ishte metër kub, sipas listës së mineraleve për rentë minerare, nënkupton sasinë e mineralit të dalë nga miniera, jo sasinë e ujit që del nga miniera...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Dy minuta tash për dy replika për zotin Muja. Urdhëroni!

ARMEND MUJA: Kryetar, kur është trajtuar çështja, propozim-ndryshimi i rentës minerare në vitin 2011, të gjithë aktorët e Kosovës, Qeveria, KPM-ja janë mbledhur dhe i kanë trajtuar tri modele. Modeli i parë ka qenë R1 në gjendje natyrore, modeli i dytë ka qenë në gjendje të thatë pas përpunimit dhe modeli i tretë ka qenë pas tatimit në fitim. Dhe, Kosova përcaktohet për R1, pra gjendjen natyrore.

Këqyre çfarë thotë udhëzimi administrativ, neni 6: “Pagesat e rentës minerare duhet të bazohen në raportet zyrtare të operuesve të shfrytëzimit dhe këto raporte mbi sasinë e lëndës së shfrytëzuar mund të verifikohen nga KPMM-ja. Sasia e shfrytëzuar e lëndës minerare që



kalkulohet me metër kub sipas listës së mineraleve, të rentës minerare të aprovuar nga Kuvendi, nënkupton sasinë e mineralit në gjendje natyrore”. Është shumë e qartë.

Shkojmë tash për t’i hequr çdo dilemë se as mos ligjvënësi e ka ditur këtë të thatë ose gjendjen natyrore. A e ka ditur dallimin apo jo. Kam hyrë dhe i kam parë të gjitha dokumentet përgatitore, procesverbalet e takimeve kur është shqyrtuar renta minerare. Po jua citoj dy prej tyre. Po e citoj, më 25. 4. 2012, Teuta Sahatçiu si kryesuese e grupit punues, thotë: “Ndërmarrja Ferronikeli kishte kërkuar që renta të ishte 1,5 në gjendje të terur, ashtu siç ishte gjatë procesit të privatizimit dhe siç është në Maqedoni. Megjithatë, Komisioni për Ekonomik duke përfituar nga pikëpamja e KPMM-së dhe Qeverisë, kishte refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin se 4.5% në gjendje natyrore është e përafërt me 1,5 në gjendje të thatë”. Kështu e thotë edhe Zenun Pajaziti. Asnjë dyshim nuk ka, i nderuar kryetar.

E dyta, a e di ky Bordi i KPMM-së që është i gjendjes natyrore? Po, kryetar! Selvete Çrajçevci ka qenë drejtoreshë e KPMM-së dhe ka marrë pjesë në këto konsultime bashkë me Ahmet Tmavën...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Diskutuesit e radhës. Adnan Rrustemit ia japim fjalën.

**ADNAN RRUSTEMI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari duhet ta kemi parasysh që pika e rendit të ditës është shqyrtimi i parë i Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

**KRYETARI:** Po thua që kemi dalë prej temës paksa a?

**ADNAN RRUSTEMI:** Pikërisht. Komplet! Po të ishte pikë e rendit të ditës shqyrtimi edhe miratimi i vendimit për shkarkimin e anëtarëve të bordit, këto diskutimet e kolegëve të nderuar, do të kishin kuptim. Unë natyrisht nuk po i kontestoj të asnjërën palë, por po flas për pikën e rendit të ditës.

Asnjë argument nuk u dha, në rastin konkret, nga Grupi Parlamentar i PDK-së, kundër plotësim-ndryshimeve të propozuara për këtë ligj. Çështja është se a je për apo kundër këtyre ndryshimeve në vetvete, pa i paragjykuar dhe pa i lidhur me asnjë rast specifik.

Në anën tjetër, u thanë shumë të pavërteta profesionale, për fat të keq. Ta keni parasysh, Kuvendi i Kosovës padyshim nuk është një organ klasik administrativ. Kuvendi i Kosovës është institucion kushtetues, simbolizon ligjvënës, ka autorizimet për të miratuar ligje, ndryshuar ligje

e kështu me radhë. E ne e kemi në rend të ditës pikërisht miratimin e një projektligji, respektivisht plotësim-ndryshimin.

U tha që ne duhet ta trajtojmë këtë projektligj krejtësisht të ndarë nga procedura eventuale për shkarkimin e anëtarëve aktual të bordit. Nuk duhet ta ndërlihim. Mund ta ketë si motiv nisa për këtë projektligj shkarkimin, por procedurialisht nuk janë të ndërlihdura për sa kohë që procedura për shkarkimin nuk ka filluar, nuk është duke u zhvilluar dhe nuk është në procedurë në Kuvendin e Kosovës.

Dhe, këtu po dal tek ajo që u tha gabimisht si e drejtë e fituar. Madje u quajt që me këtë veprim, ne bëjmë veprim të paligjshme. Absurde! Anakronike! Ne po ndryshojmë ligj, po miratojmë ligj. Si mund të miratojmë një ligj në kundërshtim me ligjin.

Ndajeni e procedurën e shkarkimit nga miratimi ose jo i këtij projektligji. Le të jepen argumente pro et contra dhe madje ky ndryshim nuk po bëhet vetëm për këtë rast, ta keni parasysh. Ky ndryshim nëse miratohet nga Kuvendi i Kosovës në dy leximet, mbetet si i tillë për sa kohë nuk ndryshohet në të ardhmen në nene specifike.

Nuk ka asnjë ndërlihdje me të drejtën e fituar. E para, e drejta e fituar nuk është e drejtë absolute. E dyta, nuk po cenojmë asnjë të drejtë të fituar. Anëtarët e komisionit janë zgjedhur dhe në asnjë rast ata nuk e kanë fituar një të drejtë që, le të themi, i kufizohen shkarkimit të mundshëm. Për çfarë të drejtë të fituar konkretisht, po flasim.

Po të bëhej fjalë, dhe këtu është një ngatërrësë nga kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, po të bëhej fjalë që me këtë plotësim-ndryshim ne ua ndërpresim mandatin anëtarëve aktualë, këtu do të vlente jo e drejta e fituar, por do të vlente parimi i ligjit të favorshëm për palën, por ne nuk po ua ndërpresim mandatin.

Se po është e vërtetë, nuk mundesh nëse me ligjin në fuqi e kanë 4 vjet mandatin, me këtë ligj nuk mundesh t'ua zvogëlosh mandatin në 2 vjet, sepse atëherë thirren në të ligjin e favorshëm, dhe natyrisht vlen parimi madje edhe kushtetues, ka edhe aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese në amendamentin e propozuar në atë kohë në reformën zgjedhore për mandatin e presidentit që s'mund t'i ndërpritet mandati për sa kohë është zgjedhur në një kohë me bazë kushtetuese me mandat tjetër.

Ne po diskutojmë për një projektligj dhe ideja është a jemi pro apo kundër ndryshimeve në fjalë. Në asnjë rast, miratimi eventual i këtyre ndryshimeve në dy lexime nuk e kufizon Kuvendin të fillojë procedurat e shkarkimit në bazë të këtij ligji, por po them, të fillojë procedurat e shkarkimit, jo të vazhdojë procedurat e shkarkimit nëse kanë filluar. Nuk mund të vlejë ajo. Nuk mund të vlejë.

Prandaj, të mos i ngatërrojmë gjërat. Madje edhe nëse ka ide të tjera për problemin e ngritur për shkarkimin e anëtarëve të bordit, nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Ne mund ta miratojmë sot projektligjin në parim. Mund ta miratojmë në dy lexime, dhe nëse ka ide të tjera për ta shkarkuar bordin aktual, ato ide mund të zhvillohen në komisionin përkatës dhe në Kuvend.

Prandaj, le të flasim për projektligjin. Cilat janë vërejtjet konkrete për propozimet që janë dhënë, dhe nëse eventualisht nuk pajtoheni me propozimet ndryshimet, ka rrugë kushtetuese se si mund të mbrohet kushtetutshmëria e akteve që i miraton Kuvendi i Kosovës.

Aktet që i miraton Kuvendi i Kosovës vlerësohen në kuptimin e kushtetutshmërisë me procedurë të qartë kushtetuese në Gjykatë Kushtetuese. Kaq kisha, kryetar! Faleminderit!

KYRETARI: Një replikë Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Nëse do ta kishte pasur vëmendjen Adnani gjatë kohës sa ka folur Mimoza kur e ka prezantuar nismën, besoj që nuk do t'i thoshte këto fjalë, por me siguri s'e paska dëgjuar.

Pra, nisma është për ndryshimin e procedurave për shkarkimin e anëtarëve të bordit dhe ndryshimin e një neni. Po, pra, saktë. I prek nenet. Dhe, një prej tyre është edhe e drejta e ankimimit në Departamentin Administrativ në Gjykatën Themelore, e cila i hiqet dhe kalon direkt në Gjykatën Kushtetuese.

Pra, një gjë duhet ta keni të qartë bre; të drejtat individuale, shkallën e parë që individi atakon është në Departamentin Administrativ në Gjykatën Themelore dhe të mbërrin deri në Gjykatën Kushtetuese. Këtë duhet ta keni të qartë ju.

KRYETARI: Propozuesit thanë, nuk e prek ankimimin.

ABELARD TAHIRI: Absolutisht e prek. Nëse ju e keni dëgjuar, zonja Kusari tha, nga Departamenti Administrativ kalon në Gjykatën Kushtetuese. Por, nuk mundesh, sepse kur është zgjedhur me këtë ligj, është zgjedhur personi në fjalë dhe është një e drejtë e fituar që ai person duhet të ankimojë së pari në të drejtën e tij të cilën e ka gëzuar në momentin që është zgjedhur.

Prandaj, mendoj që të mos hyni në një rrugë e cila nuk çon në shkarkimin e tyre. Unë në aspektin politik po e shoh, ju keni marrë një drejtim, këta njerëz të amnistohen. E kanë bërë një dëm të madh, kështu siç keni filluar, nuk mund t'i shkarkoni. Dëmin e kanë rreth 9 milionë euro.

Tash, ju për t'u nxjerrë pak, sepse ajo ka dalë në opinion publik, ju po filloni një procedurë, e cila do të kulmojë e pasuksesshme. Të drejtat e fituara në kohën kur këta janë zgjedhur nuk mund të ndryshojnë. S'mund të ndryshohet procedura e shkarkimit të tyre. Është e palogjikshme.

Pastaj e ke edhe një rast për Këshillin Prokurorial që e kthen edhe Gjykata Kushtetuese për 1 anëtar të shoqërisë civile. Pastaj e ke edhe çështjen e mandatit të presidentes, ku presidentja aktuale e dorëzon...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Edhe një minutë.

ABELARD TAHIRI: Kjo mënyrë që ju keni hyrë, është të amnistohet dhe të mos mund të shkarkohen asnjëherë, sepse do të hyjmë në një katrahurë tjetër. Pra, uluni dhe gjejini mënyrën ligjore së bashku me Zyrën Ligjore, së bashku me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, si një ministri e cila i mbikëqyr ndërmarrjet publike. Ndoshta mund të na ndihmojë në këtë aspekt. Pra, uluni dhe gjejini rrugën që sa më parë të shkarkohen, mirëpo jo të hyhet në një procedurë, ku ata do të na e ndalin procedurën në gjysmë.

Në momentin që ju e shkarkoni me këtë ligjin e ri, ky proces do të bllokohet, do të ngrihet nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Faleminderit!

KRYETARI: Një kundër-replikë, zoti Rrustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Ky është lexim antik i ligjit për fat të keq. Domethënë, nuk u dha asnjë argument. Nuk flitet për të drejtë të fituar për organe kolegjinale siç është komisioni në rastin konkret. Çështja është, a je kundër apo pro ndryshimeve të propozuara dhe a ke vërejtje ose le të themi, pretendime që këto bien ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Unë po e përsëris, këto janë procese të ndara paçka se mund ta ketë motivin të shkarkimi i anëtarëve aktual të komisionit. Por, Kuvendi i Kosovës nuk është organ administrativ dhe paditë administrative nuk mund t'i bëhen vendimeve të Kuvendit të Kosovës, sepse nuk përmbushin elementet e procedurës administrative. E elementi kryesor është që titullari, organi të jetë organ administrativ, por vendimet e Sekretarit ose të Kryesisë edhe mund të trajtohen, por jo të Kuvendit të Kosovës.

Vendimet e Kuvendit të Kosovës që i nënshtrohen edhe votës vlerësohen kushtetutshmëria dhe eventualisht ligjshmëria, dhe janë të parapara këto me procedura të qarta kushtetuese...

KRYETARI: Diskutuesi i fundit është Visar Korenica dhe e shohim pastaj a kemi kuorum për votim.

VISAR KORENICA: Faleminderit, kryetar!

E nderuara ministre,

Të nderuar deputetë,

Ç'është e vërteta edhe unë kam marrë pjesë në takimin bashkë me anëtarët e tjerë të komisionit dhe e kam përcjellë raportimin e bordit. Bordi e meriton shkarkimin, por edhe në të njëjtën kohë duhet të jemi të qartë me procedurat ligjore që të mos bie ndesh një procedurë me tjetrën.

Sa i përket pjesë së rentës që është përfolur dhe që është folur, unë konsideroj që e njoh këtë fushë. Kam punuar në këtë ndërmarrje. Dhe, renta metalore për lëndët minerale kur bëhet përcaktimi i përqindjes së metaltit, nuk bëhet në gjendje natyrore.

Për ta përcaktuar përqindjen e një metali sasia e zezë duhet të teret. Në kompaninë në fjalë gjendet zona 01, e cila është licencuar, po ashtu nga KPM-ja dhe shfrytëzohet për këtë qëllim që të përcaktohet sasia dhe në të njëjtën kohë të përcaktohet dhe përqindja. Pra, askund në botë nuk paguhet rentë minerale në lagështi.

Vërejtjet e komisionit kanë qenë të drejta sa i përket mospërputhjes së anës financiare me Departamentin e financave dhe gjeologjisë. Këto nuk kanë qenë kalkulimet e gabuara vetëm këto vitet e fundit, por në vazhdimësi ka pasur mospërputhje, dhe kjo është përgjegjësi e bordit që të marrë vendime të duhura dhe ta përcjellin me saktësi barazinë mes këtyre dy departamenteve.

Mosveprimi i drejtë i anëtarëve të komisionit në vendimmarrje, i anëtarëve të bordit në vendimmarrje mund t'i shkaktojë dëm të madh këtij Komisioni për Miniera dhe Minerale, dhe prandaj shumica e anëtarëve të bordit e meritojnë shkarkimin. Unë e mbështes në parim këtë nismë ligjore dhe në ndërkohë është mirë që edhe grupet e tjera parlamentare të kontribuojnë, në mënyrë që sa më shpejtë që është mundshme këta anëtarë të zëvendësohen me njerëz profesionistë në këtë komision. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo ishte e gjitha nga ana e deputetëve. Në emër të propozuesve, a e doni fjalën përfundimtare zonja Kusari-Lila apo kaq mjafton. Mirë, e qesim në votim. Shohim fillimisht se sa deputetë po marrin pjesë në seancë. 59 deputetë i kemi në sallë. 60, 62. Bjerini ziles!

63 deputetë janë në sallë. Uluni nëpër vendet tuaja, po e qesim në votim projektligjin.

Të nderuar deputetë,

Kush është për këtë plotësim dhe ndryshim të Projektligjit për miniera dhe minerale?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

S'besoj që ka kuorum kështu. Një pjesë e deputetëve nuk votuan. Vetëm 63 jemi. Sa thoni që ishin? Nuk ka kuorum dhe meqenëse kështu po supozohej edhe herëve të ardhme nëse e qesim. Atëherë, po e bartim këtë në seancën e radhës, sepse siç duket një grup parlamentar nuk dëshiron që të votojë, prandaj është problem që të arrihet kuorumi.

#### **\* Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për antidopingun**

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare.

Ishin 15 amendamente të propozuara, në seancën plenare të 23 dhjetorit u miratuan edhe amendamentet 1, 2 dhe 3, por deputeti Bekim Haxhiu, në cilësinë e propozuesit para votimit e ka tërhequr amendamentin e dytë.

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë dhe Teknologji e ka dorëzuar raportin plotësues për Projektligjin për antidopingun dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij së bashku me amendamentet e propozuara nga komisioni.

Në fakt, Komisioni Funkcional e ka parashtruar raportin e tij të ri, kështu që për këtë raport e ftojme kryetarin e Komisionit për Arsim, Ardian Gola.

**ARDIAN GOLA:** Faleminderit, kryekuvendar!

Në fakt, ne kur e bëmë tërheqjen e votimit në seancën e kaluar, çështja ishte vetëm tek sigurimi që nuk ka kolizion në mënyrë se si janë përkthyer dispozitat në gjuhën angleze me versionet autentike, siç janë në Kodin e WADA-s. Ashtu sikurse kam treguar më herët, WADA në mënyrë eksplicite ka kërkuar që dispozitat kur merren nga kodi të jenë të transpozuara në mënyrë eksplicite sikurse që janë në kod. Krejt ajo çka kemi bërë sot, gjatë mbledhjes së komisionit, ka qenë përputhja e përkthimeve të dispozitave, përkatësisht amendamenteve që i kemi bërë si komision me versionet e Kodit të WADA-s. Meqë është një ligj, i cili është jetik për fushën e sportit, meqë kemi punuar intensivisht si grup punues, edhe si komision, ku kanë qenë të kyçur edhe eksponentë të partive opozitare, unë konsideroj që ligj do të duhej të votohej, i ftoj me mirëkuptim dhe i lus deputetët edhe nga opozita që ta votojnë në lexim të dytë këtë projektligj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Mirë, por 1 dhe 3 i kemi votuar, 2-shi ka pasur kolizion ligjor, keni thënë, e keni përmirësuar, tash 2-shi.

Jo, sekretari më thotë që amendamenti 1 nuk ka nevojë dy herë të hedhet në votim, kështu që edhe 3-i është i njëjtë. Prandaj, ne e hedhim 2-shin fillimisht, sepse është pa përkrahje të komisionit, e shohim se çka po ndodh me atë amendament fillimisht, uluni nëpër vendet tuaja.

61 deputetë janë të pranishëm.

Me sa po e kuptoj, amendamenti 2 nuk e ka përkrahjen e...

Urdhëro, zoti Gola!

ARDIAN GOLA: Vetëm një shpjegim. Në marrëveshje me deputetin Bekim Haxhiu, kontributet e tij të cilat janë ofruar në formë të amendamenteve i kemi modifikuar dhe i kemi shkruar si amendamente të komisionit, do të thotë komisioni i ka bërë të gjitha amendamentet dhe kontributet e tij janë të përfshirë në një mënyrë ose tjetër në ato amendamente dhe ai në një farë mënyre ka hequr dorë nga amendamentet e tij. Ky është kontribut, të cilin edhe publikisht unë tash po e them kështu që nuk ka diçka problematike.

KRYETARI: Atëherë unë këtu në skenar e kam ndryshe, më duket nuk jeni harmonizuar me administratën, siç duket.

Te unë më figuron që nuk është pajtuar komisioni me Bekimin. Urdhëro, zonja Hoxha nëse mund të na ndihmosh çka është kjo paqartësi.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Edhe atë çfarë e tha kryetari Gola, në fakt, ne jemi harmonizuar, edhe në komunikim me deputetin Haxhiu, kemi diskutuar jashtëzakonisht gjatë, kemi pasur edhe përplasje në idenë e përmbajtjes së ligjit edhe diskutime të shumta. Zoti Haxhiu ka kontribuar jashtëzakonisht shumë duke e njohur fushën dhe procesin se si bëhet.

Një ligj i tillë i ndihmon Kosovës është i domosdoshëm për sektorin e sportit. Andaj, kjo procedurë dhe ky proces që e kemi ndjekur në Komisionin e Arsimit, duke pasur deputetë edhe nga komisionet e tjera dhe kontributi i tyre të integrohet në përmbajtjen e ligjit mendoj që është formulë e suksesit.

Prandaj, mendoj që ne si grup parlamentar do ta mbështesim nismën e tillë ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Gola nëse mund ta kem të qartë, amendamentin 2 që po e qesim në votim, a është me përkrahje të komisionit.

ARDIAN GOLA: Shiko, amendamentet e zotit Bekim Haxhiu nuk kanë mundur të tërhiqen thjesht për shkaqe procedurale, përndryshe çdo amendament që është i Bekim Haxhiut këtu, ai në mënyrë eksplicite në marrëveshje gojore që kemi pasur me të janë tërhequr, për shkak se janë modifikuar në amendamentet e komisionit.

KRYETARI: Edhe ky është amendamenti 2 apo?

ARDIAN GOLA: Po, çdo amendament që vjen nga Bekim Haxhiu duhet, me marrëveshje...

KRYETARI: Ato janë amendamente të tjera që vijnë më vonë.

E qesim amendamentin 2 në votim.

Zoti Kokaj, a po votoni a e do fjalën. Urdhëro!

JAHJA KOKAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Tash ne po flasim për një koncept, të cilin po e aprovojmë sot të quajtur doping.

Ju e thatë më herët se definicioni juridik shpeshherë është në kolizion me mendime të ndryshme, meqenëse konceptet juridike dhe sociologjike shpeshherë kanë karakter relativ kohor e hapësinor. Unë mendova që koncepti “doping” të jetë së pari i definuar, ndonëse është përtej elegancës juridike atje, të jetë edhe definicioni shkencor meqë “doping” nënkupton pjesëmarrje apo njoftim i premisave në një strukturë të pastër.

Prandaj, ky koncept i mirëfilltë shkencor ma merr mendja vetëm që kishte shtuar saktësinë, meqë paradite e pamë ne se në qoftë se bazohemi vetëm në definicione juridike apo sociologjike, mund të hasim në kolizion dhe në diferencë të mendimeve varësisht nga parapërgatitjet intelektuale psikologjike, kognitive dhe emocionale.

Prandaj, unë nuk do ta pengoj këtë ligj, do ta votoj, por e shoh të nevojshme ta them që është e nevojshme, ndoshta do të ishte mirë që të jetë ai definicion së pari i mirëfilltë ashtu siç është dhe pastaj forma e tij e transponuar pikërisht për çështje sportive. Faleminderit!

KRYETARI : I qesim sipas radhës amendamentet, nuk mund të bëjmë ashtu votim selektiv. Uluni nëpër vendet tuaja, sa deputetë jemi, 64.

Amendamenti 2.

Pa përkrahje të komisionit.

Kush është për amendamentin 2?

Këto amendamenti më duhet t'i hedh një nga një, sepse shumica i kanë nga dy versione, kështu që detyrohem ta hedh në votim secilin.

62 deputetë.

E hedhim fillimisht në votim amendamentin 2.

Amendamenti 2 është i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kush e voton këtë amendament?



Kush është kundër?

Kush abstenon?

Mua m'u duk që ishin tri abstenime. Po, mirë.

63 vota, 50 kundër, 10 vota ishin për këtë amendament, 3 abstenime. Konstatohet që nuk kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3 është votuar.

Amendamenti 4 i ka dy propozime.

I pari është i Komisionit Funksional, i dyti i Bekim Haxhiut.

Ne e qesim fillimisht në votim atë të Komisionit Funksional, siç kemi bërë gjithmonë.

Kush është për amendamentin e propozuar nga Komisioni Funksional?

Nuk mendoj që kuorum, më duket tash.

Kush është kundër? Kundër 3, a?

Kush abstenon?

*(Ndërhyrje)*

Grupi i PDK-së, nëse po mendoni që ky është ligj shumë i mirë, siç e thatë për antidopingun, pse nuk po votoni?

*(Ndërprerje e incizimit)*

Zoti Gola, edhe zonja Hoxha, me sa i dëgjova me vëmendje, ishin të njëjtat frekuenca. Të njëjtat frekuenca, që zoti Haxhiu e ka pasur mirëkuptimin me komision dhe është pajtuar që pas përfshirjes së propozimeve të tij nëpër amendamentet e tjera të komisionit, ato të vetat tashmë e kanë gjetur përgjigjen aty. Kështu që, ne në seancë i votojmë ato të komisionit. Kështu e kuptova unë edhe fjalën e zonjës Hoxha.

A është kështu? Po. Ma konfirmon zonja Hoxha që e kam kuptuar drejt, kështu që...

*(Ndërhyrje)*

Po. Mbeti vetëm abstenimi.

Kush abstenon për këtë amendament?

I keni pasur votat për, kundër dhe abstenim, apo nuk i keni numëruar votat?

*(Ndërprerje e incizimit)*

Për amendamentin 4 rezultati ishte ky: 54 vota për, kundër ishin 3, abstenuan 6, kështu që kalon, e ka marrë shumicën e votave nga deputetët që kanë votuar.

Kalon amendamenti i Komisionit Funksional.

Tash e kemi amendamentin 5, që është i propozuar nga Bekim Haxhiu, pa përkrahje të Komisionit Funksional.

Kush e mbështet këtë amendament?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Më tregoni fillimisht, ju lutem administrata, sa deputetë i kemi, sepse nuk e kemi të qartë tash.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Uluni, sepse mjaftueshëm jemi nëse votojmë të gjithë. 64 deputetë jemi.

Po e përsërisim amendamentin 5, sepse me këtë rezultat që ma kanë sjellë, nuk ka kuorum kështu. Uluni nëpër vendet tuaja.

Amendamenti 5, po e përsërisim votimin.

Është amendamenti i deputetit Bekim Haxhiu, i cili nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funksional.

Kush është për këtë amendament, edhe një herë?

Kush është kundër këtij amendamenti?

Kush abstenon?

*(Ndërprerje e incizimit)*

12 për, 6 kundër, 46 abstenime, nuk e ka marrë numrin e mjaftueshëm të votave për t'u votuar, kështu që nuk kalon amendamenti i Bekim Haxhiut.

Dalim te amendamenti 6. Dy propozime: I Komisionit Funksional dhe i Bekimit.

E qesim të Komisionit Funksional.

Kush është për amendamentin e Komisionit Funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

54 vota për këtë amendament, kundër 3 deputetë, kurse abstenuan 4. Ka kuorum, ky amendament e merr mbështetjen, prandaj kalon. Ishte amendamenti 6 i Komisionit Funksional.

Tash e kemi amendamentin 7 të propozuar nga Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Kush është për këtë amendament?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

63 vota krejt, për 11, kundër 5, abstenime 47, kështu që nuk kalon amendamenti nr.7.

Amendamenti 8 është vetëm një, vetëm i Komisionit Funksional, nuk ka alternativë tjetër.

Kush është për këtë amendament të Komisionit Funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Tash vetëm 61 deputetë votuan, 57 për, 4 abstenime, kalon amendamenti i Komisionit Funksional.

Amendamenti nr. 9 i ka dy propozime. I pari është i Komisionit Funksional. I dyti i Bekim Haxhiut.

E qesim në votim amendmentin nr. 9 të Komisionit Funksional.

Kush është për këtë amendament?

Jo, edhe Isaku është.

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Besnik, shfrytëzoje të drejtën përcaktuese për abstenim.

56 për, kundër 3 deputetë, abstenime 3 deputetë. Kalon amendamenti i Komisionit Funksional.

Amendamenti 10, 11, 12 dhe 13, i qesim në pako. Të gjitha janë vetëm nga një, i ka propozuar vetëm Komisioni Funksional, nuk kanë alternativë tjetër.

Kush voton për amendamentet e Komisionit Funksional?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

56 vota për, kundër ishin 4 deputetë, 3 abstenime. Kalojn këto katër amendamente.

Tash i kemi veç edhe dy. Amendamenti i parafundit i ka dy propozime. Është versioni A i propozuar nga komisioni, versioni B i propozuar nga Bekim Haxhiu.

Kush është për propozimin e Komisionit FunkSIONAL?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Po bëhet fjalë për amendamentin 14.

56 vota për amendamentin, kundër 2, abstenime 3. Amendamenti 14 kalon.

Amendamenti i fundit dhe pastaj e hedhim edhe projektligjin në votim. I ka dy propozime. I pari version është i Komisionit FunkSIONAL, i dyti i Bekim Haxhiut pa përkrahjen e komisionit. E hedhim atë të komisionit në votim.

Kush është për këtë amendament?

Kush është kundër amendamentit 15?

Kush abstenon për amendamentin 15?

Përfunduan votimet e amendamenteve, tash e shohim se si po del projektligji në votim.

61 deputetë e dhanë votën e tyre, 57 për, 2 kundër, 2 abstenime. Kalon amendamenti 15 i Komisionit FunkSIONAL.

Tash me të gjitha këto që u votuan deri tash prej amendamenteve, pesëmbëdhjetë prej tyre, e qesim në projektligjin bashkë me to të miratuara. E qesim në votim.

Të nderuar deputetë,

Kush është për Ligjin antidoping?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

64 të gjithë keni votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kështu që Kuvendi e miratoi Ligjin për antidopingun.

Pasi e kemi ministren këtu, ka qëndruar deri në këto momente, veç ta prezantojë dhe pastaj e ndërpresim seancën.

## **8. Shqyrtimi i Raportit të performansës në ndërmarrjet publike qendrore për vitin 2021**

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se Komisioni FunkSIONAL për Ekonomi ia ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij.

Ia japim fjalën përfaqësueses së Qeverisë. Në këtë rast, ministrja Rizvanolli e paraqet Raportin e performansës.

**MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: I nderuar kryetar i Kuvendit!**

Të nderuar deputetë,

Raporti i performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2021 është ai që po e diskutojmë sot. D.t.th. ka kaluar një kohë që nga atëherë dhe kjo nuk është situata e sotme. Ju përkujtoj që Qeveria jonë e ka marrë detyrën më 22 mars të atij viti, duke e gjetur ndërmarrjet publike në gjendje të rëndë financiare, pa plane biznesi të qarta, pa struktura organizative që i shërbejnë afarizmit, me mbipunësimin, me kontrata të këqija, shpenzime të pakontrolluara dhe të hyra të pasigurta.

Ne kemi ndërmarrë veprime të menjëhershme për të përkrahur ndërmarrjet, por nga ana tjetër edhe për të kërkuar llogari prej tyre njëkohësisht. Aty ku ka qenë e nevojshme, kemi shkarkuar bordin e drejtorëve dhe emëruar drejtorë të rinj në bazë të përkohshme, ose me mandat të rregullt përmes konkursit.

Kemi bërë të qartë kërkesën tonë që ndërmarrjet të qeverisen në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Kemi caktuar objektiva të qarta dhe të kapshme për secilën ndërmarrje dhe kemi kushëzuar ndihmën tonë me veprime konkrete për vendosjen e ligjshmërisë, zvogëlimin e shpenzimeve, rritjen e të hyrave dhe ristrukturimin.

Ndërmarrjet gjatë këtij viti kanë raportua mbi dhjetë raste të keqpërdorimeve në Polici e Prokurori, duke përfshirë këtu shumë raste në Telekom, raste në Trepça, Ibër-Lepenci, KRU Prishtina etj. Mirëpo, fatkeqësisht, deri më tani nuk kemi pasur reagimin e duhur nga Prokuroria e Shtetit, andaj shfrytëzoj rastin që t'i bëjë thirrje Prokurorisë që t'i trajtojë këto raste me seriozitet dhe me urgjencë.

Përkushtimi ynë, megjithëse kemi qenë më pak se nëntë muaj në detyrë, veçse kishte filluar të jepte rezultate që atëherë. Ndërmarrjet qendrore vitin 2021 e kanë mbyllur me fitim financiar

prej 21.5 milionë euro, për dallim nga viti 2020 që kishte përfunduar me humbje financiare prej 2.7 milionë euro.

Për periudhën raportuese, KEK-u ka dalë ndërmarrja më fitimprurëse, falë edhe prodhimit rekord të energjisë. Telekomu dhe Posta kanë vazhduar që gjatë 2021-ës të përballen me humbje për shkak të detyrime të trashëguara, mirëpo te këto dy ndërmarrje kemi tanimë rezultate të prekshme në reformat strukturore, shkurtimin e shpenzimeve dhe rritjen e të hyrave.

Ndërmarrjet e transportit Infrakos dhe Trainkos kanë operuar me humbje për shkak të rindërtimit të linjës hekurudhore drejt Maqedonisë së Veriut, mirëpo edhe për arsye të tjera.

Ndërmarrja Ibër-Lepenci e ka mbyllur vitin 2021 me fitim operativ, e sfiduar nga asetet që kanë normë të lartë zhvlerësimi, por që janë pasuri e paçmim për Republikën tonë.

Viti 2021 ka qenë jashtëzakonisht sfidues për Trepçën. Të goditur nga keqpërdorimet ndër vite, teknologjia e stërvjetëruar, mirëpo edhe nga rritja e çmimit të energjisë, për shkak të krizës botërore. Mirëpo, ndërmarrja ka filluar të këndellet duke shkurtuar shpenzimet operative, duke rritur të hyrat dhe duke vendosur rend e disiplinë në punë.

Ndonëse kriza energjetike i rëndon pasqyrat financiare të Trepçës që ende operon me teknologji joeficiente, ndërmarrja tani po bëhet gati për ristrukturim dhe investime kapitale në makineri të minierave dhe flotacion që kanë munguar për dekada.

Disa prej rezultateve të ndërmarrjeve publike, KEK ka rritur fitimin në dyzet milionë euro nga 24 milionë sa i kishte në vitin paraprak. Telekomu i ka filluar investimet, ka ulur shpenzimet, rritur të hyrat dhe ka ulur humbjet nga 16 milionë në vitin paraprak në 11 milionë në vitin 2021.

Ibër-Lepenci ka rritur të hyrat dhe ka ulur humbjet nga 4,1 milionë në vitin paraprak, në 3 milionë në vitin 2021. KRU Hidroregjioni Jugor në Prizren ka arritur fitimin prej 54 mijë në 193 mijë euro. KRU Bifurkacioni në Ferizaj ka ulur shpenzimin, ka rritur fitimin nga 28 mijë në 84 mijë në vitin 2021 e të tjera.

Puna jonë me ndërmarrjet publike lidhet ngushtë me tranzicionin energjetik sipas Strategjisë së energjisë 2022-2031, por edhe me planin e Qeverisë për themelimin e fondit sovran të Republikës së Kosovës. Gjashtë ndërmarrje komerciale, përfshirë KEK-un, Trepçën, Telekomin, Postën, Infrakosin dhe Trainkosin, është plani që të kalojnë në fondin sovran, pasi që të përmbillet ristrukturimi dhe të tejkalohen vështirësitë financiare e operative.

Ndërmarrjet publike veçse janë në rrugën e duhur për të qenë fitimprurëse dhe të qëndrueshme, me një udhëheqje të re e mendësi të mbarë, ne po punojmë në frymën e interesit publik dhe me

synim zhvillimin e ndërmarrjeve dhe zhvillimin e vendit dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim. Tanimë po dëshmohet që kjo është e mundur me vullnet dhe përkushtim nga ana jonë dhe e ndërmarrjeve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Me sa po i shoh grupet parlamentare tashmë janë pajtuar që ta ndërpresim këtu seancën, kështu që vazhdojmë kurdo që t'i caktojmë vendimet.

Faleminderit! Mirupafshim në seancat e radhës!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*